



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 15 KORRIK 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
15. JULA 2010. GODINE**

**KORRIK – JULI
2010**

E enjte, 15 korrik 2010, ora 10:00

Drejton mbledhjen: anëtari i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, zoti Naim Maloku.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Hapim punimet e mbledhjes plenare të datës 15 korrik 2010.
Më lejoni që të fillojmë me pikën e parë:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në bazë të nenit 47.3 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta.

Në bazë të nenit 47.3, deputetëve të lajmëruar dhe të cilët kanë mbetur pa diskutuar, pra nga mbledhja e kaluar, u jepet fjala në fillim të mbledhjes plenare të radhës. Nga mbledhja e kaluar kanë mbetur pa diskutuar deputetët. Rita Hajzeraj, nuk është këtu.

E ka fjalën Sala Berisha – Shala.

SALA BERISHA- SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje, zëvendëskryeministër, ministra prezentë!

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Më lejoni ta ngre një çështje e cila aktualisht është shqetësim serioz që po i përcjell qytetarët tanë jashtë atdheut. Në situatën aktuale të sezonit veror numër shumë i madh i mërgimtarëve tanë tashmë tradicionalisht lëvizin nga Evropa drejt vendlindjes ku jetojnë përkohësisht, këto lëvizje i bëjnë përmes rrugëve tokësore. Problem esencial po paraqet pajisja e tyre me viza transite të Republikës së Kroacisë. Pothuaj se është e vetmja rrugë e mundshme për të lëvizur në drejtim të Kosovës në bregdetin shqiptar që është rrugë më e shkurtër dhe është problem kalimi përmes kufirit kroat. Kemi të dhëna dhe informacione, shqetësime nga mërgimtarët tanë se pajisja e tyre me këto viza para konsullatave në shtetet e perëndimit është shumë e vështirë dhe shumë e vonuar. Grupet e mëdha të mërgimtarëve presin me orë dhe ditë të tëra para zyrave të kësaj konsullate duke humbur orë pune, maltretime me familje, gra e fëmijë, duke pritur kështu në kolonat e gjata prej mesnatës e deri sa të hapet orari zyrtar. Gjithsesi se këto ngarkesa administrative po u kushtojnë edhe financiarisht qytetarëve tanë në diasporë. Mendoj që kemi obligim institucional, shtetëror të interesohemi dhe të intervenojmë tek Qeveria kroate, qoftë në nivel ambasdash apo në tjetër mënyrë që të zgjidhet kjo çështje se paku për këtë periudhë sezone verore, siç bëri edhe Shqipëria për qytetarët e saj për këtë çështje. Shpresoj se Ministria e Punëve të Jashtme përmes përfaqësimit të saj konsullor do të shtojë interesimin edhe më të madh për qytetarët tanë në diasporë. Qytetarët presin, e di se Qeveria për qytetarët tanë ka hartuar një strategji që brenda në Kosovë të mos kenë pritje të gjata para zyrave të regjistrimit civil, gjithashtu që këtë interesim duhet ta shtojë edhe jashtë Kosovës në nivel të konsullatave, së paku me ato shtete që kemi bashkëpunim ndërshtetëror. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Si duket ka probleme teknike më zë, kryetar, megjithatë unë po vazhdoj.

Se universiteti është tempull i dijes për këtë pajtohemi të gjithë, sikurse që pajtohemi edhe për nevojën e madhe që ka vendi ynë për hapësira të reja universitare apo edhe për themelimin e universiteteve të reja. Qytetarëve të Republikës së Kosovës, sidomos rinisë së saj, duhet t'u ofrohen mundësi dhe kushte më të mira me qëllim të avancimit të dijes së tyre dhe arritjen e gradave më të larta shkencore përmes studimit në institucionet e arsimit të lartë. Jam shumë i sigurt se edhe për këtë pajtohemi të gjithë, por ajo për të cilën nuk pajtohemi, se paku ne, është se me çështje të tilla, përveç se po bëjnë fushata të mëdha politiko- mediatike, po bëjnë edhe shkelje të ligjeve. E shkelja e ligjeve nga kjo Qeveri nuk është ndonjë risi dhe nuk është hera e parë që po bëhet, ka ndodhur shumë herë në të kaluarën e po bëhet edhe tani dhe fatkeqësisht tashmë kjo është kthyer në praktikë.

Të nderuar kolegë,

Më lejoni që të përmend vetëm dy raste për çështjen të cilën e ngrita më lartë ku Qeveria e Republikës së Kosovës i ka shkelur ligjet e miratuara nga ky Kuvend.

E para, më 9 tetor të vitit 2009, Qeveria e Republikës së Kosovës e mori vendimin nr. 01/87, me të cilin themelohet Universiteti i Prizrenit, si institucion i arsimit të lartë publik, i cili është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit mbi arsimin e lartë, ligji nr. 2002/03, ku në nenin 6.1 përcaktohet se: "Bartësi publik i arsimit të lartë mund të krijohet vetëm me vendim të Ministrisë, vendimi duhet të ratifikohet në Kuvend" - gjë që nuk është bërë. Pra, me këtë rast është bërë shkelje e dyfishtë e kësaj dispozite, sepse përveç se vendimi nuk është marrë nga vetë Ministria e Arsimit Shkencës dhe e Teknologjisë, por është marrë nga kreu i Qeverisë, ai vendim i cili është marrë këtu 10 muaj më parë ende nuk është sjell në Kuvend për ratifikim.

Ndërkaq, tashmë së shpejti pritet të zgjidhet edhe rektori i këtij universiteti, gjithashtu është paralajmëruar se në javën e ardhshme do të shpallet edhe konkursi për pranimin e studentëve, por Qeveria nuk e sjell vendimin për ratifikim në Kuvend.

Duket se edhe kësaj radhe Qeveria, sikurse edhe shumë herë tjera, po e vë Kuvendin para aktit të kryer dhe me këtë logjikë veprimi, realisht Kuvendin po e bën vetëm ratifikues formal të vendimeve të saj, pa të drejtë debati dhe të një mendimi apo edhe vendimi ndryshe nga ai që mund të ketë Qeveria si ekzekutiv i këtij vendi.

Ndërsa, shkelja e dytë lidhet me akreditimin e institucioneve private të arsimit të lartë. Qeveritë e kaluara kishin lejuar licencimin e institucioneve private të arsimit të lartë me emërtime të ndryshme, varësisht nga dëshira e dikujt. Kjo Qeveri, përveç se nuk i akreditoi ato për vitin akademik 2008/2009, duke u bazuar në raportin e Këshillit britanik për akreditim tha se tani do të respektohen të gjitha dispozitat ligjore, por këtë e harroi shpejt, sepse vitin e kaluar u akredituan institucione private të arsimit të lartë me emërtime të cilat nuk i gjen në asnjë dispozitë ligjore, me të cilat është rregulluar kjo fushë, pra si kolegje.

E njëjta po ndodh edhe këtë vit. Më 8 korrik u publikuan rezultatet e akreditimit nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës dhe Këshilli Kombëtar i Cilësisë. Sipas rezultateve të tyre doli se asnjë nga institucionet private të arsimit të lartë, aktualisht nuk i përmbush kriteret për të bartur emrin universitet. Në bazë të Ligjit mbi arsimin e lartë në Kosovë, neni 8.2 emërtimi universitet mund t'i jepet vetëm një bartësi të akredituar të arsimit të lartë, me një kontingjent prej së paku 3000 studentësh të rregullt, të regjistruar në mënyrë të pavarur dhe që organizon kurse apo jep programe në të paktën 5 grupe lëndësh të ndryshme. Por, nga 20 institucione që janë akredituar nga Agjencia e

Kreditimit të Kosovës, 10 prej tyre bartin emërtimin kolegji, ndërsa të tjera institute dhe shkolla të larta, asnjë universitet.

Emërtimin kolegji nuk mund ta gjesësh as në Ligjin mbi arsimin e lartë në Kosovë e as në udhëzimin administrativ nr. 2/2009 të datës 6 janar 2009. Me këtë rast më lejoni të ritheksoj edhe një herë se as unë e besoj asnjëri nga ne këtu nuk jemi kundër themelimit të institucioneve të reja të arsimit të lartë, si publike ashtu edhe private, por jemi absolutisht kundër shkeljeve të vazhdueshme që po i bëhen legjislacionit të vendit tonë duke i arsyetuar ato shkelje me gjëja vepra të mëdha që kjo Qeveri po bën për vend...

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë. Për fjalë është lajmëruar deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryetar, përshëndetje!

I nderuar kryeministër i vendit, kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Këtë minutazh do ta shfrytëzoj edhe një herë për të ngritur çështjen lidhur me politikat tona të Qeverisë, pronën komunale dhe mundësitë zhvillimore të komunave. Vitin e kaluar, në seancën e parë të shtatorit, po ashtu e ngrita këtë çështje për të parë mundësinë se pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, marrjes së kompetencave, qeverisjen e pronën, procesin e privatizimit dhe AKP-ja si autoritet i cili e menaxhon pronën publike dhe pronën komunale, a ka mundësi pra që Qeveria jonë të përgatitë një memorandum të përbashkët me asociacionin e komunave, me AKP-n, për të parë nevojat e komunave, për pronën që ka të bëjë sidomos në zonat ku janë qytetet. Pra, nuk ka mundësi zhvillimore me faktin se ka mbetur edhe pak mundësi hapësirë ose tokë, ose pronë komunale në të cilën kanë mundësi të ndërtojnë, të zhvillojnë infrastrukturën aq të nevojshme për sot ose nesër. Prandaj, edhe e ngrita këtë çështje edhe një herë për të parë, a ka mundësi që brenda këtyre dy muajve pra, deri në seancën tjetër të Parlamentit, të shihet mundësia e këtij memorandumi, e këtij bashkëbisedimi me asociacionin e komunave, të shihen specifikat e çdo komune, qoftë asaj në Istog, qoftë në Ferizaj, qoftë në Vushtri ose kudo tjetër, cila është nevoja minimale e asaj çka mund t'i mbetet si pronë për këtë infrastrukturë? Ka mundësi pra si Qeveri, si AKP si asociacion i komunave që realisht ta shohin se çka nuk duhet të privatizohet nga ajo çka ka mbetur, për të mund nesër për ta zhvilluar infrastrukturën.

Dhe kur jemi te kjo pra unë e shoh po ashtu të nevojshme edhe për Ministrinë e Pushtetit Lokal, që të shohë mundësinë e një memorandumi tjetër, i cili ka të bëjë po ashtu me zonat kadastrale siç është rasti i Gjilanit edhe i Novobërdës lidhur me pjesën e periferisë së qytetit dhe Pasjakut të shqyrtojë mundësinë e memorandumit të mirëkuptimit që kjo zonë pra të mbetet në pronë të qytetit të Gjilanit, pavarësisht asaj çka ka ndodhur. Ju e dini që megjithatë komuna e Gjilanit me reformën e re të pushtetit lokal, i vetmi qytet ka mbetur pa zona kadastrale të vetat për shkak se pjesa veriore që është e banuar me serbë ka shkuar me Novobërdën, pjesa kjo që po flas zona që i bie periferia e qytetit perëndimore dhe Pasjaku, janë të gjithë shqiptarë dhe të shihet kjo mundësi e memorandumit të mirëkuptimit, a ka mundësi që me dy kryetarët e komunës së Gjilanit dhe të Novobërdës dhe Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, pra, ta shohë nevojën që kjo zonë kadastrale t'i mbetet qyteti i Gjilanit, sepse ju e dini shumë frik që ka shkuar edhe komuna e Parteshit me Budrikën, me Pasjan e të tjera, pra, një mundësi për një zgjidhje e cila ka mundësi të bëhet brenda kësaj kohe që Gjilani ...

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Për të satën herë dëshiroj prapë të ngre çështjen e veriut dhe moszgjidhjen e këtij problemi kaq të rëndësishëm.

Ngjarjet të cilat kanë ndodhur kohëve të fundit, duke filluar që nga mbajtja e zgjedhjeve, plagosja e deputetit, vrasja e qytetarit në veri, lëndimet e të tjerëve, kalimet, ardhjet, shkuarjet e gardave të Llazarit dhe të autoriteteve të Serbisë, me kërcenim se do ta bëjnë ndarjen e Kosovës, duhet të jenë alarmante për Qeverinë dhe vetë Kuvendin e Kosovës. Edhe pse u bë një strategji, të them, më shumë pro forma, e cila nuk po zbatohet nga Qeveria, po del se kjo strategji që në fillim është e dështuar. Institucioni i cili duhet të sigurojë drejtësi në veri, siç janë gjykatat, nuk po funksionojnë, realisht po funksionojnë me një kapacitet të limituar, siç është me disa gjyqtarë dhe prokurorë të EULEX-it, por nuk ka gjyqtarë dhe prokurorë të vendit, as shqiptarë dhe as serbë në veri, edhe pse nga ana tjetër prokurorët dhe gjyqtarët Kosovarë kanë shprehur gatishmërinë për të punuar në veri. Me këtë, pra, drejtësia nuk po funksionon.

Në anën tjetër, një institucion shumë i rëndësishëm, i cili është dashur të funksionalizohet dhe i cili duhet të ishte pjesë e zgjidhjes së problemit në veri, siç është Agjencioni i Kosovës për Inteligjencë, nuk është funksionalizuar, mbase kryeministri mund të tregojë pse kjo po ndodhë? Do të thotë, as nga forma e organizimit, as e kapacitetit, një institucion kaq i rëndësishëm, i cili duhet të jetë pararojë e sigurisë, nuk po funksionon në Kosovë. Pse, ndoshta mundet kryeministri të tregojë, as nga resurset, as nga njerëzit, as nga funksionimi. E gjithë kjo, më bën të ftoj Kuvendin që të jetë shumë më serioz në përcjelljen e gjendjes në veri edhe sidomos ta mbajë përgjegjëse Qeverinë për zgjidhjen e këtij problemi.

Ju ftoj, të nderuar deputetë, që të bashkëngjitni në këtë thirrje për zgjidhjen e këtij problemi të rëndësishëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nait Hasani, e ka kërkuar fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje Kabinetit,

Unë kam një kërkesë pikërisht për kryetarin e Kuvendit dhe Kryesinë që ka muaj që e kam proceduar në Kuvendin e Kosovës, në Kryesinë, kërkesën për dënimin e krimeve të komunizmit ku ende nuk ka dal në rend të ditës dhe cila është arsyeja, pse është vonuar ose pse nuk po vjen në rend të ditës.

Ne jemi vend i vetëm apo shtet i vetëm në Kosovë dhe në Evropë që nuk kemi marrë ende një vendim të tillë për dënimin e krimeve të komunizmit. Kur do të vijë në rend të ditës, ne e kemi proceduar në mënyrë të rregullt, janë nënshkrimet, të gjithë çfarë është dashur, tash pse vonohet kjo çështje? Kjo është çështja e parë.

Dhe e dyta është për kryeministrin e Kosovës, pikërisht Fakulteti i Edukimit në Prizren dhe tani regjistrimet e reja dhe Universiteti i Prizrenit, që Prizreni e ka pritur me kënaqësi ose me gëzim, atje është kërkuar që Fakulteti i Edukimit të mbyllet dhe cila është arsyeja që fakultetet e tjera të edukimit si në Gjakovë, në Prishtinë e të tjera të akreditohen, ndërsa Fakulteti i Edukimit në Prizren, të mos akreditohet. Ky është një diskriminim që i bëhet qytetarëve të Prizrenit, nxënësve atje, të cilët, një mori i tyre i gjinisë femërore nuk kanë mundësi ta vijojnë mësimin klasor apo mësimin për arsimtarë dhe ata të vijnë në Prishtinë. Prandaj, kërkoj nga ju si kryeministër të ndikoni që pozitivisht, duke

ndikuar në hapjen e Universitetit të Prizrenit, mos ta mbyllni Fakultetin e Edukimit në Prizren. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë. Myrvete Pantina e ka kërkuar fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Çështja që do ta ngrit ka të bëjë me bujqësinë. E dimë që bujqësia apo bujqit kosovarë nuk kanë përkrahje të mjaftueshme institucionale. Përveç kësaj shpeshherë bujqit tanë për t' u marrë me këtë veprimtari ka raste që edhe demotivohen nga veprime të ndryshme që zhvillohen në vendin tonë. Unë do ta përmend një rast konkret. Para disa muajsh një sindikatë e bujqve të Kosovës ka mbledhur disa fakte për dëmet që kanë pësuar bujqit kosovarë, ka të bëjë me ata që kanë mbjell grurë. Për shkak se në tregun tonë është shitur një sasi e plehut të cilësisë së dobët, ekziston rreziku që nga përdorimi i këtij plehu dëmet për prodhuesit e grurit të mos jenë vetëm për një vit, por të zgjasin më shumë vite. Sipas informatave që i kam kjo sasi e plehut i takon kontingjentit për subvencionimin e fermerëve që mbjellin grurë. Parashtrohet pyetja si ka mundur të ndodhë një gjë e tillë? Deri kur bujqve tanë do t'u ofrohen në treg impute jo cilësore apo impute që vendet tjera i largojnë nga përdorimi për shkak të rrezikut? Ky rast tregon qartë se sa i paorganizuar dhe i pakontrolluar është tregu i produkteve dhe i imputeve bujqësore dhe se në çfarë pozite është farmeri në Kosovë, dhe po ashtu se bujqit tanë kanë nevojë për një mbështetje më të madhe institucionale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Rita Hajzeraj, e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Unë e kam bërë këtë pyetje edhe e kam kërkuar fjalën në javën e kaluar kur ishte edhe greva e punonjësve për motrat edukatore të cilat janë në foshnjoret tona. E di që është një kategori e cila nuk po e intrigon shumë elitën tonë politike, sidomos Qeverinë e Kosovës. Besoj që kjo kategori jo aq e madhe me numër, po ka të drejtë me kërkesat e saj tash e 10 vjet, ndërsa dy vjetët e fundit Qeveria e Kosovës iu ka premtuar se do ta rregullojë statusin e tyre. Janë e vetmja kategori në Kosovë e cila nuk e ka të rregulluar statusin e tyre. Ministri i Arsimit, më 14.4. të vitit 2010 ka nënshkruar një udhëzim administrativ, me të cilin zotohet se do ta respektojë edhe statusin e këtyre punëtorëve, po ashtu edhe ngritjen e pagave, sepse tashmë ato punëtorë kanë mbetur, as me shëndetësi dhe as me sistemin e arsimit, do të thotë, janë pa status. Është një kategori e cila vazhdimisht nuk ka gjetur përkrahje nga qeveritë tona. Unë kërkoj nga ministri i Arsimit që udhëzimin administrativ, të cilin e ka nënshkruar në muajin e katërt të këtij viti, ta respektojë, ose unë si deputete po ashtu edhe kjo kategori e këtyre punëtorëve do të jetë prapë në protesta apo greva siç kanë filluar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Driton Tali, e ka fjalën.

DRITON TALI: Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Me keqardhjen më të madhe më duhet që në këtë mënyrë të protestoj ndaj mënyrës së udhëheqjes së seancave plenare nga zoti Jakup Krasniqi. Siç jeni edhe ju dëshmitarë, të nderuar qytetarë, zoti Jakup Krasniqi, shpeshherë shkel Rregulloren e Kuvendit duke patronizuar Kuvendin dhe deputetët, sidomos ata të opozitës, e në veçanti të deputetëve të pavarur, siç ishte rasti me seancën e fundit parlamentare, pra të 8 korrikut, në pikën e pyetjeve dhe përgjigjeve. Zoti Krasniqi, shpeshherë sillet kështu, sikurse Kuvendi të jetë pronë e tij apo sikurse Kuvendi të jetë ai dhe ai të jetë Kuvendi,

edhe duke dhënë përgjigje dhe komente pa qenë fare i thirrur në çështje të shumta që i ngritin deputetët. Bile, e shfrytëzon rastin kur deputetëve u ndalet mikrofonin dhe ai komenton, duke qenë i vetëdijshëm se deputetin opinioni nuk e dëgjon, kurse atë po, pra i dëmton deputetët. Kjo është ngjashëm sikurse njeriun ta sulmosh pas shpinës apo ta rrahësh njeriun me duar të lidhura. Në këtë mënyrë, zoti Jakup Krasniqi sillet herë- herë si të ishte pronar i Kuvendit, herë - herë mbret i Kuvendit e herë- herë si mësues i Kuvendit, e më shumë herë sillet si sekretar i përgjithshëm i PDK-së, duke e ngulfatur shprehjen e lirë, debatin dhe demokracinë dhe duke sjellë pra Kuvendin në nivelin e Kuvendit të Koresë Veriore apo Kuvendin si në kohën e Stalinit. Ju faleminderit! Rasti eklatant është edhe sot, i pari kam kërkuar fjalën.

KRYETARI: Vazhdojmë.

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,

Qeveri dhe deputetë të nderuar,

Me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/22 ka qenë krijuar baza juridike për themelimin e institucioneve mikrofinanciare. Prej vitit 2000 deri 2006, 2007 janë formuar një numër i madh i këtyre organizatave. Qëllimi themelor i tyre ka qenë bamirësia e jo plaçkitja e nevojtarëve, e debitorëve, me kamatat astronomike deri 25%. Në atë mënyrë numër i konsideruar i institucioneve mikrofinanciare kanë krijuar, hiq më pak se 36 milionë euro. Tani është fushata prej tyre edhe kanë pasur sukses, madje të krijojnë, ta determinojnë krijimin e një grupi punues nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Qeveria, për ta vlerësuar një farë forme për t'u shndërruar ato institucione mikrofinanciare në shoqëri aksionare. Lexo, kupto për t'i fshirë ato 36 milionë euro, ata, ato, të cilët më së paku i meritojnë. Ky është një shqetësim shumë serioz edhe aksentin, apostrofin ia adresoj kryeministrit dhe ministrit të Ekonomisë dhe Financave që ta marrin këtë çështje shumë seriozisht, mos ta tolerojnë uzurpimin e 36 milionë eurove të debitorëve nevojtarë, skamnorë që ato nuk është dashur, nuk është dashur të grumbullohen në atë mënyrë nëpërmjet normave interesore astronomike. Ju falënderohem!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Nurishahe Hulaj, e ka fjalën.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Unë për herë të dytë paraqes çështjen e Fakultetit të Edukimit të Prizrenit dhe plotësisht e përkrah deputetin Nait Hasani, i cili e theksoj këtë çështje. Dhe unë do të paraqes të dhënat se Agjencia e Akreditimit të Kosovës në vitin akademik 2009/2010 ka zhvilluar procesin e akreditimit të programeve në disa njësi të Universitetit të Prishtinës dhe ka dhënë rekomandime Universitetit të Prishtinës, por unë do të ndalem vetëm në këtë rekomandimin për Fakultetin e Edukimit, respektivisht për programet që do të zhvillohen në kuadër të fakulteteve të edukimit, pikërisht për Prizrenin. Dhe në këtë aspekt unë kërkoj nga Qeveria dhe këtë kërkesë e barti nga gjithë studentët e rajonit të Prizrenit, nga prindërit e rajonit të Prizrenit që të mos hiqet Fakulteti i Edukimit në Prizren, por në kuadër të Universitetit që do të ndërtohet në vitin akademik 2010/2011, në kuadër të këtij universiteti të inkorporohet edhe Fakulteti i Edukimit në Prizren. Prandaj, Qeveria mundet dhe kërkojmë që ta mos respektoj këtë pikë, por ta ndryshojë duke inkorporuar edhe Fakultetin e Edukimit për hir të gjithë studentëve e cila është kërkesë e domosdoshme që të jetë, të qëndrojë pra Fakulteti i Edukimit në Prizren, në kuadër të Universitetit të ardhshëm për vitin akademik 2010/2011. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Dhe, i fundit për sot, deputeti Zef Morina e ka fjalën.

ZEF MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Kolegë deputetë,

Kohë më parë grupi punues për reformën zgjedhore i përbërë nga grupet parlamentare të partive kryesore politike ka filluar punën për hartimin e Projektligjit për zgjedhje, hap të cilin e mbështesim, sepse ligji aktual vërtet ka shumë mangësi dhe ka krijuar shumë probleme gjatë zgjedhjeve të fundit që i lamë. Por, nuk pajtohem që në këtë grup punues të mos marrin pjesë edhe partitë tjera, partitë të cilat janë të regjistruara, qofshin ato parlamentare apo jo parlamentare. Andaj, Partia Demokratike për Integrim kërkon të jetë pjesë e grupit punues për hartimin e këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kisha kërkuar edhe një herë po kërkoj nga deputetët që ta lexojnë nenin 47 për deklaratat e lira të grupeve parlamentare dhe të deputetëve. Mendoj që ndonjë deputet ka nevojë ta lexojë në mënyrë të veçantë disa herë nenin 47.

Vazhdojmë tani me deklaram të lirë të Qeverisë.

Fjalën e ka kryeministri zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Siç edhe është proklamuar edhe zyrtarisht edhe nga ministri i Jashtëm, Hyseni, më 22 korrik do të shpallet mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për statusin politik të Kosovës. Republika e Kosovës dhe institucionet, qytetarët do të përcjellin dhe janë duke përcjellë me kujdes dhe optimizëm prezantimin e këtij opinionit këshillëdhënës. Qeveria e Kosovës beson në mendim që do të jetë plotësisht në përputhshmëri me interesat e qytetarëve të Kosovës, me vullnetin e tyre të shprehur për shtet të pavarur dhe sovran, me vendimet e institucioneve legjitime për shpalljen e Kosovës shtet për të jetuar si popull, por si vend demokratik, multietnik, në krah të kombeve të lira, me perspektivë për t'u integruar në NATO dhe Bashkim Evropian.

Qeveria e Kosovës beson dhe njeh të drejtën ndërkombëtare, dëshmon se çdo veprim dhe vendim i institucioneve të Kosovës ka qenë dhe është plotësisht i drejtë dhe në përputhshmëri me vullnetin e qytetarëve të vendit.

Gjithashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës, siç edhe e dinë të gjithë miqtë dhe partnerët tanë, vendimin për shpalljen e Kosovës shtet e ka bërë në koordinim të plotë, pas negociatave 2 – 3 vjeçare, me ndërmjetësimin ndërkombëtar të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe faktorëve tjerë.

Pavarësia e Kosovës, pas prezantimit të opinionit këshillëdhënës, pra për shtetin tonë do të ketë një fazë të re, faza e konsolidimit dhe fuqizimit të shtetit tonë, të institucioneve tona, faza e re do të hapet e integrimi edhe në NATO, edhe në Bashkim Evropian, edhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Faza e re e relacioneve tona ndërfqinjësore, ndërshtetërore, në kuadër të kësaj edhe angazhimet tona për çështje të pazgjidhura teknike në raport me shtetin e Serbisë, por për Kosovën do të ketë vetëm ecje përpara, do të ketë vetëm progres, do të ketë vetëm njohje të reja dhe fuqizim të vizionit tonë për t'u anëtarësuar sa më parë në strukturat euroatlantike. Pra, me prezantimin e opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare dhe në këtë periudhë kur kemi implementuar mbi 85% të

dokumentit të presidentit Ahtisari, ne po hyjmë në fazën definitivisht përmbyllëse të realizimit të suksesshëm të pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Të kaloj në një çështje tjetër, por që ndërlidhet drejtpërdrejt me ndërtimin e rendit demokratik të një shoqërie civile, të sundimit të ligjit dhe të respektimit, të implementimit të plotë të kriterëve demokratike për t'u integruar sa më parë në strukturat e Bashkimit Evropian, por para së gjithash edhe për të implementuar angazhimet dhe vizionin të cilin e kemi për ndërtimin e vendit demokratik, të sundimit të ligjit.

Me qëllim të parandalimit dhe goditjes së krimit të organizuar dhe trafikimit, kam iniciuar masa parandaluese në këtë drejtim, jo vetëm që të kemi ndëshkim, por edhe një parandalim, preventivë, që të mos ndodhin fare fenomenet negative, pra as korrupsioni, as krimi i organizuar, as dukuri tjera negative. Në kuadër të kësaj, siç edhe jeni të informuar, kam iniciuar nxjerrjen e Ligjit antimafia. Ky ligj përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave që janë subjekt i këtij ligji si të dyshuar për pjesëmarrje në krim të organizuar dhe trafikim. Qëllimi i këtij ligji antimafia, është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit përmes konfiskimit të pasurisë së personave të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale. Edhe ky ligj do të përfshijë periudhën 10 qershor e tutje.

Ndërsa, të nderuar deputetë,

Përfaqësues të gjitha partive politike, ju ftoj për mbështetje të këtij debati për këtë ligj, pasi që do të fillojë të hartohet nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe do të jetë plotësisht në përputhshmëri me standardet e vendeve të Bashkimit Evropian.

Ndërsa, çështje tjetër që u ngrit gjithashtu është ajo e akreditimit, unë dëshiroj të theksoj se ne edhe në mbledhjen e djeshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kemi prezantuar vendimet, qoftë për akreditimin e Universitetit Publik të Prishtinës, me fakultetet përkatëse të cilat mendoj se janë shumë dhe është një vendim 6 – 7 faqe dhe do t'ju merrja shumë kohë që t'i lexoja të gjitha, por është tani më në ueb sajtin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe secili mund ta lexojë, gjithmonë me mundësi ankese në vendim.

Gjithashtu, është edhe vendimi tjetër i akreditimit të kolegjeve private. Unë vlerësoj se kolegjet private kanë arritur një avancim në kuptimin e jashtëzakonshëm të cilësisë dhe Kosova, ka nevojë mbi të gjitha, arsimit kosovar, edukimi kosovar, ka nevojë mbi të gjitha për cilësi dhe jo vetëm emra apo numra, por unë mendoj se të gjitha këto institucione janë duke shkuar në drejtim të duhur që të meritojnë akreditimin më meritues dhe më të lartë të mundshëm akademik në të ardhmen e afërt. Është një vendim i propozuar nga institucionet e pavarura të cilat i ka respektuar Qeveria e Republikës së Kosovës. Përsëri e them, gjithmonë me mundësi ankese në Qeveri, në vendimin e Qeverisë për t'u plotësuar ky vendim.

Tek Universiteti i Prizrenit dhe çështjet që u ngritën, ju e dini se Universiteti i Prizrenit do të fillojë punën më 1 tetor të këtij viti dhe unë kam besim të plotë se propozimet të cilat u dëgjuan këtu nga deputetët përkatës, do të inkorporohen, por dëshiroj të theksoj se tani më është punë e kryer, shumë shpejt do të zgjidhet edhe rektori, do të hapet konkursi për studentë dhe puna e Universitetit të Prizrenit, pra Universiteti i Prizrenit do të fillojë punën më 1 tetor të këtij viti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Koha edhe e deputetëve edhe e Qeverisë për deklarime të lira kaloi. Vazhdojmë.

Për rend dite është lajmëruar deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryetar!

U lajmërova që të propozoj për seancën e sotme ta shtojë një pikë të rendit të ditës. Është fjala për një vendim që duhet ta marrë seanca plenare për auditorin, i cili do ta auditojë auditorin gjeneral. Siç e dini, Kryesia e Kuvendit i ka dhënë obligim Komisionit për Financa Publike t'i kryejë procedurat e tenderimit edhe përzgjedhjes dhe të rekomandimit për kompaninë që do ta auditojë auditorin gjeneral. Në këto procedura i kemi kryer, arsyeja pse e kërkoja jashtë procedurës që të vihet në rend të ditës është, sepse janë disa afate ligjore të Ligjit për prokurimin publik që duhet të bëhet kjo punë me një afat prej disa orësh, prej ditës, momentit kur është përzgjedhur kompania, dhe që të mos humbim kohë gjatë verës. Mendoj që do të kem mirëkuptim nga deputetët, është fjala për një votim, për një procedurë që është përfunduar. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Kërkesa e deputetit është bërë mbi bazën e nenit 42, paragrafi 2. Shkojmë në një votim formal. Kush është për kërkesën e deputetit Haki Shatri? Shumica absolute. Faleminderit! Kush është “kundër”? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka. Faleminderit, atëherë, vazhdon si pikë e fundit të rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 1 dhe 5 korrik 2010

Kush ka vërejtje në këto procesverbale? Nuk ka. Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 1 dhe 5 korrik 2010.

Pika e tretë e rendit të ditës është:

3. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti dy pyetje.

Vazhdojmë sipas radhës, deputeti Driton Tali, pyetje për kryeministrin Thaçi ose për ministrin Ahmet Shala.

DRITON TALI: Faleminderit!

Pasi që e kemi nderin ta kemi këtu zotin kryeministër, do t'ia parashtroja zotit kryeministër.

Zoti kryeministër, pyetja është kjo: Për shkak se në opinion janë shfaqur shumë dilema rreth dhënies me koncesion të ANP-së, të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, pse nuk e publikoni kontratën e nënshkruar dhe përmbajtjen e ofertave të ofertuesve të tjerë? Deri më tani janë dhënë disa informata shkarazi me atë se konzorciumi Limak - Aeroport de Lyon do të fillojë të jap të hyra 18% vitin e dytë dhe këto do të përfundojnë deri në 55%, pra me një mesatare për 20 vjet, 39.42%, por jo më shumë se kaq. Shumë qytetarë të Kosovës janë të interesuar për shkak se kemi të bëjmë me një pronë publike, të shohin kontratën. Ne e dimë se UNMIK-u kur i privatizonte pronat publike, nuk i publikonte kontratat. Ju lutem, ju po mendoj kështu, si pishtar i transparencës, duhet ta ndërroni këtë modë të qeverisjes. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, a e doni fjalën?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar deputet Tali,

Për pyetjen tuaj të falënderoj shumë, sepse më mundëson që të ritheksoj edhe një herë se procesi i dhënies me koncesion të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës është procesi më transparent dhe më profitabil që kemi bërë deri më tani dhe që ka qenë fituese i konzercium jashtëzakonisht i suksesshëm dhe opinioni edhe vendor edhe ndërkombëtar është shumë mbështetës dhe shumë pozitiv për transparencën të paparë jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon.

Ky proces që na fillim është shoqëruar me transparencë të plotë. Përveç kësaj USAID, Komisioni Evropian, Banka Botërore, kanë qenë monitorues të përhershëm të këtij procesi. Siç jeni në dijeni projektet kontraktuale të partneritetit publiko- privat, i nderuari Tali, janë mjete shumë komplekse dhe kanë efekte afatgjata.

Në këtë drejtim kontrata e partneritetit publiko- privat është një kontratë 20-vjeçare, ku partneri privat duhet të dizajnojë, ndërtojë, financojë dhe operojë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Çështja e kontratës... të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës është debatuar shumë herë. Po ashtu edhe nga Komiteti Ndërmintor i projektit është potencuar se tashmë është përzgjedhur fituesi në bazë të procedurës paraprakisht të aprovuar publike dhe transparente. Dhe kjo është bërë në bazë të përqindjes bruto të hyrave që ai do të paguajë ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe e cila mesatare është 39.42% për 20 vjetët e ardhshme.

Gjithashtu duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me objekt shumë të rëndësishëm infrastrukturor për vendin, Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Komitetit drejtues ndërmintor është siguruar që kushtet e kontratës janë tejet specifike, por gjithmonë sipas standardeve të vendeve të Bashkimit Evropian, sipas standardeve perëndimore.

Është edhe praktikë e zakonshme ndërkombëtare, moderne, që në rastet e tilla në implementimin e partneriteteve publiko – private, ofertuesi i përzgjedhur duhet t'i përmbushë një mori kushtesh paraprake para se kontrata të bëhet efektive.

Tashmë kemi hyrë në fazën ku operatori privat ka filluar përmbushjen e këtyre kushteve siç janë: themelimi i korporatës në Kosovë, me qëllim të veçantë për menaxhimin dhe operimin në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, përzgjedhja e dizajnit për terminalin e ri do të jetë 3 herë më i madh se sa terminali ekzistues, përgatitja e raportit mbi ndikimin mjedisor, kontraktimi i punëtorëve të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, sigurimi i financimit për ndërtimin e infrastrukturës së re.

Besoj, i nderuar Tali, se tashmë e ke të qartë se kontrata ende nuk është nënshkruar dhe nuk do të nënshkruhet derisa të përmbushen këto kushte të lartcekura dhe me nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës, ky dokument do të bëhet i njohur për opinionin në kuptimin e gjerë dhe natyrisht edhe juve do t'ju jepet në dispozicion, por gjithmonë plotësisht në përputhshmëri me kontratat e standardeve më të larta evropiane, ndërkombëtare, moderne.

Kontrata pritët të nënshkruhet më 12 apo 13 gusht, varësisht nga negociatat a do të përmbyllen më 12 apo 13-in, ndërsa sa i përket kompanisë fituese apo konzerciumit, pritët që brenda 20 ditëve pas kësaj date t'i plotësojë, jo pritët por do t'i plotësojë në mënyrë që kontrata të jetë e plotfuqishme dhe të fillojë punimet.

Ka pasur opinione edhe të ndryshme edhe sa i përket autostradës dhe ndryshimit të trasesë, kam mbetur borxh të sqaroj, por dua të them, ideja për ndryshimin e trasesë, sepse projekt për autostradën në Parlamentin e Kosovës deri tani nuk ka ardhur, ai projekt do të silllet në Parlamentin e Kosovës, do ta sjellë, të jeni të sigurt.

Qëllimi i ndryshimit të trasesë është ky, interesi ekonomik, nëse ndryshohet traseja, do t'i kemi kursime rreth 400 milionë euro dhe qytetari i Kosovës do të humbasë vetëm 6 minuta më tepër udhëtim e buxheti i Kosovës ka nevojë për ato 400 milionë euro. E di se janë të shtrenjtë 6 minuta, por, në kushtet, rrethanat e krizës ekonomike globale, mendoj se edhe unë do ta prezantoj qëndrimin tim, propozimin tim të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin e trasesë, që t'i kursejmë 400 milionë euro, natyrisht me koston 6 minutshe që do t'i kushtojë në kohë qytetarit të Kosovës.

I nderuari zoti Tali, gjithashtu do të vazhdojmë dhe jemi në proces shumë të mirë, të qartë për privatizimin e Distribuimit të KEK-ut, gjithashtu edhe të privatizimit të PTK-së. Unë e ftoj Komisionin Parlamentar, sot, sinjerisht që t'i përgjigjet ofertës së tregut të lirë të transparencës, të procesit të privatizimit dhe Komisioni Parlamentar i jep mundësinë Parlamentit të Kosovës, të debatojë për atë projekt dhe të marrë vendimin merit. Vendimi i juaj do të jetë udhërrëfyes për Qeverinë që të përmbillet brenda këtij viti.

Gjithashtu edhe për Termocentralin "Kosova e Re" do të vazhdohet dhe është duke u respektuar në përpikëri agjenda edhe ditore e punës. Faleminderit shumë!

Drejtimin e mbledhjes e merr anëtar i Kryesisë, zoti Eqrem Kryeziu.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!
Zoti Tali, a keni pyetje shtesë? Zotit Tali, mikrofonin.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Po, unë të pyeta kësaj radhe për kontratën për Aeroportin. Nuk ke hapur debat asnjëherë për autostradën dhe do të duhej të hapni debat në Kuvend. Sidoqoftë, unë shpresoj që atë kontratë do ta publikoni e nuk do të vazhdoni ashtu, po them edhe një herë, se kur e kemi pas privatizuar Ferronikelin, po këto fjalë të bukura që po i thua ti, i kanë pas thënë disa të tjerë, bile edhe një njeri shumë i popullarizuar, siç është Christofer Dell sot, një farë Jakim Ycker, që kosovarët e kanë harruar, ishte ndër promotorët e privatizimit të Ferronikelit dhe tash na doli se po ia japim bakshish Ferronikelit çdo vit nga 20 milionë e herë 30 milionë euro. Shpresoj se atë do ta publikoni, sepse kemi të bëjmë me një kontratë të partneritetit publiko – privat, domethënë me theks publike, që duhet opinioni kosovar të njoftohet për çdo pikë dhe presje edhe shpresoj që do ta mbani fjalën, më 12 dhe 13 gusht.

Sa i përket autostradës, unë të ftoj që ta hapësh debatin siç duhet në Kuvend, është dashur të hapet para se të filloni punën...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Tali!
Zoti kryeministër,

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë dëshiroj vetëm të sqaroj, zoti Tali. Keni plotësisht të drejtë në kërkesën tuaj për debat dhe kjo është në agjendën e Qeverisë për t'u sjellë mundësia më e mirë për të proceduar që të kemi debat edhe për privatizimin e PTK-së dhe sot debati varet nga vendimi i Komisionit Parlamentar për këto çështje. Për këtë arsye edhe ftova Komisionin Parlamentar, pa

dallim partie, që t'i japë mbështetje këtij procesi, të sillet ai projekt për të diskutuar në Parlamentin e Kosovës dhe të marrë vendimin Parlamenti. Nuk është vendimi im, vendimi paraprak është i Parlamentit, pastaj Qeveria vazhdon. Në të njëjtën kohë edhe sa i përket autostradës të jesh i bindur se ka munguar debati prej inicimit të këtij projekti, unë do ta sjell shumë shpejt. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Tani e ka radhën pyetja e deputetit Naim Rrustemi, për ministrin Justina –Pula – Shiroka. Urdhëroni, Naim!

NAIM RRUSTEMI: Unë do ta lexoj pyetjen e nëse dikush prej Qeverisë, sepse besoj që i përket të tërë Qeverisë, dëshiron të përgjigjet, le të përgjigjet.

Duke pasur parasysh deklaratat publike të ministrit Bajram Rexhepi për vendosjen e normalitetit në vend, në veri të Kosovës, disi më solli në situatë ose të mendoj se veprimet e Qeverisë janë të sinkronizuara dhe duke kujtuar gjendjen e Elektroprivreda Serbia, u bëra merak që është e njëjta situatë, prandaj po ja përsërisë pyetjes ministres Justina Pula. Në muajin tetor 2009, KEK-u mori vendim për të ndërprerë furnizimin me rrymë në pjesën veriore të Kosovës. Vetëm një ditë, pasi kryeministri i Kosovës doli publikisht në skemë dhe, siç u shpreh atëherë, me ftesë që qytetarët të respektojnë ligjin dhe vendimet që kontribuojnë në kthimin e normalitetit në vend, dhe të nesërmen Elektroprivreda Serbia merr nën kontroll Vallaqin dhe depërton edhe në shërbimin e qytetarëve në veriun e Kosovës. Pyetja ime është: A janë veprime të tilla pjesë e politikave qeveritare dhe pjesë e heshtur e strategjisë për veriun e Kosovës, sepse është e vërtetë se rryma po paguhet në Mitrovicë, po e arkëton Elektroprivreda Serbije.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Naim!

Kryeministri do të përgjigjet.

KRYMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar deputet gjithashtu për pyetje!

Politika e Qeverisë edhe për veriun është shumë e qartë, respektimi i plotë i Kushtetutës dhe i ligjeve të Republikës së Kosovës dhe dokumentit të presidentit Ahtisari. E para ka qenë dhe është ushtrimi gradual i ligjshmërisë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. E kemi hapur zyrën e cila sot është që funksionon si Zyre e Republikës së Kosovës, ku punojnë autoritetet e shërbyesve civilë, por edhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe janë në shërbim të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, pavarësisht dallimit etnik, do të vazhdohet me projektet e rëndësishme për formimin e komunës së re, gjithashtu për organizimin e zgjedhjeve të lira në tri komuna dhe investimet socio-ekonomike. Ky është projekti ynë, kjo është strategjia jonë e koordinuar ngusht me gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

A keni pyetje shtesë? Zotit Naimi, mikrofonin.

NAIM RRUSTEMI: Unë po i referohem vetëm deklaratës publike të kryeministrit të Kosovës, ku kërkon që të kthehet normaliteti në vend, por të nesërmen, menjëherë të nesërmen dhe kjo s'do koment se sigurisht se veprimet kanë qenë të sinkronizuara dhe po frikohem edhe tash që deklaratat kaq pompoze, publike mos janë të sinkronizuara, nuk po them se janë, sepse fjalët e mira po shihet, po shihen fjalët e mira, por veprat po dalin të këqija.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Zoti kryeministër.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë definitivisht, duke vlerësuar opinionet mendoj se është më tepër një konspiracion që askush s'mund ta kuptojë dhe lexojë se sa realitet, por Kosova ka ekzistuar, ekziston dhe do të ekzistojë për jetë e mot, shtet i pavarur, sovran, me integritet territorial të paprekshëm, të pacenueshëm dhe të njohur ndërkombëtarisht. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, kryeministër!

Në radhë është deputeti Rexhep Hoti, pyetje për ministren Edita Tahiri, a dëshironi ta lexoni pyetjen, zoti Rexhep?

REXHEP HOTI: Pra, po e lexoj se s'mund t'i zëmë këta ministrat kurrë.

Pyetja ka qenë për ministren: Qeverisja elektronike, është një projekt që është edhe standard evropian. Ku kanë shkuar procedurat, sepse është premtuar se do të qeverisim në mënyrë elektronike, ndërkaq sipas informacioneve që i kemi në terren, ka probleme sa i përket personelit. Ne deshëm të dimë se çfarë është duke ndodhur me këtë qeverisjen elektronike, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të kenë mundësi që të marrin shërbime në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe mos të ngarkohen me udhëtime dhe pagesa shtesë. Ndoshta ministrja do ta kuptojë këtë pyetje dhe do të përgjigjet kur do të ketë kohë. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Kryeministri do të përgjigjet menjëherë. Faleminderit!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, deputet!

Ne jemi duke vazhduar me angazhimet tona që të kemi me të vërtetë një sistem elektronik në përputhshmëri me standardet më të larta perëndimore edhe në Republikën e Kosovës, një sistem ky që ka munguar në të kaluarën. Kemi filluar me angazhimet për prokurimet elektronike, gjithashtu për qeverisje elektronike, për kompjuterizimin e shkollave të Republikës së Kosovës dhe jemi duke punuar me modelin më të përsosur mund të them edhe të përvojës së Estonisë. Natyrisht se kërkohet edhe kohë dhe mjete se këto nuk janë gjëra që mund të bëhen edhe aq lirë, por jemi duke kursyer që të investojmë në të ardhmen elektronike të Republikës së Kosovës. faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Zoti Hoti, a keni pyetje shtesë? Zotit Hoti, mikrofonin.

REXHEP HOTI: Po, nuk jam i kënaqur me përgjigjen. Në fakt, qeverisja elektronike është dashur të bëhet dhe jo tash të na thuhet se do ta bëjmë, se do ta bëni. Unë e kuptoj që duhet të thoni, nuk jam i kënaqur fare me teknologjinë informatike edhe përgjigja është shumë jo e saktë. Meqë hyre në atë drejtim, ky ka qenë prioritet i qeverisjes së Partisë Demokratike, edhe e ministrit të Arsimit. Nuk ka ndodhur asgjë në këtë drejtim, të paktën jo në atë që është premtuar, prandaj dëshirojmë të kemi përgjigje substanciale këtu e jo të jepen llafe të bukura. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti!

Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë ndihem tepër mirë për opinionet që po prezantohem, po ndihem shumë krenar që edhe në fshatin tuaj është instaluar sistemi elektronik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Edhe një herë, zoti Rexhep Hoti, pyetje për ministrin Haki Demolli. Urdhëroni, zoti Rexhep.

REXHEP HOTI: Faleminderit!

Sa i përket Krushës, e kemi bërë vetë, se po ta kishim pritur Qeverinë, do të kishim mbetur në rrugë.

Zoti ministër, pyetja për juve: Dihet se transporti i të burgosurve është një çështje bukur e ndjeshme e cila përcillet me mjete dhe transporte dhe specifike, madje, sipas të dhënave të llogaritura në këtë drejtim me mjete transportuese të kësaj natyre mund të ketë brenda ditës deri në 700 kilometra, është një çështje shumë e ndjeshme. Dëshirojmë të dimë se sa është kompletuar Njësia e Transportit Përcjellës dhe Njësia e Transportimit të Burgosurve dhe si është pajisur stafi i sigurisë përcjellës me mjetet e komunikimit dhe me mjete tjera përcjellëse të nevojshëm për të kryer një shërbim të tillë? Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Lidhur me pyetjen e deputetit të nderuar, zotit Rexhep Zoti, së pari do të theksoja se në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, vepron Njësiti për Transportin e të Burgosurve. Ky njësiti është themeluar në vitin 2008 dhe është kompetent për transportimin e të gjithë personave të privuar nga liria në territorin e Republikës së Kosovës. Njësiti vepron sipas dispozitave të Rregullores së brendshme për punën e njësitet dhe aktualisht numëron 152 pjesëtarë të stafit. Baza qendrore e njësitet është në Qendrën Korrektuese të Lipjanit, kurse pjesa tjetër e rëndësishme e tij ndodhet në Qendrën Korrektuese të Dubravës, ku punojnë, përveç koordinatorit edhe 35 oficerë korrektues. Mirëpo, edhe qendrat të tjera të paraburgimit kanë në radhët e veta degët e Njësitet për Transportin e të Burgosurve, në kuadër të cilave veprojnë kryesisht nga 15 oficerë korrektues. Njësiti ka gjithsej 16 vetura, 8 prej tyre janë për transportin e të burgosurve, ndërsa 8 të tjera për përcjelljen e të burgosurve. Pjesëtarët e këtij njësiti iu kanë nënshtruar trajnimeve profesionale në lëmi të caktuara, si për shembull në fushën e përdorimit të armëve me tytë të shkurtër dhe atyre me tytë të gjatë, pastaj në rrafshin e përdorimit të sprejit neutralizues, në sferën e taktikave mbrojtëse, prangimit të personave dhe mbrojtjes nga afërsia, trajnimeve të specializuara për përcjelljen e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe rrezikshmëri jashtëzakonisht të lartë.

Shumica e pjesëtarëve të këtij njësiti janë të pajisur me armë me tytë të shkurtër e disa prej tyre edhe me tytë të gjatë, pastaj me pranga, sprej neutralizues dhe me mjete tjera teknike të përshtatshme për mbrojtje personale. Ky njësiti gjatë këtij viti do të pajiset edhe me 5 vetura për transportin e të burgosurve.

Dhe, në fund lidhur me punën e Njësitet për Transportin e të Burgosurve të Shërbimit Korrektues të Kosovës, do të potencoja, se që nga themelimi i tij më datën 1 korrik të vitit 2008 e deri më tani, ka bërë përcjelljen e 12.017 të burgosurve, duke mos regjistruar as të vetmin incident. Ju faleminderit, për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër,

Zoti Rexhep Hoti, a e doni fjalën? Jo. Faleminderit!

Shkojmë më tutje. Radhën e ka deputetja Zylfije Hundozi, pyetje për ministrin Haki Demolli, gjithashtu.

ZYLFIJE HUNDOZI: Menjëherë pas luftës, Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë hapa për t'i licencuar mjekët në Kosovë dhe sot asnjë mjek nuk punon pa licencë. Përkundrazi, në fushën e ndërtimtarisë nuk është licencuar asnjë inxhinier i ndërtimtarisë e as arkitekt, si pasojë e kësaj kemi

kaosin urbanistik, sidomos në Prishtinë, sepse me ndërtimtari janë marrë të gjithë, pos atyre që janë ekspertë. Kanë kaluar tash 10 vjet me këtë gjendje, a nuk mendoni se është koha e fundit që kjo situatë të ndërpritet dhe inxhinierët dhe arkitektët të licencohen? Pyetja për ministrin: Kur do të bëhet licencimi i inxhinierëve dhe arkitektëve?

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Hundozi, Zoti ministër.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari kryesues,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar deputetë, ministra,

E nderuara deputete zonja Hundozi,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka filluar përgatitjet për organizimin e provimit profesional dhe licencimin e inxhinierëve të ndërtimit dhe arkitektëve pas kompletimit të udhëzimeve administrative duke u bazuar në Ligjin e ndërtimit 2004/15. Në këtë ligj ka pasur disa përzierje të kompetencave në mes të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në fushën e ndërtimit. Andaj, edhe për këtë është paraqitur nevoja e amendamentimit ose ndryshimit të Ligjit të ndërtimit të cilën e kemi në proces e sipër ku në këtë pikë e kemi edhe përkrahjen e USAID-it, të cilët i kanë angazhuar disa ekspertë të huaj për përkrahje profesionale të cilët janë duke punuar shumë ngushtë me stafin tjetër vendor në hartimin e këtij ligji në mënyrën sa më profesionale.

Gjithashtu, si kërkesë e Ligjit të ndërtimit, neni 18, paragrafi 3 ka dalë edhe Udhëzimi administrativ nr. 06/5 për provimin profesional për teknik, inxhinierë të diplomuar të ndërtimtarisë, të arkitekturës, elektroteknikës dhe makinerisë në lëmin e ndërtimit, si dhe në bazë të nenit 21, paragrafi 5 i Ligjit të ndërtimit e parasheh udhëzimin administrativ, i cili është hartuar me numër 05/5 për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e projektimit, ndërtimit, mbikëqyrjes profesionale dhe revidimit. Aktualisht ne kemi formuar grupe punuese të cilat e kanë për obligim të rregullojnë këtë sferë ku edhe në këtë rast jemi në mbështetje të përhershme nga USAID-i dhe keni nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me ta për përkrahje profesionale në sferën e licencimit të arkitektëve dhe inxhinierëve të ndërtimit.

Paralelisht me ndryshimin e Ligjit të ndërtimit është duke u punuar edhe në sferën e licencimit të inxhinierëve dhe arkitektëve dhe planifikojmë që gjatë këtij viti të përfundojmë të gjitha punët të cilat kanë të bëjnë me hartimin e programeve, materialeve për inxhinierë dhe arkitektë, procedurën e licencimit, pyetësorët, trajnimet e të tjera.

Dëshiroj t'ju informoj në këto grupe punuese janë të përfshira të gjitha institucionet e Qeverisë, pastaj është i përfshirë edhe Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës, shoqëria civile përmes shoqatave të inxhinierëve dhe arkitektëve si dhe ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Zonja Hundozi, a keni pyetje shtesë? Zonjës Hundozi edhe një herë ia jepni fjalën.

ZYLFIJE HUNDOZI: Po, edhe një pyetje të shkurtër. Po shoh që jeni përpjekur mjaftë, por këto përpjekje të juaja që 6 vjet s'kanë dhënë rezultat. Sa kohë ju vyen që kjo përnjëmend të realizohet?

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, faleminderit!

Është një fushë shumë komplekse, po gjithashtu ka ndodhur edhe një përzierje edhe në mandatin e kaluar edhe ju jeni dhe ish deputete, ku përmes Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Mjedisit, përmes dy ligjeve ka ndodhur disa përzierje edhe kompetencave, kështu që jemi në fazën e qartësisë së kompetencave, por gjithashtu jemi në fazën e përgatitjeve. Besojmë që deri në fund të vitit edhe me aprovimin e ligjit të ri do të përfundohet edhe licencimi ose do të fillohet licencimi i inxhinierëve.

KRYESUESI. Faleminderit, zoti ministër! Zonja Hundozi, tani e keni radhën ta lexoni atë pyetjen e parë, se e ndërruat renditjen edhe unë e përজেva drejtësinë me ambientin.

ZYLFIJE HUNDOZI: Pyetja e dytë është për ministrin e Drejtësisë. Ekzistojnë 54 mijë lëndë nga gjykatat, por që nuk ekzekutohen, shumica prej tyre 85% janë lëndë të kontesteve civile. Kjo ka bërë që populli ta humbë besimin në gjykata, por kjo nuk është pasojë e vetme, si pasojë e kësaj mungojnë edhe investimet e huaja direkt, pra diçka që do ta dëmtojë edhe më tutje ekonominë tonë, edhe pse Ligji për procedurën përmbarese është kryer moti në këtë Parlament, është e qartë që ai nuk po zbatohet.

Zoti ministër, unë e di që ju e keni marrë postin shumë frikë, po ju pyes se çka keni ndërmarrë në ndërkohë, se nëse nëpër gjykata çdo gjykatës i ka edhe nga 2000 lëndë të cilat po presin të ekzekutohen po edhe ato që janë krye s'po ekzekutohen, atëherë domethënë gjykata është në veprimin zero.

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

I nderuar kryeministër dhe kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

E nderuara deputete Hundozi,

Fillimisht do t'ju falënderoja për pyetjen dhe për interesimin tuaj lidhur me gjendjen aktuale në sistemin e përmbarimit në Kosovë.

Sikurse ju, deputetë të nderuar edhe unë jam i vetëdijshëm se ekzekutimi i lëndëve gjyqësore në Kosovë, sidomos në lëmin civil, viteve të fundit është ballafaquar me vështirësi të shumta e që për pasojë ka numrin e madh të lëndëve të papërmbaruara. Me qëllim të përmirësimit të kësaj gjendje jo të mirë, Ministria e Drejtësisë i ka dhënë vetes për detyrë reformimin e tërësishëm të sistemit të përmbarimit në Kosovës. Në këtë drejtim me strategjinë legislative të vitit 2010, ndër të tjera, është paraparë edhe plotësimi dhe ndryshimi i ligjit në fuqi për procedurën e përmbarimit. Madje duhet theksuar se amendamenti i këtij ligji është njëri prej prioriteteve të Ministrisë së Drejtësisë për periudhën e dytë të vitit 2010. Me këto ndryshime dhe plotësime urgjente synohet të zvogëlohet mundësia e zvarritjes së panevojshme të procedurave përmbarese. Si rezultat i reformave, Ministria e Drejtësisë planifikon akceptimin e zgjedhjeve të reja në rrafshin e përmbarimit, të cilat tani në praktikohen në shtetet e ndryshme të botës, si për shembull aplikimi i sistemit miks të përmbarimit që do të përbëhet nga sistemi shtetëror dhe ai privat apo aplikimi i sistemit tërësisht privat të përmbarimit.

Konform legjislacionit të ri do të përcaktohet themelimi i zyrave të përmbarimit privat dhe mekanizmave për funksionalizimin e sistemit të ri të përmbarimit, përfshirë këtu edhe mekanizmat për

ushtrimin e një kontrolli efektiv ndaj përmbauesve në përgjithësi e me theks të posaçëm ndaj përmbauesve privat.

Sipas legjisllacionit të ri kreditorët, respektivisht qytetarët do të kenë mundësinë e zgjedhjes për përmbauesin e vendimeve me të cilat në instancë të fundit është vendosur çështja e tyre gjyqësore. Pra, ata do të mund të zgjedhin ndërmjet përmbauesve privat dhe atyre shtetërorë.

Po ashtu duhet theksuar se problem në vetë në krijimin e kësaj gjendje ka paraqitur edhe mungesa e stafit të mjaftueshëm profesional në sektorin e përmbaimit. Shpresojmë se ky problem do të zgjidhet përmes reformës së tërësishme që është duke u bërë në gjyqësorin e Kosovës, ku parashihet edhe shtimi i gjykatësve në përgjithësi dhe i gjykatësve përmbaues në veçanti, si dhe personeli tjetër ndihmës të kualifikuar në këtë

KRYESUESI: Faleminderit!

A keni pyetje shtesë, Zonja Hundozi?

E ka fjalën zonja Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti ministër, unë ju kuptova shumë mirë, por reforma e gjyqësorit do të zgjatë një kohë shumë të gjatë, kështu që cili është afati kohor për këtë situatë konkrete, se 54 mijë lëndë që nuk janë ekzekutuar, edhe pala tjetër 54 mijë, janë 100 mijë konflikte potenciale të njerëzve në Kosovë, është çudi sa durim ka populli ynë që deri tash nuk e ka marrë situatën në dorë të veta. Domethënë, është i domosdoshëm sundimi i ligjit.

KRYESUESI: Faleminderit, për këtë koment!

Zoti ministër!

MINISTRI HAKI DEMOLLI: Unë, së pari nuk do të isha pajtuar me thënien tuaj se puna e gjyqësorit vlerësohet me zero, që e thatë në fillim. Së dyti, sa i përket afatit kohor, ne këtu në këtë Parlament, në këtë Kuvend, në dëgjimin e parë e kemi aprovuar Ligjin mbi gjykatat e Kosovës, i cili ligj paraqet bazën për reformimin e sistemit gjyqësor të Kosovës e konform atij ligji reformat diku do të fillojnë në vitin 2011, kurse finalisht apo përfundimisht, realizimi i tij do të fillojë në vitin 2013. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani radhën e ka zoti Ismail Kurteshi, edhe pyetja e parë e tij është për ministrin Rashiq, a doni ta lexoni pyetjen, zoti Kurteshi?

Urdhëroni, zoti Kurteshi!

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Përsëndetje për të gjithë!

Meqë ministri mungon, unë do ta shtyj këtë pyetje për herën tjetër kur do të jetë ministri prezent.

KRYESUESI: Okej, faleminderit!

Gjithashtu, është radha e juaj tani, pyetje për ministrin Stavileci.

Urdhëroni, zoti Kurteshi!

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Edhe një herë përsëndetje për të gjithë të pranishmit!

Zoti ministër,

Në Kosovë, sipërfaqe të mëdha të tokës pjellore nuk po punohen, përkundër faktit se ne nuk i plotësojmë nevojat tona me prodhime bujqësore dhe se kemi shumë të papunë që mund të punësohen në këtë sektor. Sa ka ndikuar në rritjen e prodhimit bujqësor dhe në punësim privatizimi i gjertanishëm i tokave bujqësore? Sa po punohen tokat e privatizuar dhe e ka Ministria juaj strategji për ndërrimin e kësaj gjendje, gjegjësisht stimulimin ose edhe detyrimin e pronarëve të tokave që ta punojnë tokën e tyre ose të njëjtën t'ia japin në shfrytëzim apo me qira të interesuarve të tjerë që dëshirojnë për ta punuar tokën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuar kryesues,

I nderuar kryeministër, kolegë qeveritarë,

Të nderuar dhe të çmuar deputetë,

AKP-ja në bazë të Ligjit të privatizimit në Kosovë është një trup i pavarur dhe administron me tokat bujqësore në pronësi shoqërore, ndërmarrje me pronësi publike dhe asetet në pritje të privatizimit. Për të gjitha tokat bujqësore të privatizuar vlejnë të gjitha ligjet në fuqi sikurse edhe për pjesën tjetër të tokave me pronësi private. Ndërkaq, nga ana tjetër Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka përgatitur infrastrukturën ligjore dhe veprimet konkrete në kontekstin e reformës së tokës dhe ato janë: Ligji mbi tokat bujqësore dhe udhëzimet administrative përcjellëse që derivojnë nga ky ligj, projekti i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës bujqësore i financuar nëpërmjet fondeve IPA të Komisionit Evropian, vazhdimi i përfundimit të konsolidimit të tokave bujqësore janë në vazhdimësi për këtë vit dy projekte për komunën e Vushtrisë dhe të Obiliqit, inicimi dhe zhvillimi i projekteve të reja të konsolidimit në baza vullnetare, përgatitja e strategjisë për konsolidimin e tokës 2010 – 2020 është duke u përgatitur plani i veprimit si dhe kostingu përcjellës, si dhe përgatitja e planit të veprimit për mbrojtjen e tokës bujqësore. Të gjitha këto veprime paraqesin hapa konkret që do të adresojnë çështjen e shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës bujqësore dhe ne do të propozojmë programin për tokat bujqësore i cili do të përfshijë të gjitha palët e interesit dhe analizën përkatëse të hollësishme për tokat të cilat priten të privatizohen dhe nga kjo sipërfaqe të krijohet fondi i tokës, i cili mund të jepet me qira afatshkurtër dhe afatmesme si dhe privatizimi i tokave bujqësore të klasës të cilësisë I deri në IV, që janë në sistemin e ujitjes dhe të konsolidimit me spinof special.

Përveç kësaj, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural zbaton planin e zhvillimit rural dhe bujqësor 2009 – 2013, në kuadër të këtij plani jemi duke zbatuar programin e grandeve investuese për sektorin e prodhimtarisë së qumështit, për sektorin e hortikulturës, si dhe kemi hartuar rregulloret për implementimin e projektit të pagesave direkt për sektorin e kafshëve të imta, për sektorin e gjedheve dhe për sektorin e drithërave, kultura e grurit, konform procedurave të programit IPAR.

Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e këtyre projekteve për vitin 2010 ka ndarë 5 milionë euro dhe po ashtu unë ju informoj dhe besoj se edhe ju jeni të informuar se ne tash së fundi kemi edhe një grand për herë të parë nga Komisioni Evropian që është ndihmë e drejtpërdrejtë sektorit të bujqësisë, në veçanti industrisë përpunuese, pra prodhimtarisë sekondare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Zoti Kurteshi, a keni pyetje shtesë? Urdhëroni, zoti Kurteshi!

ISMAIL KURTESHI: Zoti ministër, a mund të na thoni nëse i keni këto shënime, sa për qind e tokave pjellore këtë vit është punuar në Kosovë? Faleminderit!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Përsëri edhe në këtë pyetje, ju e dini se sistemi statistikor edhe statistikat janë shumë të rëndësishme, janë të rëndësishme në veçanti edhe për sektorin e bujqësisë. Ne duhet të kemi një sistem të integruar të administratës dhe të kontrollit, i cili përfshin sisteme të ndryshme që janë pjesë e këtij sistemi integral, ku janë regjistri i kafshëve, regjistri i fermave, regjistri i vreshtave, po ashtu edhe parcelat e tokës e në të gjithë këto projekte ne jemi duke punuar. Për sa i takon sipërfaqeve, ju siç e dini, në kuadër të Ministrisë që unë drejtoj kemi një departament të politikave dhe të shërbimeve statistikore, por po ashtu edhe me drejtoritë komunale unë kam kërkuar që deri sa të realizohen këto projekte ne megjithatë nëse jo shifra qind për qind të sakta të kemi shifra shumë më të përafërta se sa punohet toka. Besoj se tash jemi, siç e dini, në kuadër të aktiviteteve të korrijeve dhe nga ajo çfarë është bërë vitin e kaluar sa është subvencionuar sipërfaqet e tokës të mbjella me grurë me qenë se jemi aktualisht në këto, varirojnë shifra të ndryshme të cilat sillen mbi 70 mijë. Dhe, në bazë të kësaj jemi duke i bërë këto subvencione, mirëpo unë kam kërkuar nga të gjitha drejtoritë komunale nga drejtoritë përkatëse për bujqësi që të sjellin të dhëna të sakta statistikore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Në radhë është zonja Sanije Aliaj, ka një pyetje për ministrin Shala. A doni ta lexoni pyetjen, pasi që ministri nuk është këtu? Zonja Sanije.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra dhe të nderuar deputetë, Zoti ministër, në Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm, pasqyrohen të dhënat se Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, prej 59 njësive të auditimit të brendshëm, ka pranuar 56 raporte ose shprehur në përqindje 95%. Njësitë e auditimit të brendshëm që nuk kanë raportuar janë: Agjencioni Kosovar i Pronës, Agjencioni Kosovar i Privatizimit dhe komuna e Shtërpcës. Pyetjen e kam bërë për ministrin, për të ngritur përgjegjësitë e këtyre 2 – 3 organizatave buxhetore që t’i respektojnë detyrat e tyre për të cilat janë formuar.

Zoti ministër,

Pasi Ministria për Ekonomi dhe Financa është themeluese e Njesisë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, cilat janë masat që ju keni ndërmarrë ndaj këtyre organizatave buxhetore për mos raportim dhe për mos krijimin e mundësive për realizimin e auditimit të brendshëm. Nuk di në çka asocon kjo, por rubrikat në Raportin e auditimit të brendshëm për këto tri organizata buxhetore janë të zbrazura. Kjo nuk iu bën nder institucioneve të Kosovës, Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Sanije!

E shoh se ministrat, përkatësisht kryeministri dhe zëvendëskryeministrat do t’ia lënë radhën zotëri Shalës për t’u përgjigjur.

Atëherë, kalojmë te pyetja tjetër dhe pikërisht është zoti Naim Rustemi, ka pyetje për të njëjtin ministër, nuk është këtu. A doni ta lexoni pyetjen, zoti Rustemi?

NAIM RRUSTEMI: Edhe pse ministri i Ekonomisë dhe Financave nuk është këtu, po kjo pyetje i përket tërë Qeverisë, me fjalë të tjera janë politika qeveritare lidhur me menaxhimin e ndërmarrjeve publike, ka të bëjë me një kod të etikës që është miratuar në prill një vit e gjysmë, Kodi i Etikës për qeverisjen korporatave, me të cilën në njërin prej pikave definohet shumë saktë dhe qartë që është politikë mirë, adapt për jetën moderne, për qeverisjet moderne të korporatave në të cilën tekstualisht saktësohet, se anëtarët e bordit nuk kanë të drejtë të kenë vetura, telefona, zyra, nuk kanë të drejtë të kenë brenda ndërmarrjeve publike. Kurse ne të gjithë të tjerët për çdo ditë i shohim anëtarët e bordeve duke u shëtitur nëpër qytetet e veta të lindjes, nëse më kërkohet do të them edhe në Vushtrri,

Mitrovicë e në Prishtinë. Edhe pyetja ime drejtuar ministrit është, nëse dikush tjetër do të shpjegojë le të shpjegohet- Pse është miratuar ky kod i etikës dhe qeverisjes korporatave?

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rrustemi!

Po e shoh se do të duhej të kënaqeni me përgjigjen e ministrit Shala më vonë, atëherë do ta ndërrojmë pak radhën dhe do t'ia japim fjalën zotit Kervan, që ka një pyetje për Fehmi Mujotën, megjithëse ai do ta lëshojë Parlamentin. Urdhëroni, zoti Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Sayın Bakan,

Türk topluluğunun, Kosova Güvenlik Güçlerine (FSK) göstermekte olduğu ilgisiden yola çıkarak, bu parlamenter soruyu sizlere yöneltmeyi uygun gördüm.

Kosova Cumhuriyetinde eğitimin Arnavut, Türk ve Boşnak dilleri olmak üzere, üç dilde yapıldığını göz önünde bulundurarak, Türk topluluğu, sözlü ve yazılı yapılan kabul sınavlarında kendilerini daha iyi ifade edebilmeleri amacıyla, adayların başvuru formu, kabul sınavları ve yoklama metinlerinin Türk dili üzere de hazırlanmasını talep etmektedir.

Merkezi düzeydeki resmi dillerin konumu ile ilgili ayrıntılarının bilincindeyiz, ancak var olan yasal haklarımızı göz önünde bulundurarak ve Türk topluluğunun, Kosovada Türk dili üzere eğitim görmesi itibarıyla, Kosova Güvenlik Güçlerine sözlü ve yazılı kabul sınavlarının Türk dili üzere de yapılması talebini sizin bakanlığınız çerçevesinde faal olan Topluluk Konuları İdare Dairesine ilettiyseniz de, bu konuda başvuruda bulunduysam da, bugüne kadar yanıt alamadım ve dolayısıyla bu doğrultuda hiçbir olumlu gelişmenin kaydedilmediğini hatırlatmak isterim.

Türk topluluğunun Kosova Güvenlik Güçlerine olan ilgisini önemseyerek ve göz önünde bulundurarak, bu yönde herhangi bir önlemin alınıp alınmayacağını ve Türk topluluğu adına tarafımdan ortaya atılan talebin karşılanıp karşılanmayacağını sormak istiyorum.

Saygılarımla,

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Zoti ministër e kenë fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, kabinet i Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Enis Kervan,

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në procesin e selektimit dhe të rekrutimit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, është shërbyer plotësisht në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovës. Gjithashtu në këtë proces kaq të rëndësishëm të hapur dhe demokratik në kuptimin e konkurrimit për gjithë qytetarët shtetas të Republikës së Kosovës, ka respektuar kriteret, standardet e parapara bashkërisht me NATO-në, që nënkupton që janë standarde unike të NATO- për procesin e selektimit. Kemi bërë disa veprime pozitive në raport me komunitetet pakicë dhe po numërojmë vetëm disa prej tyre.

E para, kemi bërë ekipet mobile të cilat kanë lëvizur gjithandej nëpër Kosovë, në të gjitha vendbanimet ku kanë jetuar komunitetet pakicë. Edhe në Mamushë ekipet tona kanë lëvizur, kanë kontaktuar me qytetarët dhe kanë mundësuar konkurrimin e gjithë atyre që kanë qenë të interesuar.

Po ashtu një veprim tjetër pozitiv në raport me komunitetet pakicë ka qenë ftesa për gjithë ata konkurrues që kanë konkurruar për të qenë pjesëtarë të Forcës së Sigurisë, në procesin e selektimit, që nuk nënkupton që nuk duhet respektuar pastaj kriteret dhe standardet në procesin e mëtutjeshëm të përzgjedhjes për pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ne jemi shumë të kënaqur që nga komuniteti turk në Kosovë, këtë vit kemi pasur 54 konkurrues, prej tyre 20 kanë pasur sukses të jenë pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, nëse e marrim në përqindje, janë rreth 27% nga e komuniteteve pakicë në Kosovë, që janë pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Të gjithë konkurruesve u kemi mundësuar që të kenë mundësinë e përkthimit në gjitha fazat e konkurrimit dhe procedimit të mëtutjeshëm. Dhe mund t'ju sjell dy dëshmi në këtë rast nga dy konkurrues të komunitetit turk që kanë deklaruar se nuk kanë nevojë për përkthim në gjuhën turke, por megjithatë ne në të gjitha fazat e nevojshme të konkurrimit, selektimit dhe përzgjedhjes për të gjithë pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në këtë rast edhe për komunitetin turk, mund të ofrojmë veprime tjera pozitive- lehtësuese për përgjigje me gojë, përgjigje me shkrim dhe përkthim të nevojshëm.

Dhe një dhënë tjetër që ka nevojë ndoshta ta themi këtu në Parlament, është ajo se deri më tani në Forcën e Sigurisë së Kosovës, ka 110 pjesëtarë nga komunitetet pakicë, duke përfshirë fazën derisa nuk e kemi pasur gjeneratën e re të rekrutëve që po e bëjmë këtë vit. Kjo nënkupton se kemi edhe 6.13% të komuniteteve pakicë, pa këtë gjeneratë, ndërsa me këtë gjeneratë që kemi 72 pjesëtarë të komuniteteve pakicë që kanë kaluar në Forcën e Sigurisë së Kosovës, përqindja do të jetë rreth 8...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Në qoftë se keni të domosdoshme të sqaroni deri në fund, atëherë lus regjinë që t'ua lëshoj edhe pak mikrofoni. Faleminderit! Zoti Kervan, a keni pyetje shtesë? Jo. Faleminderit!

Shkojmë më tutje, radhën e ka zoti Driton Tali, dhe pyetja e tij drejtohet kryeministrit Thaçi ose zëvendëskryeministrit Kuçi. Urdhëroni, zoti Tali!

DRITON TALI: Faleminderit!

Do të doja të ishte kryeministri këtu për ta sqaruar një çështje, se u keqkuptua në seancën e kaluar dhe nuk më dha përgjigjen, andej u desh ta përsëris. Sidoqoftë, pyetja ishte me këto grupet e ekspertëve të cilët pati premtuar Qeveria më 8 mars që t'i krijojë për ta zbatuar strategjinë e veriut. Pyetja është kjo: A janë krijuar këto 6 grupe punuese për zbatimin e strategjisë për veriun? Nëse jo, pse jo, dhe nëse po, kur do të fillojnë punën. Do të doja që zoti zëvendëskryeministër ta jap përgjigjen, sepse zoti kryeministër shkoi. Përgjigja e zotit kryeministër në seancën e kaluar ka qenë më shumë për hapjen e zyrës në veri, e asgjë për 6 grupet punuese për zbatimin e strategjisë. Unë, sinqerisht do të doja të marrë një përgjigje konkrete, zyrtare nga Qeveria. Shpresoj se zoti zëvendëskryeministër do të jetë konkret, ashtu siç di të jetë gjithnjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Tali!

Zoti zëvendëskryeministër?

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti Tali,

Do të provoj kësaj radhe të jap përgjigje në pyetjen tuaj, jo në komentet tuaja.

Sa i përket grupeve punuese, janë dhënë disa rezultate, përkundër asaj që ka vështirësi të theksuara edhe nga komuniteti atje, i organizuar, do të thosha në emër të Qeverisë së Serbisë dhe në emër të individëve që merren me veprime ilegale, por megjithatë disa rezultate të para janë evidente.

Grupi për zhvillimin e reformës së pushtetit lokal ka formuar grupin përgatitor komunal për krijimin e komunës së re në veri të Mitrovicës, ashtu sikur parashihet me pakon e presidentit Ahtisari. Grupi për ngritjen e shërbimeve publike tashmë ka hapur zyrën e parë dhe ka filluar të ofrojë shërbime për gjithë qytetarët që jetojnë atje. Natyrisht, këto të dy grupe janë të përkrahura nga grupi për komunikim, i cili në vazhdimësi jep sqarime të nevojshme për opinionin publik.

Grupi i sundimit të ligjit është duke punuar intenzivisht që të japë rezultate konkrete që pritej shumë shpejtë në funksionalizimin e gjykatës atje, në forcimin e zinxhirit komandues të policisë dhe në kontrollin e plotë të doganave.

Ndërsa, Grupi për zhvillimin socio-ekonomik është duke përgatitur modalitete të nevojshme për themelimin e Fondit për zhvillim. Tanimë janë bërë konsultat e para edhe besojmë që shumë shpejtë do të merret një vendim në Qeveri dhe do të procedohet në Kuvend, ku do të alokohen mjetet edhe nga buxheti i Kosovës, por edhe kërkesë nga donatorët ndërkombëtarë.

Natyrisht, që grupet punuese ato që tashmë po e them janë funksionale, përbëhen nga përfaqësuesit e ministrive relevante të Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësues të ICO-s dhe të EULEX-it. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Zoti Tali, a dëshironi të shtoni diçka?

Zoti Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër për këtë lajm ekskluziv, sepse shumë pak opinioni di për krijimin e këtyre 6 grupeve. Ju lutem, a na tregoni se kush janë bartës të këtyre 6 grupeve, a kanë udhëheqës? Shpresoj se janë njerëz, ekspertë të profileve të caktuara që i udhëheqin këto grupe shumë të rëndësishme për implementimin e strategjisë edhe më të rëndësishme për stabilitetin e Mitrovicës veriore. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër,

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

E thashë edhe më herët emrat konkret nuk i kam tash me vete, do t'ua sjelli, pa asnjë merak, por ajo çka po e them është që grupet punuese përbëhen nga përfaqësuesit e ministrive, do të thosha, po e zëmë Grupi për pushtetin lokal, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për Socio-ekonomik, nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe të tjera për sundimin e rendit dhe ligjit nga Ministria e Drejtësisë, ku marrin pjesë edhe përfaqësuesit të ICO-së dhe të EULEKS-it. Unë besoj që nëse ka nevojë diçka edhe herën tjetër mund ta bëni pyetjen e njëjtë dhe do të japi informata shtesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Tani është radha për deputetin Riza Smaka, që ka një pyetje për ministrin Hazirin. Zoti Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues!

Zoti ministër, Haziri,

Ku qëndrojnë shkaqet që Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, të cilën ju aktualisht e administroni,

Një, nuk praktikohet shpallja publike e pozitive të lira në mënyrën e përcaktuar me nenin s'po e them këtu se s'po premtan koha e kemi të limituar,

Dy, nuk aplikohet përshkrimi i detyrave në punë, prapë ka dispozita që për hir të limitit kohor, po janë këtu. Nuk është formuar Komisioni Disiplinor dhe Komisioni i Ankesave në mënyrë të përcaktuar me ligj, dosjet e personelit nuk janë të kompletuara as të sistemuara në mënyrën e përcaktuar me ligj, "I" e vogël, me ligj, dhe statusi juridik i nëpunësve civilë nuk është rregulluar konform dispozitave ligjore, referuar Shërbimit civil të Republikës së Kosovës. Kjo është një pyetje, besoj që e keni lexuar.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Smaka!
Fjalën e ka ministri Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zëvendëskryeministra, kolegë deputetë, ministra,
I nderuari profesor Smakaj,

Ju konfirmoj që pas zgjedhjes sime për të udhëhequr Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, procesi i regrutimit brenda Ministrisë për pozita të lira ka hyrë në fazën e riorganizimit apo ristrukturimit të Shërbimit civil, sepse kjo ministri nuk ka vende të lira, nuk ka pozita të lira, po ka pozita të tepërta të vendeve të punës të angazhuara edhe brenda vetë Ministrisë edhe në institucionet në varësi. Në kuadër të procesit të ristrukturimit duke u bazuar në Urdhëresën administrative 2003 kapitulli II, pjesa 3.8 dhe në strukturën e brendshme të vetë Ministrisë dhe nga dje fatbardhësisht duke u bazuar edhe në Udhëzimin e fundit, Qeveria ka lëshuar në bazë të shërbimit civil të Kosovës, natyrisht kemi marrë të gjitha veprimet e domosdoshme që qojnë në drejtim të rregullimit, ristrukturimit, përshkrimit, ndërtimit të dosjeve për shërbyesit civilë, dhe mbi të gjitha rregullimin e statusit të punonjësve kulturor, kultivuesve kulturor dhe performuesve kulturor. Statusi i ri për punëtorët e institucioneve të kulturës tashmë rregullohet me ligj. Kjo ministri ka marrë mandat që deri në fund të shtatorit ta rregullojë, ta gradojë dhe ta qojë për miratim në Qeveri numrin prej 365 zyrtarëve të lartë që nuk janë më shërbyes civilë të ministrisë. Kontrata mbi vepër që ekziston për këta punonjës nuk është legale, sepse vazhdon me vite të tëra dhe rekomandimi i fundit i auditorit dhe vendimi i Qeverisë është që të zgjidhet përfundimisht ky problem.

Natyrisht është filluar prej pozitës më të lartë zgjedhja e shefit të Personelit, është emërua njëri nga drejtorët i cili i ka plotësuar kushtet, ka përvojën, ka dijen dhe ka mundësinë që ta udhëheqë këtë pjesë, këtë sektor jashtëzakonisht të rëndësishëm, zoti Fatmir Hoxha, ka shkallën e magjistratit të shkencave në administratë publike, përvojën si drejtor i Departamentit të Rinisë dhe tash po punon në realizimin edhe përmbushjen e kësaj detyre ligjore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!
Zoti Smaka, a doni të shtoni diçka?
Zoti Smaka, e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Konsiderata për ministrin edhe për rrethana se në kohë të fundit e ka marrë postin aty, po me qëllimin më të mirë që në këtë ministri, por edhe në ministri tjera të eliminohen paligjësitë dhe parregullsitë. Tash, po e zëmë, shumë kush elaboron me termin kontratë për vepër, kontratë për vepër them shkurt është kur na kontraktujmë me një punë kryes për të na, po e zëmë, lyej këtë ndërtesë apo diçka ngjashëm për ta bërë një riparim teknik. Marrëdhënia e punës nuk bën, nuk krijohet me kontratën për vepër, për shembull ka shumë të tillë me kontratën për vepër, jo në ministrinë e juaj po në numër më të madh të ministrive bëhen abuzime sa i përket punësimeve, më

pastaj nuk shpallen. Ne po e dimë edhe rrethanën tjetër se edhe në shpallje ka kurdisje, po aty s'po hymë, po pse nuk shpallen, ju lutem, vendet e lira, apo jo. Kjo është, domethënë, që bie në sy në hapin e parë apo jo. Unë këto i them, ju lutem i kam të mbështetur në futnota edhe në referenca në...

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti ministër, a dëshironi të përgjigjeni, zoti Haziri, e ka fjalën.

MINISTRI LUTFI HAZIRI: faleminderit!

Ju siguroj që gjitha vendet e lira, pozitat e lira brenda Ministrisë së Kulturës dhe në institucionet në varësi të Ministrisë dhe Qeverisë, pozitat shpallen, janë publike në media elektronike të shkruara dhe në portal të Qeverisë dhe në ueb sajtin e Ministrisë dhe të gjitha mjetet për ta përmbushur detyrën ligjore që përfshin edhe gjuhët, respektimin e gjuhës zyrtare edhe respektimin e gjinisë në disa raste, sepse absolutisht për mua është e qartë respektimi i bazës ligjore dhe respektimi i të drejtave që ky Parlament i ka vendosur me ligj është detyrë e çdo autoriteti atje.

Nën dy, unë e di që për shumicën prej jush edhe për publikun e Kosovës nuk është i njohur një fakt në të cilën jeton Kosova. Po 365 punonjës kulturor në Kosovë që 8 vjet punojnë me kontrata mbi vepër, këta janë kryesisht autoritete kulturore që janë pjesë e Filarmonisë së Kosovës, Baletit të Kosovës, Operës së Kosovës, Ansamblit Kombëtar, Teatrit Kombëtar, Galerisë Kombëtare, dhe rregullimi i statusit të këtyre njerëzve, sepse kem të bëjmë jo vetëm performues çfarë mund të jenë violinistët, pianistët, por kem të bëjmë me profesorë universitarë që në sektorin e muzikës apo në sektorin e teatrit, janë pjesë të institucioneve kulturore. Kemi arkeologë, antropologë dhe autoritete shkencore që punojnë brenda Ministrisë, po që nuk kanë të rregulluar statusin e tyre. Këtu për mua është problemi kryesor i cili dhe për cilin besojmë që do të rregullohet.

Pjesa tjetër e kontratave mbi vepër është në shuarje, është në eliminim brenda Ministrisë, nuk njihen, nëse janë vendet e punës të tepërta apo duhet të legalizohen përmes shpalljes, konkursit dhe përshkrimit të vendit të punës.

Më lejoni që të sjell me shifra. Qeveria e Kosovës për këtë vit ka dhënë 1.02 milionë euro subvencione ...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

I njëjti deputet, zoti Smaka, ka pyetje për ministrin Justina Pula - Shiroka, e cila nuk është këtu. A dëshironi ta lexoni pyetjen? Zoti Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti kryesues,

Nuk po e shoh të udhës për ta lexuar pyetjen, se po i bie ajo punë që po flasim me vetveten. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Tani e ka radhën deputetja Gjylnaze Syla, që ka një pyetje për ministrin Bujar Bukoshi.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë kisha ftuar njërin nga anëtarët e Qeverisë që në qoftë se kanë njohuri, qenka ministri Bukoshi këtu, se nuk e pash, më falni! Pyetja ime, zoti ministër, ka të bëjë me Ligjin për sigurimet shëndetësore. Tanimë dihet se shumë vite qytetarët e Kosovës janë pa sigurime shëndetësore, megjithatë në strategjinë legjislative të cilën e ka sjellë Qeveria është paraparë që më 28 shkurt të këtij viti të procedohet Projektligji për sigurimet shëndetësore.

Zoti ministër, kur do të procedohet për shqyrtim në Kuvend Projektligji për sigurimet shëndetësore?
Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër e ka fjalën.

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Faleminderit, në pyetje kolege!

Aq më tepër kur jeni shumë familjare me këtë problematikë, po ashtu edhe në Komisionin për Shëndetësi, legjislaturën e përparme. Kosova është i vetmi vend që nuk ka sigurim shëndetësor edhe kjo është boll keq. Tani do t'ju kurseja me historikun e kësaj pune pasi ju e dini këtë, përcjellja, letrat, përgatitjet, por problemi themelor, i vetmi problem është ose janë të ashtuquajturat implikime buxhetore, domethënë s'ka para. Tani në këtë situatë unë kam kërkuar aty edhe të shohë, domethënë mundësitë si t'ia bëj se është problemi i cili është i pashmangshëm edhe pa të cilin nuk mund të imagjinohet asnjë hap i mirëfilltë me organizimin e sektorit të shëndetësisë, dhe ne jemi, domethënë kemi filluar të punojmë me një do ta quaja një plan- propozim dhe kjo është punë e koordinuar me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, me Fondin Monetar Ndërkombëtar, i cili në esencë do të bazohet në buxhetin e Kosovës, në buxhetin të ligështë të Kosovës, në donacionet ose suplementet e donacioneve edhe privatizimit. Domethënë, do të studiohen edhe do të përpiqemi që të gjitha modalitetet të inkorporojmë në mënyrë që të sigurohet një start, një fillim i sigurimeve shëndetësore. Kjo është esenca e problemit.

Përgjigja, tani në pyetjen e juaj konkrete, pyetet kur do të përcillet kjo, kjo është përcjellë një herë me të vërtetë letrat janë bërë, por kur s'ka para s'ka as qare. Unë shpresoj, shpresoj se në vjeshtën e vonë, domethënë kah fundi i vjeshtës ne me mirëkuptim edhe të Qeverisë edhe të kryeministrit, i cili ka bajagi ndikim në Kabinetin qeveritar, që ta përcjellim këtë projektligj edhe të sigurohet startimi, fillimi i një bazamenti të sigurimeve shëndetësore. Në detaje mund të vazhdoj se ne, natyrisht, nuk janë këto fjalë të kota për shkak se kemi përgatitur edhe ekupe të cilat janë të ekspertëve, të cilët punojnë me disa skenarë e shumë skenarë se si do të bëhet nëse bëhen kaq, participimi këndej, participimi i qytetarëve, domethënë, ka aty kombinatorikë e skenarëve që janë skenarët, këto janë krejt punë që janë krejt në kuadër të këtij plan-propozimi që ne duhet me kujdes ta kemi kredibël këtë ose klauzibël, në mënyrë që të kemi pastaj edhe përkrahjen e Kuvendit edhe të Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

A keni pyetje shtesë, zonja Sylja?

Zonja Sylja ka pyetje shtesë.

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër,

Në qoftë se ju kuptova mirë, në vjeshtë pritet që kjo çështje të zgjidhet, a plani ju qysh e prezantuat, është ende hulumtimi i koncepteve të ndryshme. Në qoftë se është e vërtetë që në vjeshtë ne mund të presim një ndryshim lidhur me çështjen e sigurimeve shëndetësore, a mund t'i informoni qytetarët e Kosovës se sa është kostoja e këtij projektligji ose e këtij ligji, me qenë se vjeshta është shumë afër, ne jemi në korrik, në gusht, shtatori veç është vjeshta. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër,

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Po, ky është zotimi për të cilin unë sot e deklaroj, natyrisht nëse nuk arrijnë të dalim me këtë, atëherë do të më duhet mua patjetër t'i marrë përgjegjësitë për këtë farë zotimi. Por ky zotimi im bazohet në diçka edhe bazohet në këto komponentë që janë reale, që janë të bëshme. Natyrisht kjo është rrugë dy kahe kolege deputete, ju e dini se nuk bëhet puna vetëm me një kahe, është në pyetje vendimi edhe i shoqërisë tonë, edhe i institucioneve tona që ky sektor që ka

mbetur shumë mbrapa, që ka qenë me të vërtetë i trajtuar në mënyrë fare jo adekuate, të kompensohet tash me një mënyrë shumë më gjeneroze edhe t'i korrigjojmë disa gjëra e kam fjalën për distribuimin joadekuat të buxhetit të kaluar, tash ne duhet të përpiqemi në buxhetin e ardhshëm të sigurojmë diçka më shumë për sektorin shëndetësor. Prapë po them ky është zotim, unë shpresoj se do t'ia dalim.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Dhe zonja Drita Maliqi, është e fundit për sot dhe ka një pyetje për ministrin Shala, i cili mungon. A dëshironi ta lexoni pyetjen?

Zonja Maliqi, e ka fjalën.

DRITA MALIQI: Po, dhe e kam kërkesë në qoftë se ka mundësi, meqë ministri i Ekonomisë dhe Financave nuk është prezent, kam kërkesë nga Qeveria, mendoj nga kryesia e kësaj qeverisje nëse ka mundësi t'i përgjigjet kësaj pyetje, meqë vërtet i përket edhe Qeverisë.

Gjendja socio-ekonomike në Kosovë vazhdimisht po përkeqësohet, duke u bërë kërcenim kryesor i stabilitetit në vend. Duke pasur parasysh papunësinë e madhe në Kosovë, çmimet e artikujve të ndryshëm janë shumë të larta, për dallim nga pagat që vazhdojnë të mbesin shumë të ulëta. Ndërkohë, që standardi jetësor në mënyrë të vazhdueshme është duke shënuar rënie, varfëria në Kosovë po rritet. Indeksi i tërësishëm i çmimeve të konsumit në vendin tonë është më i lartë për 0.3% krahasuar me vitin paraprak. Kështu që qytetarëve tanë në fillim të vitit u është shtrenjtuar shporta e konsumit.

Zotërinj të nderuar, si e vlerësoni këtë gjendje dhe çfarë masash do të ndërmarrë Qeveria për të ndaluar këtë trend shqetësues? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Maliqi!

Nuk po shoh se dikush dëshiron të përgjigjet, por do të detyrohej të kënaqej me përgjigjen e ministrit Shala, më vonë.

Së këndejmi ne kemi përfunduar me pikën tre- Koha për pyetje parlamentare, dhe do të shkojmë menjëherë te pika katërt e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor

T'ju them se në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji, kështu që e ftoj me këtë rast ministrin përkatës, zotin Yagcilar, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë këtë projektligj.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar deputetë dhe ministra,

Nxjerrja e Ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor është i nevojshëm për faktin se me ligjin ekzistues shumë çështje nuk janë përfshirë, duke filluar nga përkufizimet si dhe përafrimi me direktivat e Bashkimit Evropian. Si direktiva e Këshillit të ministrave për vlerësimin e planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, direktiva e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për pjesëmarrjen e publikut në hartimin e planeve dhe programeve të caktuara të cilat kanë të bëjnë me mjedisin, rregulla e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian për zbatimin e dispozitave të konventës së AKAUS-it për qasje në informata, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen për drejtësinë në çështjet mjedisore në institucionet dhe organet e komuniteteve.

Gjithashtu direktiva e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës për qasjen në informacionin për mjedisin dhe Direktiva për mbrojtjen e habitateve natyrore të florës dhe faunës së egër.

Nevoja për hartimin e këtij projektligji është se përmbajtja e disa dispozitave të përfshira në ligjin ekzistues për vlerësimin strategjik në mjedis në një masë ka qenë pengesë për zbatimin e tij dhe ka qenë kërkesë permanente që ky ligj të ndryshohet dhe të plotësohet dhe pasi mbi 40% është ndryshuar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, konstatoj se më mirë është të nxirret ligji i ri. Projektligji ka për qëllim t'i adresojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një strukture komplete, gjithëpërfshirëse dhe përmbajtjesore të shtjelluara në projektligjin në fjalë, për rregullimin e administrimit të resurseve mjedisore në harmoni me normat dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Ligji ekzistues për vlerësimin strategjik në mjedis nuk ka përfshirë të gjitha normat dhe standardet e kërkuara për administrimin e lejeve mjedisore, gjë që ka qenë pengesë në zbatimin e tij.

Të nderuar deputetë,

Projektligji përbëhet prej pesë kapituj nga 19 nene dhe tri shtojcave.

Kapitulli i parë, dispozitat e përgjithshme, trajton qëllimet dhe përkufizimet.

Kapitulli i dytë, vlerësimi strategjik mjedisor për planet dhe programet, përcakton fushëveprimin, detyrimet e përgjithshme, përcaktimi i nevojës për vlerësimin strategjik mjedisor, njoftimi për përcaktime dhe udhëzime.

Kapitulli i tretë, raporti i VSM-së, procedurat e konsultimit trajtojnë përgatitjen e raportit të VSM-së, procedurat e konsultimit, debatin publik, konsultimet ndërshtetërore, planet dhe programet e shteteve të tjera. Vlerësimi i raportit të VSM-së, vendimin për pëlqim mjedisor, për raportin e VSM-së, miratimin e planit apo programet, informacionin për vendimin si dhe monitorimin.

Kapitulli katër, përfshinë mbikëqyrjen.

Ndërsa kapitulli i pesë, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare, trajton planet dhe programet që i nënshtrohen këtij ligji dhe hyrjen në fuqi.

Ky ligj rregullon procedurat për identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis dhe për procedurat shoqëruese, administrative gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për lëshimin e pëlqimit mjedisor dhe siguron që të gjitha informatat relevante lidhur me mjedisin janë afruar dhe janë marrë parasysht.

Projektligji për vlerësimin strategjik në mjedis në mënyrë më përmbajtjesore dhe më saktë adreson rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me procedurat e VSM-së, informimin, pjesëmarrja e publikut në procedurat e VSM-së.

Projektligji është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet që janë të përafërta me dispozitat e Bashkimit Evropian.

Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese dhe për zbatimin e këtij projektligjit nuk i nevojiten mjete shtesë buxhetore.

Dispozitat e këtij projektligji lidhur me administrimin e resurseve mjedisore garantojnë të drejtën e qytetarëve për të jetuar në mjedis të pastër.

Të nderuar deputetë, kërkoj që në leximin e parë të aprovohet ligji, në parim, të procedohet në komisione parlamentare që ligjit të jetë më funksional dhe më efikas. Ju faleminderit, për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani përparësi do të ketë kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e shoh që është paraqitur zonja Selvie Halimi, a doni të flitni në emër të Komisionit. Në emër të grupit. Atëherë, Komisioni, zoti Rugova. Zoti Naser Rugova, e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja dhe zotërinj,

Në kuadër të pakos ligjore të ligjeve që rregullojnë politikat mjedisore dhe harmonizojnë në një masë të konsiderueshme legjislacionin tonë nacional me direktivat e Bashkimit Evropian dhe asquis communautaire vjen edhe Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor një ligj i cili në masë të madhe harmonizon edhe direktivat, edhe traktatet, edhe konventat, por edhe obligimet që i kanë vendet anëtare dhe vendet pretendente që të jenë pjesë e Bashkimit Evropian sa ju takon politikave të caktuara mjedisore.

Ky ligj rregullon procedurat e identifikimit, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis, si dhe procedurat tjera shoqëruese, administrative, që në fund e kanë emëruesin e përbashkët marrjen e lejes mjedisore apo pëlqimit mjedisor. Duke e ditur që kjo fushë ka qenë e rregulluar me një ligj jo adekuat i cili nuk ka qenë në akordancë të plotë me direktivat e BE-së, ky projektligj, Projektligji i ri do të thotë për vlerësimin strategjik mjedisor është një ligj i strukturuar mirë i cili në vete ngërthen të gjitha fushat me rëndësi të veçantë sipas kriterëve dhe konventave të BE-së, kërkon pjesëmarrje dhe transparencë dhe konsultim me qytetarin, me publikun, varësisht se ku duhet të zbatohet apo implementohet projekti i caktuar. Gjithashtu ky projektligj rregullon në mënyrë strikte konkrete dhe shumë pragmatike edhe aspektet që kanë të bëjnë në projektet që prekin marrëdhëniet ndërshtetërore, ndërkufitare dhe ndikimet e tyre. Andaj, pakot e fundit të ligjeve për politikat mjedisore Projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis si dhe Projektligji për vlerësimin strategjik mjedisor duhet të mbështeten nga ky Parlament dhe duhet që gjatë punës së procedimit të mëtutjeshëm dhe amendimeve të këtyre ligjeve në veçanti të këtij projektligji vërtet të krijojnë ligje pragmatike ku forcohet roli i shtetit i autoriteteve kompetente, por edhe pjesëmarrja e publikut për projekte të rëndësishme që janë në interes të qytetarëve dhe publikut në përgjithësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: faleminderit, zoti Rugova!

Tani radhën e kanë grupet parlamentare dhe në Emër të PDK-së u identifikua zonja Selvie Halimi. Urdhëroni, zonja Selvie!

SELVIE HALIMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar vëmendshëm Projektligjin për vlerësimin strategjik mjedisor dhe e përkrah në parim. Gjithashtu ne i jemi mirënjohës të Ministrisë, sepse edhe përkundër faktit që brenda këtij mandati ky ligj është punuar një herë dhe ka hyrë në fuqi, ka identifikuar problemet dhe mangësitë e pjesëve të direktivave të ndryshme të BE-së, të cilat i kanë munguar këtij ligji dhe nuk kanë mund të zbatohen dhe pas kërkesave dhe të Komisionit Evropian, Ministria menjëherë ka qenë e gatshme që t'hyjë plotësimi ndryshimit të ligjit dhe kur e ka vërejtur se po kërkohet një plotësim ndryshim po thuhet se si e ceku edhe ministri diku rreth 40% i substancës së ligjit, atëherë ka filluar të punojë një ligj të ri.

Përsëritim gatishmërinë e Ministrisë pra që shumë shpejtë ka filluar të punojë në këtë drejtim dhe na ka sjell projektligjin në Kuvend. Në Komisionin funksional ne do të japim kontributin tonë kryesisht do të përqendrohemi te pjesët ku është bërë bartja e pjesëve të direktivave të cilët kanë qenë

të domosdoshme që të hyjë në Ligjin për vlerësimin strategjik mjedisor që të kemi në qartësim, me qëllim që të ndihmohet zbatimi i ligjit në praktikë rreth përkthimeve të cilat kemi vlerësuar se nuk janë mjaftë të qarta. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani e ka radhën Grupi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zonja Pantina është paraqitur, urdhëroni zonja Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Me qenë se Ligji për vlerësimin strategjik mjedisorë i miratuar më 12 shkurt në vitin 2009 nuk e mbulon në tërësi lëmin e administrimit të resurseve mjedisore, pasi që nuk janë të përfshirë detyrimet që dalin nga direktivat e Bashkimit Evropian, konkretisht direktiva 2003/35, atëherë me projektligjin të cilin po e shqyrtojmë sot do të plotësohen zbrazëtirat ekzistuese.

Në këtë projektligj janë të përfshira pesë direktiva të BE-së, qëllimi i të cilave, përveç që të sigurojnë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit është edhe të nxisin pjesëmarrjen e publikut në hartimin e planeve dhe programeve të cilat kanë të bëjnë me mjedisin.

Në bazë të nenit 4 të këtij projektligji planet dhe programet për të cilat kërkohet vlerësim strategjik mjedisor nuk do të mund të miratohen derisa autoriteti përgjegjës të mos ketë kryer vlerësimin strategjik mjedisor në pajtim me këtë ligj.

Andaj, mendojmë se ky projektligj ka një rëndësi të veçantë për fazën e zhvillimit në të cilin gjendet vendi ynë, kur kërkohet edhe shfrytëzimi i burimeve natyrore por edhe mbrojtja e mjedisit, që njëkohësisht është edhe një kriter shumë i rëndësishëm për të integruar në BE.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim Projektligjin për vlerësimin strategjik mjedisor dhe kontributin tonë do të japim në kuadër të Komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Pantina!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Naim maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së të shpreh vlerësimet që i ka ky grup parlamentar në lidhje me këtë projektligj. Ne e miratojmë në parim këtë projektligj, duke e konsideruar se i plotëson nevojat e parapara. Mirëpo, më lejoni, zoti ministër dhe të nderuar deputetë, që të ndalem në disa vërejtje që i kam dhe i shpreh në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

Neni 2, ku janë të përkufizimet, të nderuar ministra dhe të nderuar deputetë, gati në të gjitha ligjet, për shembull, e kemi përkufizim “Ministria” dhe “ministri”. Të ndalemi pak dhe të mendojmë se a ka nevojë të ngarkohet secili ligj që vjen në Kuvend me shpjegimin se çka do të thotë “Ministria” dhe çka do të thotë “ministri”. Ose për shembull, e keni përkufizimin te 1.4, çka nënkupton publiku? Mendoj se nga disa përkufizime e shpjegime duhet të lirohen ligjet edhe për faktin se shpenzohet edhe material, edhe fjalë, edhe letër.

Tjetra, më lejoni, të nderuar deputetë dhe ministër, t’ua tërheq vëmendjen në nenin 10 të projektligjit, që për grupin parlamentar përkufizimi që shprehet me këtë nen në këtë ligj, ka të bëjë me konsultime ndërshtetërore për projektet strategjike, të cilat në një mënyrë a një tjetër ndikojnë në mjedis në shtetet

fqinje. Në bazë të këtij përkufizimi, siç është ky nen këtu në këtë ligj, atëherë i nderuar ministër, posaçërisht paragrafin 4 të këtij neni, kur thotë citoj: “ në rastet kur ministri pranon nga ndonjë shtet tjetër ndonjë shenjë se ai”, pra ai shtet “dëshiron të hyjë në konsultime para miratimit të një plani ose programi të dërguar te ai, në pajtim me paragrafin 3, ministri do të konsultohet” e tjera, paragrafi 4.1, 4.2 e tjera. E ngrita këtë shqetësim në emër të grupit parlamentar për faktin se ju, zoti ministër dhe Qeveria planifikon që në vitin e ardhshëm do të fillojë implementimi i projektit Termocentrali “Kosova e Re”, siç po e quani tani me të renë dhe ju me këtë nen praktikisht e bëni të pamundur fillimin e atij projekti, jo në vitin e ardhshëm, por me faktin se në përkufizimet e këtij neni dhe me paragrafë ju askund nuk keni kohë, për shembull, që mund t’i jepni atij shteti për t’i dhënë vërejtjet në mënyrë që mos të bëhet praktikisht pengesë një shtet fqinj në implementimin e ndonjë projekti, në këtë rast e kemi projektin “Kosova e Re” që në bazë të këtij neni dhe paragrafit 4 mundet shteti fqinj, pra të ngre shqetësime që ai projekt mund të ndikojë në mjedis në atë shtet dhe pastaj në bazë të faktit, se ju nuk keni parapa ndonjë kohë brenda të cilës do të kryhen konsultimet dhe sqarimet me shtetet fqinje, ju lëni hapur këtë çështje me këtë nen, ju ia lidhni këmbët vetvetes, Ministrisë, Qeverisë edhe implementimit të projektit në fjalë.

Mendoj se duhet mirë të mendoni, zoti ministër, dhe me trupat tuaja pra të ministrisë, Zyra për legjislacion dhe Komisioni Parlamentar dhe unë ju ftoj, të gjitha grupet parlamentare që ta kenë vëmendjen në nenin 10 dhe në të gjitha përkufizimet që i ka ky nen dhe implikimet e mundshme që pastaj do t’i kemi ose implikacione në qoftë se ky ligj me këtë nen miratohet kështu. Unë ju ftoj të gjithëve që të punojmë dhe t’i heqim, pra, ose t’i shtojmë disa nene ose paragrafë që do ta lirojmë veten nga këto përkufizime dhe kufizime që mund të na qesin të tjerat rreth nesh në implementimin e projekteve strategjike për të cilat edhe jemi marrë vesh në këtë Kuvend dhe e ka prioritet Qeveria. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Maloku!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, është paraqitur Drita Kadriu, a është e vërtetë, ose Heset Cakolli e ka fjalën.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuari Kabinet qeveritarë,

Të respektuar kolegë deputetë,

Hartimi i Ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor ka qenë i domosdoshëm për faktin se ligji ekzistues në një masë ka qenë pengesë për zbatimin e tij në praktikë, sepse shumë çështje nuk kanë qenë të përafërta me direktivat e Bashkimit Evropian.

Ligji ekzistues numër 03/L-015 edhe pse është aprovuar në këtë Kuvend në shkurt të vitit 2009, ka pësuar ndryshime mbi 40% dhe tani ky projektligj që po e diskutojmë sot është në përputhje me 5 direktivat e Bashkimit Evropian të dhëna në memorandum shpjegues.

Ky projektligj ka edhe tri shtojca ku përshkruhen.

Në një, kriteret për përcaktimin e efekteve të mundshme të parashikuara në nenin 5, do të thotë të këtij projektligji.

Në dy, informata që duhet përfshirë në raportin e vlerësimit strategjik mjedisor ku përshkruhen në nenin 7.

Dhe nën tre, kriteret për vlerësimin e raportit të vlerësimit strategjik mjedisor që janë dhënë në neni 12, pika 5.

Ne si grup parlamentar kemi disa vërejtje të përgjithshme dhe konkrete në nene të caktuara dhe unë pajtohem me vërejtjet që i ngriti deputeti i nderuar Maloku, në këtë projektligj, por në parim e përkrahim që të procedohet në komisionet funksionale dhe kontributin tonë do ta japim nëpërmes anëtarëve tanë deri në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Cakolli!

Tani në emër të LDD-së, e kemi përsëri Naser Rugovën.

NASER RUGOVA: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse vitin e kaluar patëm miratuar formalisht këtë projektligj është vërejtur që ka mangësi të shumta, nuk është në harmoni të plotë me direktivat e BE-së dhe te e fundit nuk ka gjetur implementim në praktikë. Si shtet i ri dhe në një tranzicion dinamik që jemi duke e ditur që kemi para vetes shumë punë dhe na nevojiten shumë projekte të mëdha nacionale të cilat konform këtyre direktivave kanë nevojë që ta kenë vlerësimin strategjik mjedisor, por edhe vlerësimin e ndikimit në mjedis. Ka filluar projekti famoz i autostradës dhe cila ministri, cili përgjegjës i Qeverisë e ka dhënë një vlerësim adekuat se cilët janë impaktet e këtij projekti kur dihet që është ndryshuar edhe traseja dhe kalon nëpër vise të tëra do të thotë që nga pjesa veriore deri në jugë të Kosovës. Çfarë vlerësimi strategjik mjedisor, çfarë fizibiliteti i efekteve ose impakteve mjedisore dhe sociale është dhënë për këtë projekt. Po trumbetohet me të madhe pastaj për Termocentralin “Kosova e Re” i cili po shtyhet si zakonisht dhe u dha një sqarim nga ministrja e resorit kompetent që do të fillojë diku kah mesi i viti të ardhshëm. A është debatua në Qeveri, në Ministrinë e Mjedisit a po na ka ardhur ndonjë raport zyrtar në institucionin më të lartë legjislativ të vendit për ndikimet dhe efektet mjedisore të këtij projekti që fatkeqësisht ende nuk dihen kapacitetet e tij a 500, a 1000, a 1500 apo nuk do të zbatohet fare? Dhe efektet mjedisore të projekteve të tilla që kanë një rëndësi nacionale po që kanë impakte të theksuara në mjedisin edhe ashtu të kontaminuar të Kosovës, atëherë vërtet ky projektligj përcakton është një ligj më i strukturuar, është në harmoni me direktivat e BE-se, sepse po të vazhdojmë me këtë logjikë si deri tani që çdo 6 muaj apo çdo një vit të ndryshojmë ligjet e tilla, atëherë çfarë zbatueshmërie të këtyre ligjeve presim, për çfarë mjedisi, për çfarë shëndeti publik për popullatën thjesht angazhohemi, qoftë si Qeveri, qoftë si Parlament?

Andaj, zoti ministër, jo vetëm në nenin 10 por edhe në disa nene të tjera duhet të precizohen saktësisht, por edhe bashkëpunimin ndërkuftar që është një nga objektivat politike të Bashkimit Evropian, duhet të precizohen në mënyrë të saktë dhe me periudha kohore strikte se si duhet të silllet dhe çka duhet të ndërmerr Ministria kompetente apo edhe në instancë të fundit edhe Qeveria e vendit?

Grupi Parlamentar i LDD-së do ta epë kontributin e vetë gjatë procedimit të mëtutjeshëm në Komisionin funksional dhe në komisionet tjera të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në parim e mbështesim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rugova!

Në emër të Grupit “7+” është paraqit zoti Marxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Ju përsëritem juve, stafin tuaj!

I përsëritem ministrat që kanë mbetur, edhe pse një numër i paktë, mirëpo prapë i përsëritem, sepse kanë durim që të na dëgjojmë edhe ne deputetëve çka po flasim.

Në projektligjin për mjedisin, tha kryetari i komisionit, zoti Naseri në fjalimin e vet, ashtu që ky ligj që na ka ardhur tash është më i mirë se ai ligji që ka qenë para këtij. Edhe ne, Komisioni i Bujqësisë,

po me ato që i tha edhe zoti Maloku, ne në parim do ta mbështesim, ashtu që edhe në komisione tjera do ta plotësojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Merxha!

Në emër të Grupit SLS, është paraqitur zoti Mursel Halili.

MURSELJ HALILI: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Gospodo ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna Grupa SLS je tokom razmatranja ovog Nacrta zakona došla do stanovišta da je ovaj zakon neophodno potreban. Smatramo da ovaj Nacrt zakona zadovoljava sve kriterijume i što pre bi trebalo da bude usvojen u ovoj Skupštini. Obzirom da su u procesu veliki projekti koji mogu direktno uticati na životnu sredinu, na zagrađivanje i na prirodna staništa flore i faune, a to je takođe preduslov za javno zdravlje i zdravlje građana. Smatramo da odsustvo ovih direktiva Evropske unije je dodatno otežavalo rešavanje pitanja iz ove oblasti pa, samim tim, uvrštavanje ovih direktiva u Nacrt zakoni i sam tekst zakona je neophodno potrebno. Mi ćemo u načelu podržati ovaj Nacrt zakona. Ja se u ime Parlamentarne Grupe SLS zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Halili!

Në emër të Grupit për Integritet, është paraqitur zonja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala na datu reč!

Ja isto u svoje ime pozdravljam predsedništvo, ministre i svoje kolege!

Mi smo pažljivo razmatrali ovaj Zakon koji danas imamo o strateškoj proceni uticaja na životnu sredinu. Znamo da je osnovni cilj ovog zakona da strateškom procenom planova i programa životne sredine obezbedi visok stepen zaštite životne sredine radi zdravlja ljudi. Nešto što hoću, ne bi želela da ponavljam ono što su moje kolege rekle, ali nešto što hoću ka kažem, jeste da Zakon ima svoj cilj, ima definiciju, ima određene organe koji treba da sprovedu ovaj zakon, definisani su organi i ministarstva. Jedno što hoću da napomenem, jeste član 9. kada je u pitanju javna debata, pošto smo imali više priliku da čujemo da su u toku nacionalni projekti na Kosovu koji su od izuzetnog značaja, ali koji mogu biti i negativno uticati na životnu sredinu i okolinu, uništenja prirodne sredine.

Kada je u pitanju član 9. javna debata, ja kažem da ovde nemamo praksu, meni je jako milo da je ovaj Zakon uveo javnu debatu kao obavezu za bilo koji plan i program, gde treba Nacrt plana ili programa da daje izveštaje da ne utiče negativno na ukupnu procenu životne sredine. Obavezna javna debata, neću da opterećujem kolege da čitam koji su sve članovi i stavovi obavezne debate. Mi smo imali priliku da smo bili u Finskoj i kada su u pitanju nacionalni programi, jako je važna posle zakona, donošenja zakona, javna debata o bilom kom zakonu ili o biloj kojoj proceni kada je u pitanju životna sredina.

Drugi član, član 10. to što smo čuli da smo u obavezi znači oko međudržavnih konsultacija, kada je u pitanju Kosovo sa ostalim državama, na osnovu Evropske direktive o zaštiti životne sredine i, normalno, član 11. koji nas obavezuje da planovi i programi drugih država isto moramo da vodimo računa i koji su planovi i programi drugih država u bokolini, da li oni negativno utiču na procenu životne sredine na Kosovu. Ovo je od izuzetne važnosti, zato što se radi o globalnoj zaštiti životne sredine, te mislim da se ovim zakonom mora da počne ozbiljno da se posmatra Kosovo unutra, iz spolja kada je u pitanju Evropska unija, jer moraćemo neke postupke iz zakona da rešavamo po direktivama Evropske unije, gde ćemo moda, kažem u ovom zakonu nema, ali međunarodni zakoni imaju i plaćati penale ostalim državama ako se životna sredina bilo koje države oštećuje od naše strane.

Mi ćemo svoj doprinos da damo, podržavamo ovaj zakon i čekamo da se ova oblast jako dobro reguliše na Kosovu. Mi ćemo naš doprinos da damo i kao grupa i kao sami poslanici. Mislim da je preko potreban i da treba da ide u daljoj proceduri. Izuzetno hoću da napomenem da se funkcionalne komisije kada su u pitanju ovih zakoni pozabave sa zakonima ostalih u regiji i da usklade ovaj zakona ako je nešto prepušteno. Toliko od nas. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Me që kanë përfunduar përfaqësuesit e grupeve, radhën e kanë deputetët e paraqitur për debat dhe radhën e kanë: Bahri Hyseni, Drita Kadriu, Donika Kadaç, Hajdin Abazi dhe Adem Hajdaraj. Kështu, Bahri Hyseni tani e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, konsideroj që projektligji që e kemi para vetes është i hartuar në aspektin profesional dhe natyrisht e përgëzojmë edhe ministrin, edhe Qeverinë për një punë jashtëzakonisht të mirë.

Megjithatë, konsideroj që disa nga vërejtjet duhet të merren parasysh në komisionet funksionale, pa dashur tash të ndalem në të gjitha vërejtjet, por do t'i përmend vetëm disa nga çështjet.

Nëse shkojmë te neni 4, paragrafi 6, flitet në paragrafin 3 për një grup punues apo një komision, i cili do të formohet për çështjen e mbikëqyrjes apo për çështjen e përgatitjes së draftit të parë dhe pastaj në paragrafin 6, flitet: “anëtarët e Komisionit, të themeluar në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni, duhet të posedojnë shkathtësi, njohuri dhe përvojë për planin ose programin”. Me një fjalë të tillë, çka kërkohet nga ministri. Është bërë një praktikë në të gjitha nenet, edhe në këtë projektligj po përmendet si organ vetëm ministri. Nuk është lehtë bash për ministrat ku përmendet edhe t'i japin udhëzimet, edhe t'i njoftojë ato komisionet konsultuese, edhe çështjen e ankesave. Nëse e merrni në të gjitha nenet, është në rend të parë ministri. Do të kisha kërkuar që komisionet funksionale të kenë parasysh që ministri është organ i Ministrisë dhe menaxhon për politikën, por mos e ngarkoni me krejt çështjet të cilat nuk janë të rëndësishme dhe do ta ketë vështirë tash ministri, siç e keni shkruar, mbas 10 ditëve duhet t'i njoftojë për planin, për publikimin, por këto janë çështje krejt të dorës së dytë dhe, natyrisht, janë më tepër teknike, të cilat i bën Ministria, zyra e sekretarit dhe shërbimet tjera. Por, në anën tjetër, siç e keni paraparë në ligj, atëherë nëse nuk e bëni, keni bërë shkeljen e ligjit, është çështja e parë. Dhe, çështja e dytë që e lexova, nuk mundet kriteret t'i përcaktojë ministri. Kriteret do të përcaktohen ose me këtë ligj, ose me një rregullore dhe absolut nuk mund të jenë kritere individuale, ministri nuk është organ i cili përcakton kriteret kualifikuese të njerëzve, por e nxjerr një rregullore apo një udhëzim administrativ me të cilin përcaktohen kriteret.

Çështja tjetër me interes është te mbikëqyrja. Nëse i lexojmë me vëmendje, e keni shkruar në nenin 17, “mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj e kryen Ministria”. Mbikëqyrjen nuk është e thënë ta kryej vetëm Ministria, mbikëqyrjen mund ta kryejnë të gjithë të interesuarit, institucionet tjera, komisionet parlamentare, Kuvendi, inspektoratet e ndryshme, mandej varësisht prej sferës në të cilën preket. Mirëpo, kjo po bie ndesh më poshtë me paragrafin 2, thotë: “detyrën për të monitoruar zbatimin e këtij ligji do ta kryej Inspektorati i Njësisë, në përputhje me ligjin”. Inspektorati konsideroj se nuk e kryen shumë monitorimin, por ai do të mbikëqyrë zbatimin dhe do të ndëshkojë në aspektin administrativ, por monitorimin dihet kush e ka në kompetencë dhe përgjegjësi. Prandaj, këto është mirë të përmirësohen në komisionin

funksional, sepse Inspektoriati nuk është i themeluar për monitorim, por është për ta zbatuar pikërisht dhe për të marrë masa adekuate për t'i zbatuar.

Dhe, në fund, thotë “raportin për zbatimin e këtij ligji e përgatit Ministria 3 vjet pas hyrjes në fuqi”. Edhe kjo nuk e di, ndoshta është krejt në rregull, mirëpo monitorime mund të ketë edhe para 3 viteve, sepse nëse i kërkon Kuvendi i Kosovës para tri vjetëve, atëherë duhet të përgatitet ndonjë raport për çështjen e monitorimit. Mirëpo, mund të lihet si afat që Ministria raporton për zbatimin e Ligjit në çdo tri vjet. Obligimi ligjor për monitorime mund të ndodhë edhe para 3 vjetëve.

Dhe, krejt në fund, është te dispozitat kalimtare dhe përfundimtare. Unë mendoj se e kanë bërë shumë në mënyrë të qëlluar, mirëpo ndoshta për të mos rënë në lajthitje, është te paragrafi 3 dhe te paragrafi 2 i dispozitave përfundimtare. Paragrafi 2, thotë: “vlerësimi për strategjinë e mjedisit dhe i planit dhe i programeve prej të cilave akti i parë formal përgatitor është para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të kryhet në pajtim me dispozitat e ligjit aktual që e kemi në fuqi”. Është krejt në rregull. Mirëpo paragrafi 3 thotë: “Përfjashtimisht nga paragrafi 2, i këtij neni, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji i vlerësimit strategjik mjedisor”. Faktikisht, paragrafi do të duhej të ishte për nenin përkatës të ligjit, të ligjit aktual që e kemi, jo për paragrafin 2, sepse këtu po flasim për ligjin në tërësi dhe po flasim për paragrafin 2.

Do të duhej rregulluar që të shfuqizohet paragrafi përkatës, apo të mbetet në fuqi paragrafi përkatës i ligjit aktual, i cili do ta rregullojë çështjen në fjalë, nëse ka të bëjë sepse, nëse e shkruajmë kështu, atëherë përjashtimisht nga paragrafi 2, ne domethënë nuk jemi duke kërkuar ta shfuqizojmë paragrafin, por ligjin aktual. Prandaj, duhet të thirremi në nenin përkatës i cili e rregullon ndonjë plan eventual i cili ka filluar.

Këto në pika të shkurta do të ishin disa vërejtje. Edhe një herë, ligji duhet të mbështetet, sepse është ligj i hartuar në mënyrën më profesionale të mundshme që ka ardhur në Parlament. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni. Tani radhën e ka zonja Drita Kadriu.

DRITA KADRIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është kënaqësi që sot në radhë e kemi Ligjin për vlerësimin e ndikimit mjedisor. Vërejtjet e mia besoj që do t'i kontribuojnë cilësisë së ligjit dhe do të ndalem vetëm te neni 2 i përkufizimeve.

Te pika 1.1, ku përkufizohen konceptet e planeve dhe programeve, mendoj se ky nen është mjaft i cinguar, sepse po e citoj: “planet dhe programet janë plane dhe programe”, domethënë sponzoruesi nuk ka gjetur shprehje adekuate që i përshkruan se çfarë ose çka i përkufizon se çka janë planet dhe programet.

Unë propozoj që këtu t'i shtohet nocioni: “planet dhe programet janë dokumente që përcaktojnë veprimtari të caktuar” dhe mandej të vazhdohet me kuptimet mbi financimin e këtyre planeve dhe programeve, sepse këtu kemi një kufizim të financimit, ku thotë: “ato të bashkëfinancuara nga komuniteti evropian ose institucionet tjera”. Meqenëse kemi një caktim të bashkëfinancimit, besoj se është më në rregull nëse ne e përkufizojmë “të financuara nga mjetet private publike të donatorëve evropianë dhe donatorëve tjerë”. Arsyeja pse unë i them këto vërejtje, është se vetë ky paragraf e kufizon krejt konceptin e ligjit dhe e ndalë vetëm në nivelin e planeve dhe programeve.

Unë besoj që ky nen dhe ligji duhet në kuptim të koncepteve të përmbledhë planet, programet dhe strategjitë. Një arsye për këtë është se ne para disa kohe kemi miratuar Strategjinë për energjinë dhe meqenëse në fund të këtij paragrafi edhe vet Parlamenti është i theksuar si autoritet procedural i miratimit të planeve dhe programeve, unë besoj që me futjen e konceptit të strategjisë në përkufizim dhe të plotësohet në gjithë ligjin aty ku përmenden planet, programet, të shtohet edhe nocioni planet, programet dhe strategjitë, besoj se Ligji domethënë i mbulon konceptet e dokumenteve, nivelet hartuese të dokumente. Përndryshe, është e domosdoshme që ky ligj sa më shpejt të kalojë dhe besoj që grupi funksional do t'i ketë në vëmendje vërejtjet që u dhanë sot në seancë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Drita! Po kërkoj falje që më parë ju apostrofova në emër të një subjekti, të cilit ju nuk i përkisni., Ju faleminderit shumë! Edhe, tani e ka radhën zonja Donika Kadaj – Bujupi.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Po, i nderuar kryesues, ju faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Fillimi i fundit të mandatit të kësaj Qeverie po afrohet dhe do të thotë fushat e shumta ku kanë dështuar, nuk përjashtojnë as fushën e mjedisit. Dështuan në hartimin dhe zbatimin e plotë të politikave efikase mjedisore, ku përveç veprimeve për qëllime fushatore, na kujtohet të gjithëve ai projekti famoz i kryeministrit Thaçi, i fidaneve, në fakt ka munguar një përkujdesje ndaj natyrës.

Anarkia po i konvenon kësaj Qeverie, sepse vetë Qeveria, ashtu siç e kemi potencuar disa herë, është ndotësi më i madh i mjedisit. Indiferenca e saj në administrimin e resurseve natyrore, regjenerimin tyre, e ka thelluar krizën e mjedisit jetësor. U tha edhe më herët nga kolegët, do të thotë sot na është sjellë një projektligj i cili ka një mori përkufizimesh shumë qesharake, ku Qeveria ii tregon deputetëve se çka do të thotë shprehja “publik”, çka do të thotë shprehja “ministër”, “ministri” dhe unë konsideroj se kjo Qeveri duhet t'i japë përgjigje këtij Kuvendi, qytetarëve të Kosovës, por dhe organeve të rendit, prokurorisë, se çka do të thotë gurthyesi në Vushtrri, i kujt është ai gurthyes, kush qëndron prapa tij, i kujt është gurthyesi te Rrasa e Rahovecit, i kujt është gurthyesi në Leposaviq, ku nuk po e shtrini ndikimin kushtetues, por e keni shtrirë shumë mirë ndikimin e biznesit. Duhet t'i japë përgjigje këtij Kuvendi dhe qytetarëve të Kosovës se a ka inspektorat, a ka inspeksion i cili merret me mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, a shkojnë ndonjëherë ata inspektorë në magjistralen Pejë-Prishtinë, përkatësisht karshi Parkut të Drenasit, ku po bëhet një eksploatim i zonave të tëra me qëllime përfitimi, duke mos përfillë asnjë kriter. Janë këto vetëm disa nga dëmet, eksploatimet dhe politikat abuzuese dhe korruptive të cilat po i instalon kjo Qeveri, e cila në retorikë të veten ka gojën plot me rend dhe ligj, por që në fakt bën të kundërtën.

Gurthyesit janë vetëm disa nga veprimet shumë anarkike abuzuese dhe korruptive, të cilat në këtë trevjeçar të mandatit të saj ka implementuar dhe zbatuar Qeveria Thaçi, për pasojë po rrezikon shëndetin publik, po rrezikon brezat e ardhshëm, ndërkaq qëllimi i këtij projektligji, i nderuar kryesues, apo neni 1 i këtij Projektligji thotë që “qëllimi i këtij ligji” dhe këto po e lexoj për kolegët deputetë, të cilët reagojnë, “është që vlerësimi strategjik mjedisor i planeve dhe programeve të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut”. Prandaj, pavarësisht se çfarë projektligji kanë sjellë, me shumë të meta, po pavarësisht, edhe sikur të ishte i mirë, zbatimi i tij është iluzion. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Kadaj!

Fjalën tani e ka zoti Hajdin Abazi, të bëhet gati zoti Adem Hajdaraj.

HAJDIN ABAZI: Ju faleminderit, zoti kryesues,
Të nderura kolege dhe kolegë deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,

Vërtet, ky Ligj për vlerësimin strategjik të mjedisit u vlerësua edhe nga kolegët e tjerë, se është bërë shumë mirë që vetë Ministria e ka parë të arsyeshme që ta sjellë një ligj të ri dhe të mos përcillet te komisionet, sepse pastaj po ka vështirësi të shumta, kështu që kjo e ka lehtësuar shumë punën që komisionet dhe ne si deputetë të mund të japim ndonjë kontribut të vogël që ligji të jetë..., vërtet t'i realizojë dhe të jetë adekuat me qëllimet për çka është përcaktuar.

Unë desha të kujtoj me këtë rast vetëm një çështje. Prindërit e mi, për fat të keq, që të dy, edhe babai, edhe nëna kanë qenë të paarsimuar, mirëpo një veti e tyre ka qenë e të dyve, se që të dy kanë qenë ambientalista ose, po them, edhe ekolog. Nëna ka qenë shumë merak dhe oborrin e shtëpisë e ka bërë si një kopsht të vërtetë me lule, kurse babai im, po në oborr, që nuk ka pasur më shumë se 8 ari, ka mbjellë të gjitha pemët që kultivohen në Kosovë, të renditura dhe të radhitura sikurse të kishte qenë një ekspert i mirëfilltë, edhe pse absolutisht kanë qenë analfabetë dhe nuk kanë pasur njohuri përkatëse.

Për fat të mirë, nuk kanë qenë vetëm prindërit e mi, por ka pasur dhe ka ende shumë qytetarë që vërtet e duan ambientin. Mirëpo, në anën tjetër, sikur të ishte që vetëm kjo Qeveri e tashme vërtet e ka bërë gjendjen kaotike, unë do të konsideroja se do të ishte gjendja shumë e lehtë për t'u zgjidhur. Fati ynë i keq është se jo vetëm që nga paslufta, por edhe para luftës kanë filluar ndërtimet e egra pa kontroll dhe pa pasur mundësi për t'i kontrolluar se si po bëhen ato, se si po shfrytëzohen pyjet. Ne të gjithë le të shohim se pyjet po shkatërrohen dhe nuk po ka, jo vetëm gjatë këtyre ditëve, por shumë nga paslufta e këndej dhe, duke qenë se qëllimi i këtij ligji, ndër të tjera është që ta organizojë planifikimin hapësinor dhe urbanistik dhe parashihet dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve të vogla në nivel lokal dhe në rastet kur këto janë të modifikuara, unë shpresoj që përmes këtij ligji do të ketë mundësi që vërtet të ndalet hovi jashtëzakonisht i rrezikshëm i ndërtimeve, kur bëhen objekte shumë katëshe dhe nuk ka as vend për parking, e të mos të flasim për një kopsht përpara, ku të ketë mundësi që të rregullohet ambienti me lule, me drunj të ndryshëm, ku të kenë mundësi fëmijët të dalin tek objekti ku banojnë. Në këtë pikë unë desha të ndërlidhem me atë që edhe ligji i mëhershëm që ka ekzistuar e ka dhënë këtë kompetencë dhe do të ishte mirë që Qeveria vërtet të jetë më efikase në kuadër të veprimit ose të bashkëveprimit me komuna, që të ndalet ky hov, sepse një ditë prej ditësh ne do ta kemi një xhungël betoni dhe nuk do të kemi as ku të dalim në dritare të shohim, pos do ta shohim objektin tjetër që nuk e respekton as minimumin e 8 metrave që duhet të jetë larg një objekti tjetër dhe të mund të funksionojë si duhet. Kështu, do të ketë jo vetëm kushte që nuk do të ketë gjelbërim, nuk do të ketë ambient, por edhe për vet ajrin do të ketë ndotje, sepse nuk do të ketë mundësi që këto të kontrollohen. Prandaj, unë e shfrytëzoja rastin, duke qenë se po bisedojmë për një ligj të ri, që është për vlerësimin strategjik të mjedisit, vërtet t'i kushtojmë rëndësi dhe ky ligj i jep mundësi të reja që kjo ministri ta shfrytëzojë gjithë kompetencën e vet, pas këtij ligji, që urgjentisht të intervenojë dhe të mos e aprovojë asnjë projekt që nuk do të jetë i shoqërueshëm bashkë me kopshtin, bashkë me oborrin, bashkë me kushtet elementare ambientaliste.

Personalisht, do ta përkrah dhe do ta votoj me kënaqësinë më të madhe. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Abazi!

Tani e ka fjalë zoti Adem Hajdaraj, të përgatitet zoti Riza Smaka dhe ndoshta është gabim, por Donika Kadaj është paraqitur përsëri për fjalë.

ADEM HAJDARAJ: Zotëri kryesues,

Ministra dhe deputetë të respektuar,

Unë e mora fjalën që, në radhë të parë, ta përgëzoj këtë ministri për një draft mjaft të mirë dhe sigurisht se do të kalojë në leximin e parë, por që të mos humbim kohë, unë do të ndalem në dy tri çështje, të cilat më duket se do të kontribuojnë, do ta japin ndihmesën për përmirësim të disa gjërave këtu.

Së pari, do të flas për titullin e projektligjit. Nuk ma thotë mendja se është formular mirë titulli. Domethënë, Projektligji mbi vlerësimi strategjik mjedisor nuk e pasqyron përmbajtjen dhe rëndësinë e qëllimit të këtij ligji. Kështu, mua më duket se do të ishte më mirë të jetë – Projektligji për strategjinë e vlerësimit të mjedisit. Pse e them kështu për strategjinë vlerësimit të mjedisit? Për arsye se përpara bëhet strategjia, e pastaj ajo strategji, në bazë të projekteve vlerësohen gjërat këtu. Domethënë, strategjia na mundëson që ta vlerësojmë mjedisin e jo mbi vlerësimin strategjik mjedisor dhe jo projektet dhe planet, sikurse thashë.

E dyta, edhe një herë po përsëris, s'është e tepërt, kanë thënë deputetët edhe në të kaluarën, e thanë edhe sot, po e themi edhe tash, se shpjegimet e nocioneve nuk bëjnë pjesë në dispozita të përgjithshme, e disa nocione mandej janë të njohura, si ministri, që e thanë edhe deputetët e nderuar më parë, por këto shpjegime më tepër në punime të ndryshme janë si fusnota, që mund të jepen në fund të ligjit, çka është kjo e çka është ajo, por jo gjithçka që është e kuptueshme, e ditur. Nuk po i përmend për arsye se u thanë, u përmenden, për të mos ua marrë kohën deputetëve të nderuar dhe të gjithë juve.

Një çështje tjetër, është një term këtu që mua më bie në sy dhe më duket jo i qëlluar. Ndonjëherë i marrim termat e huaj. Për shembull, këtu e kam fjalën, faqe 6, ku thuhet: “për habitatet natyrore”. Nëse e krahasojmë me gjuhët e tjera, habitetet nuk janë këto habitate, është term i huaj ky. Do me thënë, “On nature habitat san invite for”, por më duket se serbisht e kanë marrë në gjuhë “Prirodna stanishta” e jo “habitatet”, si fjalë e huaj që nuk ka hyrë as në fjalor, as nuk do të hyjë, veç për ata që i përkthejnë bukvalisht nga gjuhët e tjera.

Unë mendoj se duhet të jetë “banimet natyrore”, jo “habitatet natyrore”. “Banimet natyrore” do të ishte më mirë. Por, megjithatë, në komisione do të përpiqemi edhe për raste të tjera, që të mos e marrë kohën, të jap ndihmesën time. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hajdaraj! Dhe, i fundit në listë është zoti Riza Smaka, e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Disa vërejtje parimore, por shkurt. Do të përqendrohem, po e zëmë, në nenin 6 dhe nenin 13, sepse janë ofruar disa zgjidhje të panjohura pa precedencë, edhe sikundër të miratoheshin si të tilla, do të shkaktonin edhe probleme. Bie fjala, me nenin 6, ndër të tjera: “Në afat prej 28 ditësh, nga përcaktimi i bërë...” e tjera, e tjera, e tjera. Në procedurën administrative njihen këto afate, 3 ditë, 5 ditë, 8 ditë, 15 ditë, gati është standarde juridike administrative ndërkombëtare edhe bile, bile afatet më të shkurtra gjithmonë janë më efikase për palën, janë në favorin e palës, sepse edhe procedura kryhet, mbaron më herët, plus edhe mund të ndodhë që harron e tjera, e tjera. Edhe ashtu procedura nuk mund të jetë aq efiçiente, prandaj do të isha angazhuar që ta rishikojmë këtë në etapën që vijon.

Te neni 13, ju lutem, qe çfarë thuhet këtu, po e zëmë. Paragrafi 2, “brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të propozim - mendimit nga trupi përgjegjës i Ministrisë, ministri vendos për aprovim ose për refuzim të pëlqimit...” e tjera, e tjera. Këtu ministrin e vë në pozicionin e autoritetit administrativ të instancës së parë, sic, do të thotë është çështje pak që duhet të meditohet, po e zëmë. Mirë, rrjedhimisht, ja çfarë thuhet: “Ministri vendos për aprovim ose për refuzim të pëlqimit

dhe për këtë e njofton me shkrim autoritetin përgjegjës dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës.” Kuvendi, ju lutem, është tash këtu çështje parimore, që nuk mund ta tejkalojmë, të shkojmë më tutje. Kuvendi kurrësi, Kuvendi mund të njoftohet ndryshe, farë raporti, farë referati, farë informacioni, por jo edhe për rastet juridike administrative, individuale, se na do të shndërroheshim më pastaj në organ administrativ të shkallës së dytë, sipas kësaj zgjidhjeje. Kjo është e paprë dhe natyrisht nuk mund të pranohet kurrësi, në parim.

Më pastaj, thotë te paragrafi i tretë: “Ministri mund të mos pranojë propozimin, vendimi i trupit përgjegjës...” e tjera e tjera, nuk po hyjë në shprehje, por në alinenë e fundit, thotë: “Në këtë rast, vendimi i tij duhet t’i dërgohet Kuvendit...”. Kuvendit, neve, a? Do të thotë, vendimi i ministrit t’i dërgohet Kuvendit, për miratim. Kjo do të ishte, ju lutem, një formulim, një zgjidhje juridike me të vërtetë e pa parë, e pa njohur në praktikat e mira, flasim për praktikat e mira juridike administrative.

Më pastaj, me paragrafin e dytë, sikundër ta miratonim kësisoj, “Kuvendi do të shqyrtojë vendimin...”, do të thotë, ju zotëri kryesues, do ta kishit prezantuar, do ta kishim shqyrtuar, do të kishim diskutuar për vendimin e kujt, të ministrit, që është aktvendim në procedurën administrative. “Kuvendi do ta shqyrtojë vendimin, të cilin mund të miratojë...”. Qysh miratohet vendimi? Vendimi, domethënë, ose konfirmohet, ose priset. Ta refuzojë, aktvendimi nuk refuzohet, as nuk miratohet. Kjo edhe po të ishte, jo se Kuvendi nuk do të duhej të ishte organ, autoritet i instancës së dytë në procedurë administrative, ose të ndryshojë vendimin e ministrit e tjera, e tjera. Dhe përfundimisht, paragrafi i tretë. “Nëse Kuvendi nuk vendos brenda 30 ditësh nga njoftimi për”, këtu thotë “mbi vendimin e ministrit, duke u bazuar në paragrafin 3, paragrafin 2 të këtij neni...”. Shikoni, paragrafi 3 thirret, thirret mandej në të dytin të këtij neni, “do të konsideronte që”, domethënë “do të konsiderohej”, do të duhej të ishte “që Kuvendi e miraton vendimin e ministrit”. Edhe kjo është pikëpamje juridike e gabuar, se heshtja kurrnjëherë, as para epokës së re, edhe natyrisht pas saj kurrësi, nuk trajtohet në doktrinë as në praktikën juridike administrative, as civile, as penale, as ekonomike, se është miratuar akti, se këtu do të bëheshin malverzime, spekulime të papara nëpërmjet heshtjes e do të gjendeshin gjithmonë pretekste, ka qenë ministri në rrugë apo ka qenë pa qejf, pushim mjekësor apo ky e tjera, e tjera. Domethënë, është fjala, zotëri kryesues, për disa institute juridike administrative absolutisht të paqëndrueshme. Jo relativisht, se mund të bëjmë diçka e tjera, e tjera, domethënë koncept, gabim konceptor nocional juridik administrativ. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Smaka! Zonja Kaqusha, a është e vërtetë se po keni dëshirë ta merrni fjalën? Urdhëroni, se disa jeni paraqitur dhe zhdukur, kështu. Urdhëroni, zonja Kaqusha.

KAQUSHA JASHARI: Nuk e di, kjo teknika nganjëherë te unë po dështon, po shuket vetë, nuk e di. Unë shumë shkurt. Sa për këtë projektligjin, edhe në këtë pjesën e parë të shpjegimit thuhet se duhet të bëhet një ligj i cili duhet t’i plotësojë edhe kushtet, direktivat e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e sidomos është e theksuar pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje. Sa munden ata të jenë të përfshirë në diskutime dhe në qasje të institucioneve të cilat vendosin. Edhe unë mendoj se me këtë ligj është e përfshirë, por nuk kam mund ta gjejë një fuqi të respektimit të vendimeve.

Prandaj, unë mendoj se kjo pjesa e dytë e këtij ligji duhet të shikohet pak më me vëmendje, se mundet një organ, se gjithkund është ministria përgjegjëse, ministria përgjegjëse, duhet të ndahet edhe në këtë ligj përgjegjësia edhe e atyre që përgatisin vendimin për program, por sidomos në zbatimin e këtyre projekteve të cilat janë aprovuar. Ku është kontrolli i zbatimit në bazë të projektit. Prej praktikës e di që se programi është i mirë derisa aprovohet, por mandej janë disa ndryshime deri te destinacioni. Këtu mendoj se në këtë ligj duhet të ndahet përgjegjësia dhe kontrolli, këtu që po shkruan që pas tri viteve duhet të monitorohet zbatimi i ligjit, ajo është në rregull, por zbatimi në këtë ligj pas aprovimit fillon menjëherë. Shumë është e paqartë përgjegjësia e Ministrisë, pa një

ndarje më të ngushtë të përgjegjësisë të atyre që duhet të inspektojnë, e gjithashtu edhe për masat në qoftë se programet nuk aprovohen. Dhe, në fund, edhe ndërtimi i rrugës kërkon një pëlqim të vendit, fshatit, qytetit, e jo më për programet prodhuese, ku mund të kenë ndikimin negativ mjedisor në qoftë se nuk ka..., rrjeti i kanalizimit nuk është aty, në qoftë se nuk është teknologjia e avancuar. Kaq. Mendoj se në vazhdim të shqyrtimit të ligjit, do të bëhet një konkretizim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Jashari! Për fjalë është paraqitur Ministri Jagcilar, në fund të këtij debati.

MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit shumë, zoti kryesues!

Gjithashtu, falënderoj të gjithë deputetët për përkrahjen e ligjit, sepse është një ligj i nevojshëm, por është një ligj pak më specifik, ndoshta edhe teoretik, sepse hartohet një strategji për projekte të mëdha, ndërsa kur hartohet strategjia, atëherë sipas vlerësimit të ndikimit të mjedisit, bëhen ato çështje konkrete, çka nevojitet për projektin konkret.

Në këtë aspekt, unë mendoj sepse edhe këto përkufizimet “ministri” dhe “Mistria”, sepse në ligjet tjera në pakon e mjedisit nuk ekziston të shpjegohet ku ministri ka përgjegjësinë si staf politik, por ku Ministria ose sekretari i Ministrisë ka përgjegjësi, sepse kërkohet edhe sipas direktivave evropiane. Ky ligj është gjithashtu në Raportin e progresit evropian. Besojmë që me aprovimin do të përmbushim edhe një kusht, kështu që mendoj se është një ligj, ka elemente edhe juridike, por edhe mjedisore, por është edhe një ligj shumë teoretik, sepse kërkohet hartimi ose krijimi i një strategjie për realizimin e projektit, ndërsa kur fillohet me projektin, atëherë vjen Ligji i ndikimit në mjedis, me çështjet konkrete. Edhe njëherë, falënderoj për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Tani ka ardhur radha që të deklarohejmë me votim për miratim në parim të këtij Projektligji. Do të verifikojmë numrin e deputetëve të pranishëm. Janë 75 dhe mund të hyjmë në votim. Prandaj, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Dati, votojmë tash:

Me 68 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, së këndejmi ky projektligj miratohet, në parim. Ju faleminderit!

Tani, të kumtojmë edhe ato që duhet. Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

E dimë tashmë se brenda dy muajve, komisionet duhet t’i paraqesin raportet me rekomandime për këtë projektligj.

Shkojmë, në qoftë se pajtoheni, shkojmë edhe te pika e pestë e rendit të ditës, të paktën t’i kryejmë këta shefat e grupeve parlamentare, në qoftë se nuk jemi të uritur aq tepër. Pika e pestë është:

5 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje të konkurrencës

Ta kemi të qartë se në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji, kështu që kam nderin ta ftoj ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, zotin Zharku, që në emër të Qeverisë ta prezantojë këtë projektligj.

MINSITRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mbrojtja e konkurrencës në treg është parakusht për lëvizjen e lirë të mallrave dhe të shërbimeve, krijimin e një ekonomie të qëndrueshme, krijimin e kushteve të favorshme për mbrojtjen e investimeve, si vendore ashtu edhe të huaja, mbrojtjen e jetës, të shëndetit dhe të drejtave të konsumatorëve.

Funksionimi i Komisionit të Konkurrencës për më tepër se një vit, ka bërë të mundur që të shihen të metat e zbatimit të ligjit aktual në fuqi. Hartimi i Projektligjit të ri, është me qëllim që të eliminohen disa kolizione në vetë ligjin aktual dhe me ligjet tjera, të jetë më i zbatueshëm dhe në interes të ekonomisë sonë, si dhe të përafrohet me legjislacionin e BE-së. Disa nga ndryshimet themelore të cilat janë propozuar me Projektligjin e ri, janë: emërtimi i ligjit nuk ka qenë adekuat në objektivat dhe fushën e mbulimit të tij. Prandaj, është e riemërtuar në Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, që është praktikë edhe e vendeve të rajonit. Është ridefinuar Komisioni për rishqyrtim, i cili sipas nenit 36 dhe 37 të ligjit aktual, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/44, përbëhet prej 3 anëtarësh, përfshirë një përfaqësues të UNMIK-ut. Janë eliminuar kolizionet e ndryshme në kuadër të ligjit dhe të Rregullores së UNMIK-ut mbi shpalljen e ligjit. Në ligjin aktual nuk ka qenë e përfshirë çështja e përqendrimit të ndërmarrjeve, si një fushë në vete për rregullimi e konkurrencës dhe tani ky kapitull është përfshirë në tërësi në projektligjin e propozuar.

Rëndësi të veçantë në këtë Projektligj i është kushtuar procedurës për fillimin dhe zhvillimin e hetimeve të rasteve të marrëveshjeve të ndaluara në formë kartelesh dhe përqendrimin e ndërmarrjeve me qëllim të krijimit të pozitës dominuese, si dhe abuzimin me pozitën e tillë.

Në projektligjin e propozuar përfshihen këto dy lloje të marrëveshjes të ndaluara, horizontale dhe vertikale, si dhe llojet përjashtuese të tyre me vendosjen e një neni të e plotë për mënyrën e aplikimit dhe lejimit të përjashtimit. Po ashtu, me projektligjin e propozuar janë përafruar dispozitat me legjislacionin e BE-së, dispozitat që lidhen me pozitën dominuese dhe shpërdorimin me këtë pozitë, pozicioni në treg të ndërmarrjes nën hetim dhe të konkurrentëve të saj, mundësia për ekspansionin në treg të konkurrentëve të ndërmarrjes dhe pengesat e hyrjes në treg të konkurrentëve të ri potencial, si dhe fuqia kundërvepruese klientëve, gjegjësisht konsumatorëve.

Janë ridraftuar dispozitat të lidhen me funksionimin e komisionit dhe procedurat e përgjithshme administrative. Po ashtu, është definuar çështja e konfliktit të interesit të anëtarëve të komisionit, duke i përjashtuar përkohësisht nga vendimmarrja në rastet kur kanë konflikt interesi me një ndërmarrje e cila është nën hetim në një proces të caktuar. Kjo është qartësuar me deklaram të konfliktit të interesit të çdo anëtari të komisionit, para mbledhjes së komisionit për vendimmarrje.

Me projektligjin e propozuar janë ndryshuar dispozitat që kanë të bëjnë me procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit, si dhe mandatin dhe zgjedhjen e kryesuesit dhe të zëvendës kryesuesit, të cilat nuk kanë qenë të definuara me ligjin aktual. Në funksion të krijimit të një zhvillimit të qëndrueshëm të institucionit, kemi propozuar që anëtarët si dhe kryesuesi, e zëvendës kryesuesi të emërohen me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi.

Çështje tjetër është edhe dispozita 29.1, pika b) e ligjit në fuqi, e cila i lejon komisionit të marrë funksione të cilat iu përkasin institucioneve të akuzës dhe që lidhen me aspekte penale, aspekte të cilat nuk i ka ky ligj që t'i mbulojë. Tejkallimi i kompetencave vërehet edhe në nenin 30, andaj me

projektligjin e propozuar ka qenë e domosdoshme që në këto dispozita të ndërhyhet dhe të ndryshohen.

Po ashtu, është shtuar dispozita përmes së cilës garantohet dhe ruhet fshehtësia e kallëzuesit dhe e të dhënave të depozituara në autoritetin e konkurrencës. Masa e shqiptimit të sanksioneve administrative është harmonizuar me të gjitha ligjet për mbrojtjen e konkurrencës të shteteve të rajonit, duke i ikur diskriminimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në raport me ndërmarrje të mëdha.

Të nderuar deputetë,

Me eliminimin e këtyre të metave në ligjin aktual, do të kontribuohet në përmbushjen e kërkesave për fillimin e procesit të negociatave në marrëveshjen e stabilizim – asocimit. Në fund, më lejoni të theksoj se përkundër afatit shumë të shkurtër kohor të funksionimit të Komisionit të Konkurrencës, Republika e Kosovës, më 4 maj 2009, është pranuar në rrjetin ndërkombëtar të konkurrencës, si shteti i 107-të me të drejta të plota. Ju faleminderit, për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Në emër të komisionit funksional, kam përshtypjen e zotëri Zef Morina, është paraqitur. A ka dikush në emër të komisionit që është paraqitur? Jo. Atëherë, shkojmë sipas grupeve. Në emër të PDK-së, zonja Sala Berisha Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA SHALA: Ju faleminderit, kryesues!

Përsëritje zëvendëskryeministër,

Ministra prezentë,

Kolegë deputetë dhe ju të pranishëm

Në shqyrtim e kemi Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar me vëmendje projektligjin në fjalë. Projektligji vjen në kohën e duhur, vjen në momentin kur është vlerësuar se është e nevojshme të ndryshohet ligji në fuqi dhe të përshtatet konform rrethanave në të cilat kalon Kosova. Unë do të përpiqem të jem shumë e shkurtër, meqenëse edhe po shihet një indisponim edhe tek deputetët. Meqenëse ky projektligj vjen edhe në komisionin parlamentar, pjesë e të cilit do të jemi, vërejtjet tona do t'i japim gjatë fazës së amendamentimit në komision, por para kësaj më lejoni t'i them disa vërejtje që janë vërejtur në këtë dokument që e kemi në fjalë. Janë disa shprehje të panevojshme, për shembull, tek nenet e caktuara, nxjerrja e udhëzimeve administrative që parashihet në nenin 8, nuk ka afat të caktuar, që unë mendoj që ky ligj të ketë efektin e vet dhe të jetë i zbatueshëm, duhet të caktohet afati se kur Ministria do t'i nxjerr udhëzimet administrataive, në mënyrë që të ketë efektin e duhur ky ligj.

Mandej, janë disa shprehje të panevojshme tek neni 15 dhe nenet tjera, siç janë, për shembull: “mund që në raste të ndryshme”. Kjo lë hapësirë për shumë kuptimësi gjatë zbatimit të ligjit. Përdoren edhe shprehje tjera, siç janë: “procedurë e shkurtër”, edhe kjo duhet ta ketë një afat se sa është ajo procedurë e shkurtër, me ditë, me javë, me muaj. Mandej, neni 20, prapë kemi shprehje të tilla, siç thotë: “pa vonesë ta njoftojë ndërmarrjen”, ndërsa ndërmarrjes i kërkohet afat i caktuar prej 30 ditësh që t'i plotësojë kushtet e saj. Edhe kjo “pa vonesë” është një shprehje, mund të them, kështu, abstrakte dhe duhet të caktohet se sa është ajo “pa vonesë”. Mandej, te neni 20, paragrafi 9, thuhet: “përqendrimi me kusht”, edhe kjo mendoj është një shprehje abstrakte, “afatet e caktuara në mendim” e kështu me radhë.

Krejt në fund, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet ligjin në fjalë dhe vërejtjet tona, edhe si komision, do t'i marrim vërejtjet të cilat do të dalin edhe nga shqyrtimi i këtij ligji nga seanca plenare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Zef Morina.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zonja e zotërinj,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, pas shqyrtimit të Projektligjit për mbrojtjen e konkurrencës mendon se një ligj i tillë i nevojitet shumë vendit tonë, pasi që përmes këtij ligji do të eliminohen parregullsitë që pengojnë konkurrencën e lirë.

Ligji aktual për konkurrencën nr. 2004/36, nuk përcakton kompetencat, detyrat dhe organizimin e autoritetit për mbrojtjen e konkurrencës kështu që, si i tillë, është treguar jo i suksesshëm. Me këtë projektligj përcaktohen organizmat për zbatimin e ligjit, duke filluar nga autoriteti i konkurrencës, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, e tjerë, si dhe përgjegjësitë që i kanë këto organe të përcaktuara me këtë ligj.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah, në parim, dhe përmes komisioneve do të kontribuojë në amendamentimin dhe eliminimin e mangësive eventuale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Morina!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ne, si Grup Parlamentar, në parim e përkrahim projektligjin, megjithëse me shumë vërejtje, sepse është dashur të vijë si plotësim, ndryshim i ligjit, po del para publikut sikurse po ndërtojmë ligje të reja. Është një plotësim ndryshim, pikërisht duhet të ndërhyhet në këtë drejtim të shumë projektligjeve që vijnë kur janë në plotësim-ndryshim, sepse me këto dispozita, me hyrjen në fuqi të këtij propozimi që e ka sjellë Qeveria, shfuqizohen dispozitat e Ligjit 2004/36 për konkurrencën. Ne kemi vërejtje gjatë tekstit të projektligjit në shumë dispozita ligjore. Isha fokusuar te neni 24, dispozita e dytë, ku thotë: “autoriteti i konkurrencës është person juridik, me seli në Prishtinë”, thua se jemi duke biseduar për një organizatë joqeveritare, statutin e saj apo ndonjë subjekt politik, përderisa dihet se është pjesë e institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës. Edhe më herët, por edhe me këtë tekst të këtij projektligji, që ka ardhur në këtë rast nga ministria, është e përcaktuar se vetë fjalët, sepse është bërë në memorandumet shpjeguese praktikë të na tregojnë shpesh se çka është ndërmarrja publike, autoriteti publik edhe forma të tjera. Kryesisht, te e njëjta dispozitë, te i njëjti nen, te dispozita numër 4, “struktura e brendshme dhe mënyra e punës dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e autoritetit, rregullohen me statut të cilin e nxjerr autoriteti”. Për rregullimin e brendshëm duhet të formohet organogram, sikurse të gjitha dikasteret tjera, drejtoritë me organogram, jo me një statut të veçantë të rregullohet edhe të fryhet ajo, të bëhet dhe nuk është çështje stautare kjo, mund të hartohen akte nënligjore për mbarëvajtjen e punës dhe forma tjera, jo statut, të hiqet kjo nga natyra e ndërtimit të ligjeve.

Neni 25, pika 4, “kryetarin, zëvendësin, anëtarët i emëron dhe i shkarkon Kuvendi me propozimin e Qeverisë”. Është mirë të emërohen nga Kuvendi dhe flitet në nene tjera pasuese se i raportojnë Kuvendit këto të gjitha, ndërkaq për shkarkimin është edhe pjesa tjetër të masat ndëshkimore, por edhe të drejta për t’u zgjedhur apo për të mos u zgjedhur, të vazhdojë apo mos të vazhdojë me mandatin e tij. Është e rregulluar kjo në Projektligj dhe besoj se disa ndërhyrje tjera janë të panevojshme, mos t’i jepet kjo e drejtë Qeverisë, meqenëse ligji e sanksionon sa mund të vazhdojë, por është periudha raportuese që e rregullon këtë çështje.

Ndërkaq, e kemi edhe te neni 70, ku flitet për vazhdimin e mandatit që, para nxjerrës tash të këtij projektligji, iu vazhdohet mandati anëtarëve. Ne e dimë se Kuvendi e ka zgjedhur edhe atë komision që është funksional dhe me përfundimin e mandatit të tij, jo të përcaktohen me ligj efekte prapa vepruese apo diçka tjetër ose të hiqen fare, sepse janë të zgjedhur. Me kalimin e mandatit apo me shkëlqen e përgjegjësi që kanë ata, mund të shkarkohen nga Kuvendi. Besoj se do të japim kontributin tonë edhe në komisionet parlamentare, por gjithmonë duke shpresuar. E përkrahim. Ligji nuk ka kosto financiare, do të thotë është vetëm një plotësim ndryshim për fushat që nuk kanë qenë të rregulluara, sepse këtu efektin e vet e kanë edhe doganat e Kosovës, që në periudha të caktuara të mëhershme nuk kanë qenë përgjegjësi e institucioneve të Republikës, kanë qenë edhe nën përgjegjësi të UNMIK-ut, por edhe gjithë mekanizmat tjerë ndërqeveritar, ndërministror që janë të implikuara në këtë projektligj, po e them ... tash edhe pse ka ardhur si formë e projektligjit të ri. Ne e përkrahim duke mos iu ndaluar të drejtën edhe anëtarëve të tjerë të grupit parlamentar që të ndikojnë gjatë këtij leximi, në parim, të Projektligji deri në përfundim. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Shkumbin!
Për Aleancën Kosova e Re, flet zonja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin dhe dy ministrat që janë prezent dhe për të gjithë deputetët që janë prezent në këtë seancë.

Aleanca Kosova e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës. Duke marrë parasysh se aktualisht ekziston një ligj i cili është në fuqi për konkurrencën 2004/36, mirëpo ligji aktual nuk ka të përcaktuar kompetencat, detyrat dhe organizimin e autoritetit për mbrojtjen e konkurrencës, si dhe procedurat në lidhje me zbatimin e këtij ligji, me ligjin e ri përcaktohen qartë emërimi, gjithashtu që ky projektligj i propozuar është i përafërt me ligjet dhe direktivat e BE-së. Komisioni Kosovar i Konkurrencës, si kategori kushtetuese, paraqet instrument të rëndësishëm në drejtim të vendosjes së një shoqërie demokratike, ku konkurrenca e lirë është bazë e zhvillimit. Duke marrë parasysh se një mungesë e madhe e neneve, të cilat kanë qenë në projektligjin e mëparshëm, nuk kanë mundur të gjejnë zbatueshmi dhe koha e tyre është në kundërshtim me ambientin në çfarë ndodhet tani Kosova, ambientin ekonomik, dhe rregullativat e UNMIK-ut, të cilat janë përfshirë në Projektligjin e mëparshëm, është paraqitur nevoja që të draftohet një ligj i ri, me direktivat e BE-së dhe t'iu afrohet definitivisht vendeve në rajon për zhvillimin e konkurrencës. Për këtë arsye, unë e shoh shumë të mirëpritur Ligjin e ri për konkurrencën, i cili mund t'i jap një mundësi të mirë dhe një precizitet më të madh, në mënyrë që ky ligj të implementohet në praktikë.

Duke marrë parasysh se zhvillimi ekonomik i një vendi varet nga konkurrenca dhe konkurrenca gjeneron zhvillim dhe prosperitet në kuptim të rritjes së gjithë indikatorëve ekonomikë dhe të mirëqenies së një vendi, një shoqërie, atëherë në këtë projektligj parashihet çështja e autoritetit të konkurrencës, i cili në vete do të ketë një bord të rëndësishëm dhe për ta mundësuar këtë bord, duhet të plotësohet kuadri ligjor dhe profesional për mbrojtjen e konkurrencës së mirëfilltë dhe për afrimin e saj në të gjitha nivelet me anë të ligjeve të BE-së. Vetëm kështu Kosova mund të ndërtojë një ekonomi të qëndrueshme të tregut të lirë, të mbështetur në baza të forta ligjore dhe institucionale që garanton zhvillim dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e vendit.

Uroj që ky ligj të draftohet në mënyrë sa më të shpejt edhe nga komisioni parlamentar, në të cilin kemi përfaqësues të të gjitha partive, kur dihet se edhe në Raportin e progresit është paraqitur nevoja që Ligji i konkurrencës dhe autoriteti i konkurrencës të ketë kompetenca më të mëdha, si rregullator i zhvillimit ekonomik të vendit. Me gjithë mirëkuptimin dhe disa vërejtje të cilat mund të jenë ndoshta edhe vërejtje teknike, Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah Projektligjin për konkurrencën dhe shpresoj që do të përfundohet shumë shpejt edhe leximi i dytë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Selmani!

Në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, fjalën e ka zonja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ministra, deputetë të nderuar,

Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës Lidhja Demokratike e Dardanisë e konsideron të rëndësishë së veçantë, duke pasuar parasysh që konkurrenca është si një fenomen i ri në tregun kosovar, nuk është zhvilluar si duhet dhe nuk është pjesë e mirëfilltë e kulturës së biznesit në Kosovë për arsye shumë të ndryshme.

Disa nga arsyet për këtë janë: Ligji aktual për konkurrencën, i miratuar në vitin 2004, fatkeqësisht nuk ka gjetur zbatueshmëri për shkak të shumë mangësive që ekzistojnë në dispozitat kyçe për mbrojtjen e konkurrencës. Pastaj, themelimi i Komisionit Kosovar të Konkurrencës, me vonesë prej katër viteve që ka filluar të funksionojë në fund të vitit 2009. Duke u bazuar në raportin e këtij komisioni, që e kemi shqyrtuar këtë vit në Kuvend, është shumë e evidente, mungesa e vullnetit politik të institucioneve tona për të përmirësuar konkurrencën në tregun tonë, duke përkrahur ndërtimin e strukturave të nevojshme për implementimin e ligjit.

Ajo që duhet theksuar është se edhe gjetjet e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009, janë se ekonomia e Kosovës vlerësohet tejet e dobët dhe jo konkurruese. Andaj, hartimi dhe implementimi i ligjeve efektive në fushën e ekonomisë, sikurse Projektligji për mbrojtjen e konkurrencës, do të duhej të sillte dobi për tërë shoqërinë, duke i dhënë dinamizim dhe ndershmëri aktivitetit ekonomik në vendin tonë. Projektligji i propozuar përcakton qartë emërtimin e tij, përcakton rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe është i përafëruar me direktivat e Bashkimit Evropian.

Risi që kemi në këtë projektligj, është kapitulli për përqendrimin e ndërmarrjeve, që është shumë me rëndësi, e që në ligjet e shteteve të rajonit ka kohë që ekziston. Ky projektligj përcakton njoftimin për qëllimin e realizimit të përqendrimit, procedurat e vlerësimit të përqendrimit, veçanërisht kur përqendrimi krijon pozitë dominuese në treg, si dhe masat për realizimin e paligjshëm të përqendrimit. Risi, gjithashtu, në këtë Projektligj, që sipas nenit 24 është paraparë themelimi, funksionimi dhe organizimi i autoritetit të konkurrencës në Kosovë, që do të ishte i pavarur në kryerjen e detyrave të veta dhe do t'i përgjigjej Kuvendit. Dilemat tona rreth këtij autoriteti mbështeten se i tërë Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka stafin e limituar prej 18 vetash, me buxhet tanimë të aprovuar, që në bazë të vlerësimeve të implikimeve buxhetore, nuk do të ketë implikime shtesë, që do të thotë se nuk parashihet punësim i stafit shtesë.

Kjo vlen të kuptohet që nga stafi ekzistues do të krijohet autoriteti për mbrojtjen e konkurrencës, që do të financohet nga buxheti i Kosovës dhe kjo, natyrisht, shtrën pyetjen e pavarësisë së këtij organi. Kryesisht, Projektligji i ri me shumë ndryshime dhe përshtatje me Rregulloret e Bashkimit Evropian, për të qenë i zbatueshëm do të kërkojë, mbi të gjitha, ngritjen e kapaciteteve të Komisionit Kosovar të Konkurrencës, duke përfshirë ngritjen kuantitative dhe kualitative të personelit, zgjerimin e kushteve të punës dhe, natyrisht, ngritjen e buxhetit. Kosova ka shumë sektorë të ekonomisë, ku Komisioni Kosovar i Konkurrencës do të mund të hetojë për konstatimin e pozitës dominuese apo të marrëveshjeve të kundërligjshme, si për shembull: tregu bankar, nga se vazhdon të dominohet nga tri bankat që ndajnë 90% të tregut në Kosovë dhe normat mujore të interesit janë shumë të përafërta. Tregu u telekomunikacionit. Kosova është i vetmi vend në rajon ku në tregun e telefonisë mobile janë të licencuar dy operatorë, duke përjashtuar ata virtual, e çmimet e këtyre operatorëve janë pothuaj se të njëjta. Apo si një shembull eklatant, në shëndetësi është

Hemodializa. Ky është keqpërdorim i pozitës dominuese që tash e 10 vjet me aparaturë dhe material shpenzues specifik, i cili është i lidhur me aparaturë dhe nuk lejohet alternativë paralele dhe me çmimin e refuzimit të aparaturës si donacion, gjithmonë duke cenuar interesin e pacientit. Si rezultat i moszbatueshmërisë së gjertanishme të Ligjit për konsumatorët, gjegjësisht qytetarët e Kosovës paguajnë çmimin më të lartë të telefonisë mobile, fikse, të internetit, paguajnë norma të larta për hua të marra dhe fiton norma të ulëta interesi në kursime apo paguan më shtrenjtë se të tjerët derivatet e naftës.

Në fund, Lidhja Demokratike e Dardanisë e mbështet, në parim, Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës, e konsideron të rëndësishëm dhe kërkon nga institucionet vendimmarrëse të fuqizojnë zbatueshmërinë e tij, gjithmonë duke pasur parasysh efektin përfundimtar të tij, që është mbrojtja e konsumatorit, gjegjësisht e qytetarit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Morina!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+" zoti Enis Kervan e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Rekabetin korunmasina ait Yasa Tasarisinin amacini, piyasada, şirketler ile ticari özneler arasında adil ilişkilerin sağlanması teşkil etmektedir. Bu yasa tasarısını dikkatle okuduk ve oldukça ayan olduğu kanısına vardık. Sözkonusu yasayı hazırlayanın, piyasada özgür rekabetin düzenlenmesi amacıyla kapsamlı bir metin hazırlama çabasında bulunduğu görülmektedir.

7+ Parlamento grubu olarak bu yasa tasarısını incelerken, çeviri konusunda, daha doğrusu terimlerin kullanımında bazı hataların var olduğunu farkettilik. Bu tasarının, nadir anlamlı ve ayan bir tasarı olmasına rağmen, dil hataları ile bazı mantıksız formülasyonların düzeltilmesinin gerekli olduğu düşüncesindeyiz.

7+ Parlamento grubu olarak bu yasa tasarısının birinci okunuşunu kabul ediyoruz ve ikinci okunuşuna kadar katkılarımızı Fonksiyon Komisyona sunmuş olacağız. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Enis!

Në emër të Grupit SLS, zoti Mursel Halili e ka fjalën!

MURSELJ HALJILJI: Hvala, gospodine predsedavajući!

Poštovani svi,

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala ovaj nacrt zakona i imamo neke primedbe, koje bih u narednim trenucima preneo Skupštinu.

Član 8. formulacija ili definicija: „sporazum male vrednosti“ mislim da sama formacija u stavu 1. nije dovoljna, jer ne određuje koji bi sporazum mogao da bude male vrednosti. Smatramo da bi trebalo procentualno odrediti koliko iznosi tržišni udeo nekog učesnika, bilo u sporazumu horizontalnom ili vertikalnom, takođe smatramo da u članu 10. gde se definiše dominantni položaj takođe u stavu 1. nije baš precizno definisano šta znači: „dominantni položaj na tržištu“. Smatramo da bi trebao takođe procentualno odrediti koliko iznosi, smatramo recimo u regionu je taj iznos 40% i više. Tađe, što se tiče dominantnog položaja kada su u pitanju dva ili više samostalnih preduzeća, takođe treba definisati procentualni udeo njihov, koji bi mogao da se podvede pod dominantni položaj. Smatram da bi recimo procentualno bilo 50 i više, to su takozvane kolektivne dominacije. U članu 13. na, ... koncentracije preduzeća, mi smatramo da bi naslov trebao da bude promjenjen i da

glasi: „Koncentracija učesnika na tržištu“, obzirom da jeste da su preduzeća najrasprostranjeni oblik privrednih subjekata, međutim učesnici na tržištu nisu samo preduzeća.

Smatramo da u ovom delu, znači u glavi V, treba da se doda novi član i da se precizno definiše, recimo pravna ustanova, dozvoljenost koncentracije, jer smatramo da u ovom nacrtu zakona to nije učinjeno. Zatim, smatramo u članu 25. gde se govori o Komisiji zaštite konkurencije, smatramo da se samo u tom članu i stavovima koji su pred nama, samo se definiše predsednik komisije, a ostala četiri člana mogu da jednostavno spavaju i da ništa ne rade. Smatramo da bi trebalo da se definiše i njihov udeo u svemu tome, možda kroz neku formu saveta i da i ti članovi, ta četiri člana trebalo bi da nešto rade ako su deo komisije, ne samo predsednik. Možda bi bilo potrebno u ovom istom članu da se posebno da nova odredba o finansiranju komisije, jer ne postoji to, ako ne postoji finansiranje, smatramo da neće biti to dobro za rad.

Takođe smatramo da bi trebalo da postoji poseban član koji se tiče sudske kontrole, rešenja komisije i sudskog postupka i da je to veoma bitno, i sama materija o zaštiti konkurencije nam o tome govori, međutim Parlamentarna Grupa SLS je naravno primetila neke primedbe što se tiče formulacije definicije pojmova u Nacrtu zakona i mi ćemo to u radnim grupama pokušati da ispravimo, naravno i ove druge primedbe. Naša takođe jedna od glavnih primedbi je da je vladina komisija, odnosno vladina radna grupa sastav njen i sastav stručnjaka i posmatrača, nas navodi na to da možemo dati primedbu da nema predstavnika manjinskih zajednica, i kao posledica svega toga, možda je i jedna odrednica koja se nalazi u delu – Opšti komentari za Nacrt zakona, gde se spominje da je verzija na albanskom i engleskom razmatrana i usklađena, a verzija na srpskom jeziku nije analizirana, pa samim tim može doći do nekih nejasnoća koje mi želimo kao Parlamentarna grupa da izbegnemo.

Po principu, mi ćemo podržati i u načelu podržati ovaj nacrt zakona, naravno da ćemo dati svoj doprinos u radu parlamentarnih komisija. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Halili!

Në emër të Grupit për Integritet, fjalën e ka zoti Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Ju faleminderit, zotëri kryesues i Kuvendit!

Ja ću takođe dati nekoliko kratkih principijelnih, dodatak u vezi sa ovim zakonom, sa tim što bih se naravno složio, moramo to prvo istaći, sa najvećim dijelom prijedloga koji su dali prethodni zastupnici iz parlamentarnih grupa. Mi ćemo takođe podržati ovaj zakon i dati svoj doprinos u radu komisija i amandamentiranja putem komisija. Takođe, da se obratim samo kratko na ove dvije stavke, da se ne bismo ponavljali, koje se tiču ovih koje smo do sada čuli, a posebno za izbore članova komisije koje bi takođe, slažem se sa prethodnim kolegom, trebale biti mnogo jasnije i omogućiti kvalitetan, stručan, profesionalan sastav komisije, ali i odgovarajuću zastupljenost svih entiteta i ... predstavnika svih zajednica. Takođe sam pratio prijedloge pojedinih članova grupa i slažem se takođe s time da rokovi o kojima je govoreno, trebaju biti mnogo jasniji određeni, da postoje na određenim mjestima ako su u pitanju rokovi, više uopštenih izraza i da ti uopšteni izrazi ne bi trebali da postoje u tom obliku, nego da se treba jasno precizirati rokovi za donošenje određenih odluka kako bi ovaj zakon, i time ovo dovršavam, zaista omogućio da u skladu sa novim potrebama, sa novim vremenom, novom ekonomskom situacijom izbjegao sve one nedostatke koji su postajali dosadašnjem zakonu i omogućio da konačno imamo jedan zakon koji je primenjen, koji je vrlo važan i koji će omogućiti konačno jedan prosperitetan ekonomski napredak Kosova, ono što uostalom svi čekamo. Hvala vam lijepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Baliq!

Për debat i kemi vetëm dy deputetë dhe unë besoj se do ta kemi durimin t'i dëgjojmë para se të marrim pushimin e merituar për drekë. I pari është zoti Fatmir Rexhepi dhe, natyrisht, Gjylnaze Syla, pas tij.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit!

Përshëndetje, drejtues i seancë!

Ministra, zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Sigurisht që nuk ju marrë shumë kohë, ani pse thonë nganjëherë deputetë e vazhdojnë, por megjithatë arsyeja është kjo që t'i bashkëngjitem asaj rëndësisë së madhe. Unë besoj që Ministria, projektin tani që e ka prurë, e ka parasysh gjithë përvojën çka ka ndodhur në tregun e Kosovës gjatë këtyre viteve, qoftë me moszbatimin, qoftë me pengesa, qoftë me defekte në projektligjin ekzistues. Prandaj, edhe kjo që është dhënë, nga ajo që unë kam lexuar, e shoh që është me shumë interes për rregullimin dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës.

Një prej objektivave kryesore tona dihet, është transparenca, që ende nuk po mund ta mbërrijmë atë shkallë dhe, e dyta, është konkurrenca, pra, krijimi i ambientit të tregut të lirë. Një përpjekje e përditshme, prandaj ky draft megjithatë shkon një hap përpara dhe unë besoj që përveç autoritetit që iu kanë dhënë përgjegjësi më të mëdha, që është mirë, të kemi edhe dy çështje para sysh, te dy kapituj, në parim. Kapitulli i tretë, që ka të bëjë me përjashtimet dhe lejimet, pra gjithashtu që lidhet me marrëveshjet për arsyetimin e këtyre masave dhe të kufizimeve, të veprimtarive ekonomike dhe të lirive tregtare. Këtu ka nevojë, pra, për plotësime të tjera për ta përmbushur një standard që na duhet neve të kemi në kuadër të këtyre, që po e themi, janë kompatible me standarde të ekonomisë të tregut të lirë. Vërejtja e dytë, që ka të bëjë në parim, është po ashtu te kapitulli IV, që ka nevojë, nga ajo që kam lexuar, të kemi pra një kujdes më të madh kur është fjala te kontratat në mes të ndërmarrjeve, abuzimin dhe pozitën dominuese. Këtu ka rëndësi të madhe se çfarë shkruajmë më tutje brenda këtij Projektligji, në mënyrë që realisht kjo ta ketë atë masë, e cila iu përgjigjet pastaj atyre veprimeve tjera që duhet t'i merr autoriteti, në mënyrë që mos ta dëmton as ndërmarrjen, por në anën tjetër ta mbrojë dhe ta ruajë konkurrencën e brendshme.

Prandaj, rëndësi të veçantë duhet kushtuar edhe një çështjeje që e kemi përmendur disa herë - zbatimit të projektligjit. Nuk mundemi, pra, të kemi zhvillim të biznesit të mirë, nuk do të kemi investime të ndërmarrjeve, rritjen e tyre qoftë vendore, qoftë të huaja në vendin tonë, në qoftë se e kemi këtë shkallë të lartë të ekonomisë së zezë. Realisht, treguesit nga ata që i përcjellin zhvillimet brenda vendit, e thonë domethënë që kemi shumë, kështu që zbatimi nga Ministria, autoriteti përkatës i këtij projektligji ka rëndësi shumë të madhe për ambientin ekonomik që e zhvillojmë. Pra, përveç atyre pjesëve që t'i bëjmë ligjore, mendoj që shumë punë mbetet për t'u bërë në zbatimin dhe implementimin, sepse ka impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e ekonomisë, të konkurrencës së shëndoshë dhe eliminimin e ekonomisë të zezë. Prandaj, e përkrahim në parim dhe do të punojmë bashkërisht në komisione. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Fatmir! Tani radhën e ka zonja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Zoti ministër, unë kisha filluar me një bindje time se më mirë do të ishte që të zbatohet ligji aktual dhe të zhvillohet konkurrenca konform dispozitave ligjore dhe, në këtë aspekt, sidomos të fillohet me ndryshimin e konceptit të vetë Qeverisë. Në këtë aspekt dëshiroj t'i përmend dy raste të rëndësishme. Një, është mos zhvillimi i konkurrencës në sektorët vital, siç është sistemi energjetik,

por edhe sistemi bankar. Futja në një pako e termocentralit tenderues, të Termocentralit “Kosova C” apo “Kosova e Re” siç e quan tani Qeveria, por edhe të “Kosovës B” menjëherë e krijon monopolin. Realisht, e keni veç transferin e monopolit nga ai shtetëror në atë privat, kurse në sistemin bankar, mungesa e konkurrencës ka mundësuar krijimin e një sistemi kreditor, i cili është më i disfavorshmi për qytetarët e Kosovës. Prandaj, zoti ministër, filloni nga Qeveria ndryshimin e konceptit. Tjetra, është zhvillimi i politikave të cilat do të kishin efekte pozitive ekonomike dhe, natyrisht, si qëllim të fundit edhe mbrojtjen e konsumatorëve dhe përfitimin për konsumatorët. Tani atë çka është propozuar nga Ministria, besoj se ka mundur të bëhet vetëm me ndryshim- plotësim të ligjit, sesa me një ligj krejt tjetër. Ju e shtruat se një ndër arsytet pse është sjellë ligji, është gjithashtu se duhet përmbushur kërkesat për negociatat për marrëveshjen e stabilizim – asocimit. Edhe ndryshim – plotësimet e nevojshme do t’i përmbushnin këto kërkesa. Prandaj, konsideroj se duhet të quhet jo si projektligj i ri, por ndryshim-plotësim i ligjit aktual, ndërsa sa i përket organit kryesor apo mekanizmit kryesor i cili është në qendër të këtij ligji, që ka të bëjmë me autoritetin e konkurrencës, megjithatë përgjegjësitë dhe funksionalizimi i tij shumë më tepër do të varet nga mënyra se si do të finanohet. Në qoftë se është Komisioni Kosovar i Konkurrencës ai që menaxhon punën e autoritetit dhe në qoftë se nuk ka autoriteti një buxhet të veçantë, nuk arrihet qëllimi i ligjit që ky të jetë i pavarur. Në fund të fundit, komisioni nuk është se ka bërë ndonjë punë të madhe. Deri me tani ka arritur realisht vetëm deri te furrtarët, kurse pa veprim për rastin, t’ju kujtoj, kur Qeveria pat vënë monopol mbi importin e mishit.

Zoti ministër, këto ishin mendimet e mia, kërkoj, ndoshta ju mund t’i arsyetoni. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Sylja!

Në sallë janë 61 deputetë, kështu që mund të hyjmë në procesin e votimit dhe ju lus edhe juve, edhe regjinë që të bëheni gati dhe votojmë tash:

Shumë bukur, kanë dal më tepër se 61 që unë i paralajmërova.

Janë 64 “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, kështu që në parim është miratuar ky projektligj.

Natyrisht, ne e kemi konsultuar ministrin përpara se a do ta marrë fjalën dhe është deklaruar se jo, prandaj në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Në këtë mënyrë, deri në orën 15:00, ne bëjmë pauzë për drekë dhe për gjëra të tjera. Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, mund t’ia fillojmë debatit për Projektligjin e radhës dhe pikërisht është pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Prishtinën

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet, përpos qetësisë që ende nuk po arrihet në Kuvend. Këto tjerat kushte janë përmbushur për miratim, në parim, të këtij Projektligji.

Në këtë mënyrë, unë me këtë rast ftoj ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë këtë Projektligj. Zoti ministër, e keni fjalën!

MIN ISTRI SADRI FERATI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Nxjerrja e Projektligjit për qytetin e Prishtinës është obligim i përcaktuar me nenin 13 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 2.2 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

Qyteti i Prishtinës përfaqëson një tërësi administrativo-territoriale dhe bashkësi qytetarësh që gëzon status të posaçëm si një njësi e veçantë lokale në Republikën e Kosovës. Qëllimi i këtij Projektligji është krijimi i bazës ligjore për të rregulluar statusin e posaçëm të qytetit të Prishtinës. Ky projektligj, përveç se krijon bazën ligjore, synon të sjellë funksionimin më efikas të organeve, të strukturave komunale të qytetit të Prishtinës, si kryeqytet i Republikës së Kosovës.

Projektligji i qytetit të Prishtinës është risi ngase për herë të parë krijon një bazë ligjore të qëndrueshme për organizimin e qytetit, duke krijuar një ndarje të re të organizimit dhe të funksionimit të tij. Projektligji ka për qëllim të adresojë; çështjet që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e qytetit të Prishtinës, formën e organizimit, mbikëqyrjen, të drejtat dhe përgjegjësitë e organeve të qytetit të Prishtinës. Ky projektligj krijon bazën e funksionimit dhe organizimit ligjor të organeve të qytetit me qëllim të përmirësimit dhe të ngritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët e saj.

Komunat me legjislacionin e ri për vetëqeverisjen lokale kanë autonomi të gjerë dhe ushtrojnë kompetencat e konsiderueshme, pra me këtë projektligj janë paraparë disa kompetenca plotësuese për qytetin e Prishtinës.

Gjatë hartimit të projektligjit janë përdorur edhe konsultuar burime dhe përvoja të legjislacionit dhe praktika të shumë vendeve evropiane, si Gjermani, Spanjë, Maqedoni, Slloveni e tjera, si dhe dokumente kyçe për çështjen e organizimit të qyteteve në vendet që zbatojnë Kartën evropiane për vetëqeverisje lokale.

Ky projektligj përmban 10 nene, që përfshin qëllimin, fushëveprimin dhe dispozitat e përgjithshme, organet e qytetit të Prishtinës, ndarjen administrative të qytetit të Prishtinës, organet e distrikteve administrative, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe kompetencat e qytetit të Prishtinës, zonën metropolitane të Prishtinës, si formë e mundshme e bashkëpunimit të komunave të lidhura ngushtë në aspektin e urbanizmit, infrastrukturës dhe marrëdhënieve ekonomike e sociale, siç janë Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Lipjan, Graçanicë, si dhe dispozitat e tjera që lidhen me interesin e shërbimeve për qytetarët. Propozimligji ka kaluar të gjitha fazat e parapara me ligj, prandaj i thërras deputetët që të japin mbështetjen në procedimin e mëtejshëm të ligjit.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër, veçon për fjalën e shkurtër dhe koncize. Tani, në qoftë se kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Administratë Publike, dëshiron ta marrë fjalën, e ka radhën. Nuk është paraqitur. Shkojmë me grupet parlamentare. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Bahri Hyseni!

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje, i nderuari ministër!

Përshëndetje të nderuar kolegë deputetë!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Prishtinën dhe natyrisht se do ta mbështet në leximin e parë. E konsiderojmë që është bërë një hap mjaft i rëndësishëm, duke marrë parasysh që Prishtina do të duhej që edhe më herët ndoshta të ketë një ligj i cili do të rregullojë statusin e veçantë të qytetit.

Megjithatë, ne do t'i japim disa nga rekomandimet për komisionin funksional, të cilat konsiderojmë që do të duhej të qartësohen me qëllim që ligji të jetë më i qartë dhe më i zbatueshëm në praktikë. Në fillim, konsideroj se preambula e Projektligjit duhet të jetë konform të gjitha projektligjeve tjera dhe i vetmi nën i cili i jep autoritet Kuvendit të Kosovës të miratojë ligje, është neni 65, pika 1 dhe të gjitha thirrjet në ligjet e tjera janë të panevojshme, sepse nuk i japin as fuqi, as kompetencë Kuvendit të Kosovës që të miratojë ligjet. Domethënë, preambula duhet gjithsesi të ndryshohet dhe të jetë konform legjislacionit që jemi duke e përdorë vetëm në nenin 65, sepse i vetmi autoritet është Kuvendi i Kosovës i cili nxjerr ligjin.

Një çështje tjetër me interes është kur bisedojmë rreth çështjes së kryetarit të qytetit të Prishtinës, që do të jetë sipas propozimit apo sipas Projektligjit edhe kryesues i Kuvendit të qytetit të Prishtinës. Është çështja ta diskutojmë. Ai njëkohësisht do të jetë, sipas projektligjit po flas, edhe kryesues i komitetit për politikë dhe financa. Mirëpo, nëse e shihni në paragrafin 3, thotë: “nuk është anëtar i Kuvendit të Komunës dhe komitetit për politikë dhe financa, por e ka të drejtën e votës shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave për ose kundër ndonjë propozimi”. Ne duhet ta qartësojmë, moment kur vendosim me projektligj për të qenë anëtar i komitetit për politikë dhe financa dhe kryesues, ai gjithsesi duhet të ketë të drejtë vote, sepse sipas kësaj logjike, kryetari nuk do të votojë asnjëherë, por do të votojë vetëm në situata kur pengohet puna apo vendimet e komitetit për politikë dhe financa dhe kjo del pak disi e çuditshme dhe, në rend të parë, këtu nuk e kemi përcaktuar sa anëtarë do t'i ketë komiteti për politikë dhe financa dhe unë konsideroj që komiteti për politikë dhe financa duhet të ketë çdoherë anëtarë tek, se përndryshe do të vinim në situatat të pengohet.

Kjo çështje është mirë të diskutohet. Përveç çështjeve tjera që me Ligj të vetëqeverisjes lokale, ne e dimë që kryesuesit e kuvendeve e kanë autoritetin për të udhëhequr Kuvendin, a do të duhet për t'ia lënë kryetarit të Prishtinës të udhëheq edhe Kuvendin, nëse ia lëmë me këtë ligj, natyrisht që do të jetë e mundur dhe për këtë le të mbetet, le të vendos Kuvendi. Ne nuk kemi ndonjë propozim konkret për këtë çështje. Një çështje tjetër delikate është te distriktet. Natyrisht që është bërë ndarja, është kreu në rregull, është kërkuar që në distrikt që do të ketë 7 anëtarë, të jenë 4 anëtarë të kuvendit komunal. Do të ishte mirë që në projektligj ta caktojmë tani saktë nga cilat grupe parlamentare do të vijnë anëtarët e Kuvendit, që të mos kemi problematika mandej, të përdoret autoriteti i shumicës në Kuvend, dhe ndoshta ndonjë grup parlamentar të jetë pa përfaqësim, varësisht prej..., është çështje shumë diskutuese. Ta përcaktojmë saktë, cili grup ka të drejtë të përfaqësohet, do të jenë 4 anëtarë, mirëpo ta përcaktojmë saktë, sepse përndryshe do ta lëmë situatën që të vendoset me shumicë dhe atëherë nuk do të kishte logjikë të ketë borde, nëse në këto borde është shumica.

Mirëpo, çështja bëhet pak e më e vështirë kur propozimi thotë: “tre anëtarë tjerë do të emërohen, do të propozohen nga kryetari pas takimeve që do t’i ketë konsultative me qytetarët e distriktit të posaçëm”. Kjo e bën edhe më konfuz. Unë mendoj që duhet që kuvendi komunal, në takim me qytetarët ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju lutem, jepjani fjalën zotit Hyseni!

BAHRI HYSENI:.... vetëm ta përfundoj. Domethënë, këtu duhet ta qartësojmë mirë. Nuk do t’i shkonte edhe për interes shumë edhe kryetarit të dalë me propozime për kuvendin. Por, kuvendi komunal të organizojë takime me qytetarë, janë të gjitha partitë politike, organizojnë takimin dhe natyrisht do të ftojnë prej qytetarëve t’i çojnë tre përfaqësues, tri propozime të cilat mandej do të aprovohen në kuvendin komunal për me qenë anëtarë të Bordit. Nëse i lihet vetëm kryetarit, atëherë automatikisht nënkuptojmë që do të jetë, ndoshta nuk po e marrim edhe shumë politike, nuk po flasim as për situatën aktuale, por do të krijohet një situatë që anëtarët e Bordit ta kenë atë fuqinë politike dhe mos të vijë mandej në shprehje vullneti i qytetarëve të cilët përfaqësohen përmes deputetëve të zgjedhur.

Këto janë dy nga dilemat të cilat i kemi. Përndryshe, si Grup Parlamentar e përkrahim. Do të përkrahim edhe me rastin e amendamentimit në komisionin funksional dhe shpresojmë që ta kemi një ligj i cili do ta rregullojë statusin e qytetit të Prishtinës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri, se nuk po na dalin emrat, po ju kërkoj falje, prandaj po duhet...

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot, më në fund, në rend dite kemi Ligjin për kryeqytetin, Prishtinën. Kjo po ndodhë diku pas dy vite e gjysmë të miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe afër 17 muaj pas miratimit të tij në Qeverinë e Kosovës. Një falënderim, normalisht, për kryetarin, edhe pse nuk është prezent, që e ka futur në rend dite, zotin Krasniqi. Edhe sot po e them që konsiderojmë që kjo shtyrje ka qenë e paarsyeshme. Sidoqoftë, Ligji për kryeqytetin, u tha nga vetë ministri, parashihet në kapitullin e parë të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, pjesa ku ka të bëjë me dispozitat themelore dhe për të mos i përsëritur, vetë kjo seancë dhe ky ligj, po sa të miratohet, do të thotë edhe fillim të respektimit edhe të një nenit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës. Po kryejmë ose po fillojmë të kryejmë një obligim karshi kryeqytetit dhe qytetarëve të tij.

Sigurisht që ky ligj nuk i plotëson sa e si duhet nevojat e kryeqytetit dhe të qytetarëve të tij, por sado-kudo bën lëvizje e para, duke besuar se i njëjti në mes të dy leximeve mund dhe duhet të pasurohet, e për këtë mendojmë si grup parlamentar se ka nevojë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Është një ligj i shkurtër, me 3 kapituj dhe 10 nene, por unë nuk do të marrë kohë në përshkrimin e tij, por që është ligj padyshim i një rëndësie të veçantë dhe i domosdoshëm, kjo nuk do asnjë koment. Më poshtë do t’i them disa vërejtje dhe propozime që i kemi si grup parlamentar, e që kuptohet që ne këtu, sipas procedurave përkatëse do t’i paraqesim edhe në komisionet adekuate.

Në fillim, propozojmë dhe për këtë do të bëjmë amendament që ky projektligj të emërtohet Ligji për kryeqytetin – Prishtinën. Këtë e mbështesim edhe në nenin 13, pika 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe që fjala “qytet” në tekstin e mëtejshëm të ligjit, të zëvendësohet me fjalën “kryeqytet”.

Te neni 8, te kompetencat e kryeqytetit, i kemi mes tjerash dy vërejtje, që mendojmë se janë shumë të rëndësishme, përmbajtjesore, por edhe domethënëse për këtë ligj. Pika 4 e këtij neni thotë: “qyteti, gjegjësisht kryeqyteti i jepet një grand shtesë nga i cili jo më pak se 3% dhe grandit total të komunave për vitin fiskal” Ne, si grup parlamentar propozojmë që të jetë jo më pak se 5% ose së paku të mbetet jo më pak se 4%, ashtu siç ka qenë në variantin e miratuar nga Qeveria e Kosovës më 23 prill 2009, edhe pse mendojmë që edhe kjo për Prishtinën është pak krahas peshës, rëndësisë së kryeqytetit si qendër institucionale, shtetërore, arsimore, kulturore, sportive, rinore po edhe diplomatike.

Do t'i them edhe argumentet, sepse mendojmë që ky nuk do të ketë edhe ndonjë implikim ose pse duhet të ketë, më mirë të themi, këtë grand shtesë kryeqyteti. Konsiderojmë se Prishtina më herët është diskriminuar për shumë vite për arsye se edhe ka rolin e komunës, sikur të gjitha komunat tjera, por e ka edhe rolin e kryeqytetit. Pse themi se është diskriminuar? Sepse grandit qeveritar nuk e merr parasysh rritjen enorme të Prishtinës në periudhën e pasluftës. Po ashtu, është diskriminuar edhe si kryeqytet pasi ofron shumë shërbime për institucionet qendrore, vendore dhe ndërkombëtare dhe, rrjedhimisht, për të gjithë qytetarët e Kosovës, për të cilat shërbime nuk kompensohet nga Qeveria dhe askush tjetër. Prishtina ofron shërbime publike jo vetëm për qytetarët e saj, por edhe për shumë qytetarë tjerë që dalin gjatë ditës, hyjnë e dalin gjatë ditës apo punojnë në Prishtinë.

Vlerësimet janë se rreth 150.000 persona që nuk janë qytetarë, banorë të Prishtinës, qëndrojnë në kryeqytet gjatë ditëve të Punës. Të gjithë këta persona kanë nevojë për shërbime shtesë. Po ashtu, këto shërbime, gjegjësisht kryeqyteti ka shpenzime shtesë për këtë ofrim shërbimesh. Prishtina ka ofruar dhe ndarë shumë lokacione për nevoja të institucioneve të ndryshme shtetërore, për institute, për ambasada edhe asnjëherë normalisht nuk është kompensuar. Po ashtu, Prishtina gjatë ditës, gjegjësisht në Prishtinë llogaritet që hyjnë mbi 150.000 makina, të cilat i shfrytëzojnë rrugët dhe parkingjet e kryeqytetit të cilat ndërtohen dhe mirëmbahen nga buxheti i Komunës.

Grandit qeveritar bazohet në një numër prej 360.000 banorëve dhe ne e llogarisim sipas të gjithë parametrave që në kryeqytet ka diku 500.000 banorë. Vlerësimi i ndikimit buxhetor, mund të themi se ky Projektligj, për mendimin tonë, nuk ka kosto shtesë buxhetore direkte, pasi sipas këtij ligji, respektivisht nenit 8 të këtij projektligji, kryeqytetit t'i jepet një grand shtesë jo më pak se 3% e grandit total të komunave për secilin vit fiskal. Për mendimin tonë, kjo do të ishte normale nga ajo që u tha më lart. Janë argumente këto që plotësisht e bëjnë të arsyeshme kërkesën për një grand shtesë për kryeqytetin.

Pika 6 e nenit 8, thotë: “qyteti menaxhon me objektet dhe terrenet sportive publike...”. Ne konsiderojmë se absolutisht, pa kurrfarë baze ligjore është hequr nga kjo pikë e nenit fjalia “duke përfshirë edhe Pallatin e Rinisë dhe Sporteve”, ashtu siç ka qenë e miratuar në mbledhjen e Qeverisë, më 23 prill 2009, dhe vërtet nuk e dimë se kush ndërkohë e ka hequr prej ardhjes së tij nga Qeveria në Kuvend.

Arsyet se pse Pallati i Rinisë dhe Sporteve, ikona në një mënyrë e Prishtinës, i takon kryeqytetit, po i themi – poshtë, bazuar në argumentet e fuqishme dhe në dokumentacionin shumë voluminoz, i cili ekziston dhe sigurisht çdo njëri që do të ketë dëshirë, mund ta ketë gjatë punës nëpër komisione dhe

ne këtë do ta bëjmë. Atë që nuk ka arritur AKM-ja ta privatizojë, nuk është lejuar fatbardhësisht, besojmë që as tash nuk do të ndodhë kjo për këto arsye:

- Pallati i Rinisë dhe i Sporteve është ndërtuar, gjegjësisht vendimi për ndërtimin e tij është marrë më 10 shkurt 1976 nga kuvendi komunal. Vendimi është me numër, nuk po e përmendi për shkak të kohës.

- Po ashtu, Kuvendi i Komunës së Prishtinës është investitori kryesor për ndërtimin e qendrës. Ka ndarë drejtpërdrejt mjete nga fondi i saj, ka shpallur vetëkontributin e qytetarëve të saj për ndërtimin e qendrës për periudhën 1976-80 për 5 vite, më 25 dhjetor 1975, dhe ky obligim ka qenë 2% e të ardhurave personale dhe e të ardhurave tjera për këto vitet që i thashë.

- Përmes bashkësive të atëhershme vetëqeverisëse të interesit të arsimit, të shkencës, të kulturës, të rinisë, shëndetësisë, BVI-a ka qenë komunale për rregullimin e tokës, përmes këtyre të gjitha këto janë kryer konform dhe në bashkëpunim dhe në organizim të kuvendit komunal.

- Kuvendi i komunës, po ashtu, ka miratuar Planin detal urbanistik, më 18 shkurt 1975, flas të Pallatit të Rinisë dhe Sportit. Prona në të cilën është ndërtuar pallati, është komunale, është e eksproprijuar dhe kompensuar në vitin 1976. Komuna e Prishtinës në vitin 2001 ka marrë një donacion në vlerë prej 2.9 milionë marka të atëhershme për sanimin e pasojave pas djegies së një pjese të pallatit. Po ashtu, pas djegies së këtij pallati, kulmi, salla e madhe, një pjesë tjetër, në vitin 2003 Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka ndarë 115.000 euro në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2003 dhe nënshkruar ky vendim më 23 tetor 2003.

Për të gjitha këto që u thanë më lartë, ekzistojnë vendimet përkatëse të shkruara për periudha të ndryshme kohore prej vitit 1975 e këtej.

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim Projektligjin për kryeqytetin e Kosovës – Prishtinën, me vërejtjet, sugjerimet, propozimet që i dhamë dhe do të japë kontributin e vet në komisionet përkatëse që këto propozime të paraqitura edhe të pranohen në formë të amendamenteve të dokumentuara me vendimet përkatëse dhe pastaj t'i procedohen Kuvendit për miratim bashkë me projektligjin.

Duke besuar thellë se e kemi përkrahjen edhe të gjitha grupeve parlamentare, të gjithë deputetëve për propozimet që i kemi dhënë në procedurën parlamentare, në këtë mënyrë jam i bindur që të gjithë ne do të tregojmë atë përgjegjësinë që e kemi vazhdimisht të lartë dhe të respektimit të së drejtës elementare, ligjore në këtë rast karshi çështjeve që i ngritëm posaçërisht në dy-tri vërejtje.

Edhe një herë, duke u ditur që Prishtina është kryeqytet i të gjithë qytetarëve të Kosovës, ... qartë, i të gjitha partitë politike, do të kemi përkrahjen dhe të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqiri. Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Gjini është paraqitur për fjalë.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit!

Është më interesant të shihen deputetët kur iu drejtohet dikush, e unë kam shumë vullnet për t'i parë deputetët.

Ju faleminderit, zoti kryesues!

Fillimisht, prapë duhet të them që Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet këtë ligj. Do ta votojmë në parim, mirëpo ne i kemi disa pyetje, çështje, disa prej të cilave edhe u ngritën më parë nga kolegët dhe mendojmë se ministri ka qenë dashur që të na i shpjegojë disa aspekte, me gjithë respektin, të cilat nuk i ka shpjeguar dhe unë do t'i përmend ato që nuk i ka shpjeguar, se kishte qenë mirë t'i dijë Kuvendit.

Fillimisht, ligji është aprovuar më 23.04.2009, është aprovuar në Qeveri dhe nuk ka ardhur prej atëherë deri më tani në Kuvend dhe prej asaj kohe deri me tani dy ndryshime i ka pësuar ligji, prej 4 në 3% të grandit total edhe është hequr Pallati i Rinisë. Nëse është dashur të negociohet një vit e gjysmë për një pallat të rinisë, atëherë e kemi një diskrepancë serioze t'i themi Prishtinës metropol. Një metropol nuk negocion një vit e gjysmë për një pallat të rinisë, për një sallë të sporteve. Edhe duke parë, domethënë, a është metropol apo është, çka është? Edhe tjetra është, çka ka lidhje, më mirë po e bëjmë e po i themi: Ligji i Pallatit të Sporteve se Ligji për Prishtinën, për shkak se dy çështje i rregullon, e rregullon pallatin e sporteve dhe 3%.

Çështjet tjera, për mendimin tonë, janë futur në ligj pa ndonjë nevojë, realisht. Nuk rregullojnë kurrgjë, çka rregullojnë bordet? Ne e kemi një problem që do të vijë te bordet, të cilin duhet ministri të na shpjegojë ose duhet pasur kujdes çka po bëjmë me ato borde, se realisht ne nuk e dimë çka bëjnë bordet dhe kemi për t'i votuar. Realisht, po filloj me disa vërejtje. Vërejtja e parë është se çka ka ndodhë për më shumë se një vit e gjysmë, pse nuk ka ardhur ligji këtu, a është negociuar një vit e gjysmë vetëm për 3-4% edhe për Pallatin e Rinisë. A është kaq i rëndësishëm për metropolin e Kosovës pallati i rinisë, që të negociohet një vit e gjysmë ose kush është dikush tjetër që e ka kaq të rëndësishëm Pallatin e Sporteve që ta ndal një ligj të rëndësishëm, një vit e gjysmë mos ta sjellë në Kuvend.

E keni paragrafin 1 të nenit 3, thotë: “Qyteti i Prishtinës, është kryeqytet i Kosovës” ky është provizion kushtetues, nuk kemi nevojë ta qesim edhe në ligj, domethënë, të tregojmë edhe një herë që Prishtina është kryeqytet i Kosovës. Është provizion kushtetues i qartë, nuk ka nevojë të hyjë për së dyti. Thuhet më vonë që i është bashkangjitur projektligjit harta. Cila harta, ne nuk e kemi marrë, e tash ka të bëjë me korrektesën institucionale, domethënë institucionet duhet pasur kujdes, se ky Kuvend e voton. Ne jemi deputetë të Kuvendit të Kosovës që e votojmë ose nuk e votojmë ligjin dhe kur na thuhet në një pikë që i bashkëngjitet harta, atëherë le t'i bashkëngjitet harta, se nuk është ndonjë nam i madh ta ketë edhe hartën, me qenë se është premtuar, do të thotë, është njëfarë jo korrektesë e çuditshme me materialin që i sillet Kuvendit dhe çka thuhet që i sillet Kuvendit.

Çështje tjetër që duhet të na shpjegojë ministri ose të shpjegohet më qartë në ligj, është si të përcaktohen anëtarët e bordit, diçka për të cilën foli edhe deputeti Hyseni. Është shumë në rregull për ne që kryetari i Komunës t'i propozojë tre anëtarë prej qytetarëve, ata anëtarë të votohen në Kuvendin e qytetit ose të komunës, nuk është me rëndësi, por janë katër anëtarë të tjerë të bordit, të cilët përcaktohen nga deputetët e Kuvendit të Prishtinës, edhe ne nuk e dimë qysh përcaktohen ata. Nuk guxojmë të kemi kesi provizion ligjor, nëse nuk e kemi të qartë se çka kemi për të bërë. Është një provizion që kur hartohet ligji, duhet ta kemi tepër të qartë se çka bëjmë dhe mendojmë se kjo duhet të rregullohet në proces të amendimit dhe mos të shkojë, mos të aprovohet ligji kesi soji.

Çështje tjetër që është tepër me rëndësi, cilat janë kompetencat e distrikteve. Ne e dimë se mund të përcaktohen më vonë, me vendime të komunës, por ne duhet t'i dimë kompetencat në bazë distrikteve, shembull ta marrim, a shtrojnë rrugë, a kanë buxhet, në çfarë forme e marrin buxhetin, a japin dokumente, a ka të drejtë komuna të delegojë kompetenca, domethënë janë një mori e çështjeve të cilat duhen të rregullohen para se ligjin ta marrë vinë finale, edhe në këtë pjesë për shkak se janë

tepër të paqarta dhe kanë për të na sjell në konfuzion ne, në fund të fundit, vetë Kuvendin e komunës ose Kuvendin e qytetit të Prishtinës.

Çështje tjetër është se Prishtina e themelon Institutin për Planifikim Urban. Mos harroni se ne kemi institute për planifikim dhe çka ka për të bërë ky institut. Po pranoj se ndoshta është e rëndësishme, unë nuk e di rëndësinë e këtij instituti në nivel të komunës, por është me rëndësi ta dimë ne në Kuvend se çka po votojmë, çka ka për të bërë ky institut, a ka për të qenë, domethënë pandam Institutit të Planifikimit Hapësinor, shembull ta marrim, që e kemi në kuadër të Ministrisë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe a ka pasur ndonjë mendim të vetin ministri, shembull ta marrim.

Çështje tjetër, është tatimi në qira. A ka pasur ndonjë ide ministri i Financave, ky është tatim i ri. A na shpjegon neve dikush qysh prezantohet edhe një tatim i ri me një ligj për një qytet. Shikoni, kemi të bëjmë me politikë fiskale, e cila është tepër e rëndësishme dhe ne nuk e dimë çka ndodhë me këtë tatimin në qira, qysh përcaktohen normat, qysh tatohet, se po flasim për tatim e jo për taksë ose për një pi, qysh i thonë anglisht.

Çështje tjetër është menaxhimi i shëndetësisë sekondare. Pse? Cili është interesi i qytetit të Prishtinës të menaxhojë me shëndetësinë sekondare, nëse qytetet tjera nuk menaxhojnë. Për shembull, çka ka të bëjë kjo me rritjen e kompetencave të kryeqytetit, si kryeqytet, se na po flasim për kryeqytetin dhe nëse është kryeqytet, atëherë të na tregohet se cilat janë këto.

Duhet të kthehem te neni 9 dhe veç po e lexoj, do të thotë, pikën e fundit, prapë për sqarim, se është tip, janë elemente tepër konfuze. Thotë kështu: “zona metropolitane, me një Pallat të Rinisë, e Prishtinës, merr resurse të mjaftueshme nga buxhetet e komunave të cilat e përbëjnë atë”. Tani, a mundemi ne me këtë ligj t’i themi Graçanicës t’i japë zonës metropolitane buxhet? Nëse po, duhet prapë të sqarohet qysh. Mendoj se janë çështje tepër serioze t’ua vëmë veshin, se mund t’i votojmë këtu dhe atëherë t’i themi Podujevës po duhesh t’i japësh ti mjete zonës metropolitane. Ma merr mendja se Drenasi është më afër Prishtinës se Podujeva, në atë aspekt, nëse vetëm duam të flasim për zonën metropolitane.

Këto janë çështjet të cilat mendoj se gjatë procesit të amendimit duhet të shpjegohen. Edhe një çështje tjetër e cila realisht, duhet të jem unë tepër i saktë për të thënë është mendim i imi, tani nuk është edhe mendimi i grupit, për korrektësi ndaj grupit duhet ta shpjegoj, është çështja e 3%, çështja e grandit total. Unë kam biseduar me njerëz të cilët kanë pasur shumë kujdes në hartim të këtij ligji, që janë meritore për Prishtina ka mbërri deri te ky ligj dhe është mirë, realisht, kompliment po ju jap, edhe thonë që Prishtina duhet të marrë më tepër mjete prej buxhetit për shkak se është kryeqytet. Perfekt, por kjo nuk është përgjigja që unë dua ta dëgjoj se kjo nuk ma jep arsyen e vërtetë, për shkak se fakti që Prishtina është kryeqytet, është aset për këtë qytet, nuk është barrë. Dikush më thotë janë institucionet e Kosovës në Prishtinë, po prapë është aset, nuk është barrë t’i ketë institucionet, nuk është barrë t’i ketë të gjitha ministrinë në Prishtinë. Dikush thotë se i ka ndërmarrjet më të mëdha publike, po është prapë aset. Cilido qytet në Kosovë, Gjlani, Ferizaj, Prizreni, Gjakova, Mitrovica, Peja, rend po ju shkoj, vetëm le t’ju thotë dikush që po iu biem nja 3 ministri, asnjë 1% nuk i lypë, 0, se mezi presin t’i kenë, se këto institucione krijojnë të hyra për komunën, nuk marrin.

Çështja tjetër, thotë, janë ambasadat, por prapë po të kishte vendosur ndonjë shtet ta çojë ndonjë ambasadë në Gjakovë, ata i kishin dhënë pak para, se prapë është aset për komunën, nuk është barrë për komunën. Do të thotë, ky 3%, duhet të shpjegohet pak më ndryshe e mos të na thuhet se është barrë për Prishtinën pse i ka krejt institucionet. Ashtë barrë ta ketë Universitetin Publik edhe krejt studentët të vijnë e të paguajnë në Prishtinë, qysh është barrë për komunën? Kjo nuk do të thotë se

unë jam kundër për..., kjo nuk do të thotë se jam kundër në esencë, por unë po kërkoj prej ministrit të ma shpjegojë mua, ta kuptoj unë që nuk di shumë, pse është barrë ta kesh PTK-në, KEK-un, Universitetin, krejt ministritë, Kuvendin, krejt ambasadat në Prishtinë, pse është barrë për Prishtinën? Edhe pse është barrë për Prishtinën të vijë 100.000 njerëz në ditë dhe të shpenzojnë në Prishtinë, realisht?

Këto janë ato që unë i pata për t'i thënë për këtë ligj. Ju thashë edhe një herë, kjo e fundit është mendimi im. Kërkojmë shpjegim më të qartë, tjerat janë çështje të cilat i kemi diskutuar në grup dhe mendoj se duhet në procesin e amendimit me të kemi kujdes për shkak se do t'i shkaktojmë problem vet kryeqytetit, jo dikujt tjetër. Edhe një herë, e votojmë në parim ligjin.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Gjini. Në emër të Aleancës Kosova e Re, e ka fjalën zoti Ibrahim Makolli,

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështetë ligjin, në parim, natyrisht me disa prej vërejtjeve të cilat to t'i japim. Kemi shumë arsye ta mbështesim këtë ligj dhe, po them, është shumë e paarsyeshme që tash e dy vjet, 10 nene i ka gjithsej, por 9, se neni 10 është kur hyn në fuqi, domethënë një ligj me 9 nene, të pritët gati dy vjet për t'u proceduar në Kuvend, kjo është absolutisht e papranueshme dhe nganjëherë kur po dëgjoj, po mendoj se e cilës parti politike është Prishtina. Madje edhe këtu është hetuar pak deri diku, se kishte tendenca që dikush thotë se e dua Prishtinën më shumë, e tjetër kush më pak. Megjithatë, Prishtina është e të gjithë qytetarëve të Kosovës, dhe jo vetëm të Prishtinës dhe duhet të trajtohet si e tillë. Thashë, është i prishtinasve dhe duhet të trajtohet si i tillë edhe për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Vërejtjet që unë do t'i jap, janë parimore, besoj. Ligji nuk e ka përcaktuar qartazi atë që u tha edhe më herët, cilat janë kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e bordit të distrikteve dhe të drejtorëve distrikteve. Nuk mund të lejohet që kompetencat e tyre të përcaktohen me një rregullore ose statut të komunës, por duhet të përcaktohen me ligj, sepse shtrohet pyetja çka bëjnë distriktet, a janë vetëm sa për t'i ndarë, a janë edhe për veprime tjera.

U përmend shumë Pallati i Rinisë. Unë po them që më mirë është Prishtina të mos ketë ligj fare, se sa ta ketë një ligj në të cilin nuk i përfshirë Pallati i Rinisë. Pallati i Rinisë është pronë e qytetarëve të Prishtinës. Të gjithë ne, e përmendi edhe kolegu më herët se si është ndërtuar ky pallat, dhe them që, nëse Pallati i Rinisë nuk është brenda këtij ligji, Grupi ynë Parlamentar nuk e përkrahë, sepse nuk ka arsye, nuk ndryshon pastaj kurrgjë prej Ligjit për vetëqeverisjen lokale, përpos që e bën ndarjen në 5 distrikte, do të thotë nuk ka kurrgjë tjetër shtesë.

Po ashtu, vërejtja jonë është edhe sa i përket grandit shtesë për Prishtinën, i cili këtu thuhet se nuk është më pak se 3%. Edhe ne pajtohemi që të jetë së paku 4 ose 5%. Prishtina ka nevoja të tjera në raport me qytetet e tjera dhe në Prishtinë duhet të kujdeset dhe duhet të investojnë edhe institucionet e tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Makolli!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, e ka fjalën zonja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e vlerëson të një rëndësie të veçantë sjelljen në Kuvend të Projektligjit për qytetin e Prishtinës, i cili si qëllim ka rregullimin e statusit të qytetit të Prishtinës. Duke e vlerësuar të rëndësishëm, ndiejmë obligim që ta mbështesim në parim.

Çështjet e adresuara nga Projektligji kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e qytetit të Prishtinës, çështje të cilat janë trajtuar shumë sipërfaqësisht dhe shumë ngushtë brenda projektligjit. Ajo çfarë shihet në projektligj, është një ndarje e re mbi oragnaizimin dhe funksionimin e qytetit të Prishtinës dhe atë ndarja në distrikte administrative, në 5 distrikte:

- Distrikti administrativ urban - Qendra,

- Distrikti administrativ urban rural - Veriu, Jugu, Lindja, Perëndimi,

të cilat, si orientime gjeografike gjithçka është në rregull, por ne kemi emra që me shumë të drejtë do të përdoreshin si emërtime për distrikte në fjalë, siç janë: Dardania, Ulpiana, por edhe emra të ndryshëm nga pjesët të cilat u përkasin këtyre distrikteve. Prandaj, propozimi ynë është që përveç se të kenë orientime gjeografike, këto distrikte të kenë edhe emrat, që Prishtina në këtë drejtim nuk mungon me emrat që vërtet meritojnë të kenë këto distrikte.

Mandej, janë përgjegjësitë dhe kompetencat e distrikteve të cilat në ligj fare nuk janë përcaktuar apo, nuk e di, jemi mësuar ndoshta të themi me rregullore të veçantë apo, të paktën, në këtë rast nuk kemi se si t'i rregullojmë. Është mirë që edhe ato të shihen në mënyrë më të qartë dhe më të sqaruar brenda projektligjit.

Kompetencat që i jepen qytetit të Prishtinës në këtë Projektligj janë të ngushtuara dhe ka nevojë të plotësohen. Është fjala te neni 8, i cili mjaft sipërfaqësisht dhe në mënyrë të ngushtuar i ka paraparë kompetencat e qytetit të Prishtinës dhe ka nevojë për plotësime të mëtutjeshme. Por, shqetësimi kryesor i Grupit tonë Parlamentar mbetet mosvlerësimi i ndikimit buxhetor, komponentë kjo që e vështirëson zbatimin në praktikë të këtij ligji. Duke pasur parasysh se nuk shihet fare se si..., thuhet se pas miratimit në Kuvend, do të fillojë së implementuari dhe zbatuari në praktikë, ndërsa vlerësimi i ndikimit buxhetor dhe kah do të sigurohen ato mjete për krijimin e këtyre distrikteve, nuk janë paraparë brenda projektligjit. Kjo është ndoshta çështja kryesore apo çështja kyçe që duhet të definohet para se ky të vjen në lexim të dytë.

Projektligjin e mbështesim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Rysha!

Tani e ka radhën Grupi “7+” dhe zotëri Enis Kervan është paraqitur.

ENIS KRVAN: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Priştineye ait Yasa Tasarısını iyice inceledik ve 7+ Parlemlenter grubu olarak prensipte kabul ediyoruz.

Mevcut olan bazı dil hataları yanı sıra, bu yasa tasarısıyla ilgili bazı uyarılarımız var.

Yerel Yönetim Yasasının 54. maddesine göre, Meclis Başkan yardımcısı çoğunluk olmayan topluluklardan olmalıdır. Oysa bu yasada konuyla ilgili hiçbir nokta mevcut değil.

Bunun dışında bu yasa tasarısında, çoğunluk topluluğuna ait belediyenin 2 başkan yardımcısıyla ilgili nokta da var, nitekim burada çoğunluk olmayan topluluklara yer verilmemiş ve bu Yerel Yönetim Yasasının 61. maddesine aykırıdır. Ve sonunda, bu yasa tasarısının 6. maddesinde çoğunluk olmayan topluluklardan Yönetim Kurulu temsilcilerine yer verilmemiş. Teşekkür ederim!

KRYETARI: Në emër të SLS-së, Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Hvala, gospodine predsedniče!

Dame i gospodo,

Prvo pitanje koje ćemo u vezi ovog nacrtu zakona postaviti gospodinu ministru je – da li je u procesu izrade ovog nacrtu zakona kontaktirao sa predsednicima okolnih opština, obzirom da se spominju u ovom nacrtu zakona i da će biti ključni igrači u svemu ovome. Veoma je bitno i zato se ovo naše pitanje odnosi na to, znači govori se o opštinama Podujevo, Gračanica i ostale opštine. Takođe, imamo nekoliko primedbi na sam tekst nacrtu zakona i smatramo da bi trebalo doći do nekih korekcija. Mi ćemo pokušati to u radu ovih parlamentarnih komisija da ispravimo. Prvi član je nedovoljno precizan i on govori da se samo ovim zakonom uređuje poseban status grada Prištine. Smatramo da je nedovoljno samo odrediti status grada Prištine, možda bi trebalo navesti položaj, nadležnosti, organe, spominju se neki organi grada Prištine. Možda bi sam nacrt zakona trebao da nosi naziv Zakon o glavnom gradu, jer se postavlja pitanje da možda sutra neki drugi grad na Kosovu da bude glavni grad, pa će nadležnosti Prištine ostati po ovom zakonu i ovlašćenja će biti velika, a neki drugi grad će biti “glavni grad”, moda, pod znacima navoda.

Takođe, naša Parlamentarna grupa je želela da se u članu 3. stav 4. koji glasi: „Grad Priština uživa viši nivo lokalne samouprave”, da se definiše taj viši nivo lokalne samouprave, zašto bi smo bili u nedoumici šta to znači viši nivo lokalne samouprave.

U članu 6. grad Priština ima svoj amblem i simbole, ali ne kaže koji, na osnovu kog pravnog dokumenta donosi. Ako ima svoj amblem i ako ima svoje simbole, grad Priština bi trebalo da ima i svoj praznik, trebalo bi da stoji odrednica da grad Priština ima svoj praznik. Trebalo bi takođe da stoji da grad Priština ima svoju imovinu, neki od govornika su govorili šta je imovina grada Prištine, trebalo bi da se definiše lepo o ovom zakonu, da ne bi bilo nedoumica. Ko raspolaže tom imovinom, takođe se ne vidi ovde.

U članu 4. organi grada Prištine piše da su gradska skupština i predsednik grada, ali se ne kaže koliko broji gradska skupština odbornika, ni način na koji se bira i tako dalje i tako dalje. Ako je samo predsednik grada Prištine izvršni organ, onda on će imati puno posla. Ja mislim da bi u tako velikom gradu, koji ima toliko problema ili zahteva građana i potreba, trebalo bi da postoji neko telo, a ne predsednik grada da bude jedini izvršni organ u gradu. Možda bi trebalo da bude tu neko gradsko veće koje bi bilo naimenovano i između ostalog bilo zajedno sa predsednikom grada izvršni organ. Zatim nije definisano koje pravne akte donosi Skupština grada. Predpostavljam da se radi o statutu, budžetu možda, programu razvoja, urbanističkim planovima i tako dalje.

Naravno, u tom kontekstu trebalo bi definisati organe, izvršne organe, to su gradsko veće, recito, po nama i predsednik grada, ko ih bira i sve one ostale stvari koje su u ovom slučaju potrebne. Možda reč “distrikt” u ovom trenutku ne odgovara samom značenju, jer po ovome sigurno, kako je napisano u članu 6., distrikt je manja jedinica od opštine, po ovome kako je napisano, a po pravnim nekim dokumentima distrikt je mnogo više nego jedna opština, prema tome, taj termin ne bi mogao da bude i da zadovolji ovu potrebu.

Učešće građana u članu 7. je nedovoljno. U svim razvijenim zemljama Evrope i sveta, opšte je poznato da su to instrumenti građanske inicijative, zbora građana, ovde se spominju javni skupovi i možda referendum. Zašto ne referendum, jer su pitanja koje će se sutra ticati opštine veoma osetljiva. Naravno, u poglavlju 3. Prestolonasledničke zone Prištine, ja mislim termin “prestolonaslednik” je

poznat u pravnoj terminologiji kao oblik vladavine kraljevine, pa se malo treba i tu korigovati što se toga tiče. I naravno, zabrinutosti što se tiče granica opštine Priština i odnosa sa susednim opštinama, jer je to veoma osetljivo pitanje i trebalo bi da se poradi još na tome.

Što se naše parlamentarne grupe tiče, mi u ovom trenutku zbog ovih nekih značajnih pitanja, nemamo stav što se tiče glasanja. Hvala!

KRYETARI: Për integritet! Deputetja Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Kada je pitanje Zakona o gradu Priština, i mi imamo neka pitanja gde ne možemo da budemo saglasni sa ovim zakonom. Ovo kažem iz razloga zato što znamo da ovaj zakon definiše status grada Prištine. Mi znamo da postoji Zakon o lokalnoj samoupravi, gde su definisani svi gradovi kao opštine i poseban status gde se traži na ime ovog zakona, mislimo da treba da postoji poseban zakon, Zakon o glavnom gradu, da kažemo, Kosova.

Jako zabrinjavajuće u ovom zakonu jeste to da se ponavljaju isti organi, opštinski i grada Prištine, da se dupliraju praktično i ja mogu da kažem slobodno, čitajući ove amandmane, mi kao grupa videli smo da se zapravo ne radi decentralizacija, nego centralizacija pojedinih opštinskih uprava na Kosovu. Ovo kažem iz razloga, ovde se kaže da se na 5 administrativne jedinice deli Priština, neću da ih ponavljam, čuli smo ih ovde od kolega. Mi znamo da jedan grad može da se podeli na 5 administrativne jedinice, smatram da nije praktičan izraz. Trebalo bi više da to budu naselja ili da budu, kao što smo u prošlom zakonu imali, pod opštine ili opštine u okviru grada Priština, zato što će ovde još jedno centralizovano biti, još jedna centralizovana linija gde će praktično i u samoj Prištini pojedini administrativni, da kažem, delovi biti u zaostatku za centralnim delom.

Kada je razvoj u pitanju, moramo mnogo da pazimo kada razvijamo gradove i kada su u pitanju nadležnosti, kao što su u pitanju gde moramo da vršimo decentralizaciju i pojedinih ministarstava, mi znamo da smo mi imali gotovo, da kažem, ministarstvo, gotovo ministarstvo u Prizrenu o zakonu o metrologiji, da 8 -10 godina nemamo taj zakon, da je ta služba praktično u Prizrenu zatvorena, u Prištini još ne postoji.

Znači, moramo da imamo i decentralizaciju po ministarstvima, gde moramo da povežemo horizontalno i linearno gradove Kosova. Ovde je, ja ću biti jako jednostavna, da kažem vako, ranije smo se kukali i čuli smo puno puta reči: „Kosovo radi, Beograd se gradi“, a sada će praktično biti sa ovim Zakonom „Kosovo radi, a Priština se gradi“, a šta će biti sa ostalima, mi smo jako zabrinuti kao grupa. Toliko od nas. Hvala!

KRYETARI: Nejse, krahassimi nuk shkon bash, por edhe kjo bën, demokracia lejon gjithçka.

Po ju njoftoj, nëse ju jeni dakord gjithnjë, i kemi të lajmëruar edhe 18 deputetë. Kemi edhe 4 ligje edhe 6 pika gjithsej, por 4 ligje janë, dy në lexim të parë, dy në lexim të dytë. Nëse ju jeni dakord, ju diskutuesit për Ligjin e Prishtinës, shkurtojeni vet. Propozoni ju kohën, se pastaj më thoni se unë po ua marrë fjalët. Unë nuk dua t'ia marr fjalët askujt.

Urdhëro, Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Unë kur jam diskutues, 3 minuta, 3 minuta si t'i kaloj...

KRYETARI: Kush është për propozimin e deputetit Fatmir Rexhepi, për 3 minuta diskutimet për Ligjin e Prishtinës? Ju faleminderit! Kush është “kundër”? Ju faleminderit!

Shumica janë “për”. A ka abstenim? Nuk ka. Regjia e ka parasysh, 3 minuta diskutimet për Ligjin e Prishtinës. Vazhdojmë sipas radhës. Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,

Fillimisht, emri, Ligji për qytetin e Prishtinës po del se Prishtina është e qytetit, domethënë emrin duhet ta meditojmë, ta gjejmë, duhet të jetë: “Ligji për qytetin Prishtina” ama jo “për qytetin e Prishtinës”, se po vjen që qyteti qenka i Prishtinës.

Me këtë ligj duhet të precizoheshin, do të duhej të precizoheshin autorizimet e qytetit dhe të distrikteve. Edhe termi distrikt, konsideroj se nuk është term i gjetur edhe nuk është adekuat. A thua a është komuna? Po nëse nuk është komuna, atëherë po i bie sikur një shërbim dhe, tek e fundit, Prishtina nuk do të ristrukturohej eseencialisht, por do të mbetej kjo që është.

Te neni 4, paragrafi 2, “kryetari i qytetit të Prishtinës është kryesues i Kuvendit të qytetit dhe i komitetit për politikë e financa”, por sipas nenit 4, paragrafi 3, ai apo ajo eventualisht, nuk është autor i kuvendit të komunës as i komitetit për financa. Sa do të ishte kjo rationale dhe sa do të kishte autoritet kur nuk do të ishte anëtar, ama do të ishte kryesues. E sa i përket emërimit, unë e bëj një korrekcion, se e di se është edhe në Kushtetutë kësisoj, mirëpo unë aludova që, tek e fundit, edhe Kushtetuta nuk është një dokument biblik që nuk mund të ndryshohet dhe do të duhej të ndryshohej jo në këtë pikë, por në shumë pika tjera.

Te neni 5, “Territori i qytetit të Prishtinës”, thuhet këtu “ndahet në 5 distrikte”. Distrikti, ç’është distrikti tek e fundit, atë që e thashë pak më parë, ama lidhur me këtë, këtu është thënë se është bashkangjitur konfiguracioni territorial, ne deputetët nuk e kemi marrë. Kush do t’i caktonte kufijtë, se nuk është lehtë për t’u caktuar kufijtë, dhe kush do t’i zgjidhte konfliktet eventuale, referuar kufijve të distrikteve.

Neni 8, “Qyteti Prishtina ushtron kompetencat vetanake...”, ama cilat, nuk thuhet se cilat, dhe ato të deleguara, cilat dhe nga kush dhe, në ç’mënyrë, të përcaktuara, madje thotë, me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, a në këtë rast ky ligj është ligj special, nuk është ky ligj gjeneral, prandaj me këtë do të duhej të precizoheshin, të specifikohejshin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit, deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, kryetar!

Opinionimi im lidhur me këtë projektligj është që të jetë në pajtim me Kushtetutën, pra, për Prishtinën kryeqytet, me status të veçantë, të bëjmë një punë të mirë brenda dy muaj dite dhe ta kryejmë këtë punë, sepse mungesa e këtij ligji ka pasur sigurisht edhe ka prodhuar pasoja tjera që ka shkaktuar edhe probleme të mëdha qoftë buxhetore në zhvillimin e kryeqytetit, qoftë ka zvogëluar investimet kapitale që mund të jenë disa milionëshe, apo mund të ketë një kohë në vetë zhvillimin gjatë këtyre dy viteve për një ambient, për një jetë më të mirë për të gjithë ata njerëz që kanë ardhur për të jetuar në kryeqytet. Mendoj që tani me këtë vullnet politik, unë mendoj që kjo strategji për kryeqytetin duhet të jetë e përbashkët, të gjitha grupet parlamentare ta mbyllin këtë projektligj dhe realisht t’i japim statusin që e meriton me Kushtetutë dhe realisht që e meriton për një jetë më të mirë kryeqyteti ynë.

Në kuadër të kësaj, ky projektligj mundëson, nëse e plotësojmë gjithnjë, pra, që Prishtina ta marrë atë status të veçantë, Prishtina të hyjë në Projektbuxhetin e vitit 2011, që ka rëndësi shumë të madhe

nëse aprovohet, sepse nëse vonohemi, kot e aprovojmë Projektligjin më vonë dhe kryeqyteti të fitojë, pra, me buxhet ato çka mendojmë, a duhet të jetë 3, 4 apo 2%, varësisht se si e vlerësojmë që është më mirë për ta zhvilluar kryeqytetin.

Në Projektligj është dhënë edhe mundësia e organizimit të ri, në njësi nënkomunale, gjegjësisht distrikte, që mendoj është mirë ta mendojë Ministria e Pushtetit Lokal. Nuk është e lehtë kjo. Çështja më e rëndësishme është kjo për të ofruar shërbime. Mos të na ndodhë, bie fjala, që Emshiri ose edhe zona periferike tjetër e qytetit, të shkojë me komunën e Lipjanit, sikur që na ka ndodhur me Gjilanin. Një kilometër prej qendrës, pjesa përëmdimore dhe Pasjaku shkojnë me Novo Bërdën. A ka logjikë? Prandaj, e lus ministrin që në fund të seancës ta japë një sqarim kur do ta ndryshojë këtë, atë memorandumin që e lypa para dite. Pra, që është me interes, nëse mendojmë për qytetarin, se janë edhe andej edhe këndej shqiptarë. Dhe, tjetra, në përfundim të kësaj pra, unë mendoj që ky projektligj mund të krijojë mundësi të reja, në qoftë se e na si Qeveri e vendit dhe grupet parlamentare realisht i ofrojmë një shans kryeqytetit me këtë projektligj që t'i ndërtojmë të gjitha dimensionet edhe ekonomike, edhe politike që i meriton, sepse të gjithë e thanë këtu.

Nëse 150.000 vetë vijnë brenda ditës në Prishtinë, edhe ata që jetojnë, banojnë, jetojnë këtu, atëherë na duhet të investojmë qoftë brenda në qytet, qoftë në paralagje, gjithçka tjetër që i duhet statusit të këtij kryeqyteti, që është pasqyra dhe panorama e punës së krejt institucioneve tona, si për zyrat diplomatike këtu, ashtu edhe për të gjitha punët që i kryen, do të thotë një kryeqytet është, të jetë një pasqyrë reale. Prandaj, ta japim kontributin, ta ndërtojmë ligjin pa ato, si të themi, ndërskamcat politike, ashtu siç e meriton më së miri. Të gjithë e duam Prishtinën....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti Emrush Xhemajli e ka fjalën.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje të gjithëve, se nuk ka kohë ta zgjasim me përsëritje!

Është i mirëpritur, Ligjin për Prishtinën po dëshirojmë të gjithë ta votojmë, por po e shohim të gjithë që me të vërtetë ka shumë zbrazëtira. E para, në nenin 5, te ndarja administrative e qytetit të Prishtinës. Edhe kjo ka qenë dashur natyrisht, ju ka nevojitur Prishtinës përherë, por numri i distrikteve nuk duhet të përcaktohet me ligj, por të jetë çështje që rregullohet me tjera dokumente, do me thënë të Komunës.

Këtu flitet për 5 distrikte, mirëpo në ligj duhet të ceket jo numri i tyre, por duhet të caktohen kriteret që një rajon i Prishtinës të fitojë statusin e distriktit. Bie fjala, numrin e banorëve në konfiguracionin, rrugët që mundësojnë komunikim më të lehtë në kuadër të një rajoni që pretendon të jetë distrikt. Nuk mjafton vetëm të thuhet “qendër” dhe të numërohen katër anët e horizontit dhe kjo është ndarja në distrikte e Prishtinës. Kjo është diqysh shumë e simplifikuar, po dihet, domethënë.

E dyta, te pushtetet. Sipas Kushtetutës, janë dy nivele të pushtetit, pushteti lokal dhe pushteti qendror. Tash në bazë të këtij bordit, me figura politike dhe me figura të emëruara, po del edhe një strukturë e ndërmjetme, edhe një hallkë tjetër e pushtetit. Unë për veti jam për këtë, mirëpo duhet një konsultë me juristët më mirë, se a është në pajtim me Kushtetutën apo jo.

Ky nen ma ka tërhequr vëmendjen, ky nen ku flitet për këtë është neni 6.2. Aty thuhet se Bordi i distriktit përbëhet prej 4 asambleistëve komunalë dhe 3 qytetarë të distriktit të caktuar. Për anëtarë të Kuvendit po dihet, ata burojnë nga zgjedhjet komunale. Për 3 qytetarët e distriktit thuhet se këta i

emërton kryetari i komunës. Kjo mendoj se nuk është zgjidhja më e mirë, sepse ndoshta zgjidhje më e mirë do të ishte të bëhet ndonjë propozim prej anës së kryetarit, edhe në kombinim me këto forma që përshkruhen këtu dhe t'i propozohet kuvendit të komunës, asamblesë që të bëjë votimin e këtyre, së paku. Por, megjithatë është shumë e ngatërruar kjo. Te zonat...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit! Naim Rrustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit!

Unë personalisht nuk po e shoh të kuptueshme dhe nuk e kam parë ende logjikën se ku qëndron e gjithë kjo përplasje për Ligjin për Prishtinën. Realisht të them, nuk e shoh logjikën që LDK, si udhëheqëse me..., e ka kryetarin e Prishtinës, ka tentuar ta bie Ligjin për Prishtinën si mjet me të cilin e arsyeton një rast apo kaosin që ndodhë në Prishtinë, apo nuk po e kuptoj pse Partia Demokratike, që janë në koalicion, pra e ka refuzuar Ligjin për Prishtinën. Unë këtë ligj e kisha refuzuar, e kisha refuzuar pa e lexuar, se ky i ka 9 nene dhe nuk rregullon asgjë. Nëse rregullon diçka, mirë kishte qenë që, ata që e mbrojnë, të shohin se çka rregullon.

Unë konkretisht do ta komentoj nenin 4. Këtu krijohet një kaos, a është kuvendi i qytetit, kuvendi i komunës, me fjalë tjera mund të jetë edhe gabim drejtshkrimor, ndoshta edhe e kanë harruar, por realisht kjo e prek organizimin e sistemit. Në rast se të gjitha qytetet, të gjitha komunat tjera e kanë të ndarë pushtetin legjislativ, pushtetin ekzekutiv dhe administrativ, atëherë cila është arsyeja, cili është rezoni i Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal me të cilën tenton ta bashkojë pushtetin ekzekutiv me pushtetin legjislativ, sepse propozohet në ligj që të jetë kryetari i Prishtinës dhe kryesues i qytetit të Prishtinës, kurse sa për ndarjet administrative të qytetit, prapë nuk ka qartësi në ligj, sepse unë mendoj se kur fillon faza e implementimit të këtij ligji, kanë për t'u paraqitur probleme shumë më të mëdha për Prishtinën, kanë për t'u paraqitur, për shembull, distrikti administrativ 1,2,3, 4, 5 distrikte dhe 4 anëtarë janë nga radhët e kuvendit të qytetit. A janë ata që janë banorë të atij distrikti, apo nuk janë, unë veç po i ngreh si tema, që gjatë leximit të dytë që të merren në konsideratë për ta amendamentuar dhe për ta bërë më të qartë.

Edhe një herë po i kthehem bisedës fillestare, temës fillestare. Nuk e di pse paska qenë problem Ligji për qytetin e Prishtinës, sepse ky ka mundur, nëse dikujt i ka interesuar ta refuzojë këtë ligj, ka mundur ta refuzojë pa e prurë hiq për shkak të përmbajtjes. I ka 9 nene, në tri gjuhët i ka 5 faqe. Me fjalë tjera, kemi mund ta kemi ndonjë debat brenda komisioneve, komisionit që merret me pushtetin lokal dhe ta sqarojmë edhe më shumë, jo të përdoret si mollë sherri në dimension politik, sepse qyteti i Prishtinës është kryeqytet i Kosovës, por është i të gjithë qytetarëve të Kosovës. Nuk ka nevojë asnjëri prej grupacioneve politike që të marrë atributë qytetarie, apo që të marrë atributë se unë e udhëheq Prishtinën...

KRYETARI: Ju faleminderit! Nuk ka qenë problemi në mes të partive demokratike, se kryeqyteti nuk është më shumë i Lidhjes Demokratike se i Partisë Demokratike. Po, vazhdojmë. Deputetja Mimoza Ahmeti e ka fjalën.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Shumëçka deri tash u tha, vetëm desha të them që ligji është i shumë mirëpritur që ka ardhur, megjithëse mendoj që është shumë sipërfaqësor dhe shumë i mangët. Mbetem me shpresën që shumëçka brenda tij do të plotësohet dhe do të ndryshohet me qëllimin që të jetë sa më përmbledhës.

Nga ato që u përmendën më herët, nuk dua t'i përsëris. Do të ndalem vetëm te një vërejtje që e kam hasur gjatë leximit të tekstit. Tek neni 8, pika 4 në versionin shqip përmendet që qytetit të Prishtinës do t'i jepet një grand shtesë në lartësinë jo më pak se 3% e grandit total të komunave për secilin vit fiskal, ndërsa në versionin anglisht, në po të njëjtin nen dhe në po të njëjtën pikë është – jo më e lartë se 3%, domethënë është një kontrast shumë i madh. Po besoj që është një gabim teknik dhe që versioni final, kur të na vjen, do të vjen i sqaruar dhe i korrigjuar.

Gjithashtu, te neni 8, tek pika 5, ku përmendet – qytetit të Prishtinës i jepet edhe e drejta e mbledhjes së tatimit me qira, shkruan, e unë besoj se kjo është – e tatimit në qira. Këto do të ishin vetëm dy vërejtje, për të mos e zgjatur më tepër, ndërkaq e përkrah dhe e përsëritës ardhjen e këtij ligji kaq të rëndësishëm për kryeqytetin. Faleminderit!

KRYETARI: Po e ndryshojmë pak radhën, se janë krejt të Partisë Demokratike. Po ia japim fjalën deputetes Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji për qytetin e Prishtinës është përmbushje e obligimit kushtetues. Megjithatë, Kushtetuta ka hyrë në fuqi para dy vjetëve, prandaj jemi me dy vjet vonesë dhe nëse ky projektligj është hartuar në Qeveri në prill të vitit të kaluar, shtrohet pyetja – pse është pritur deri sot dhe unë pres nga ministri ta shpjegojë – pse ministër një vit vonesë për ta sjell në Kuvend?

Në qoftë se është e vërtetë ajo çka shkruan në media, se ka qenë pjesë e mospërputhshmërisë në mes koalicionit ose të arritjes së marrëveshjes për ta sjellë projektligjin për qytetin e Prishtinës, atëherë duhet t'iu tregoni qytetarëve të Kosovës dhe të na informoni neve si deputetë.

Po filloj, gjithashtu, me një çështje që ka qenë shumë aktuale sa i përket Pallatit të Rinisë. E drejta e atyre që e kanë ndërtuar, është edhe e drejtë e pronësisë së tyre. Prandaj, në radhë të parë qytetarëve të Prishtinës iu takon dhe në këtë aspekt sidomos rinisë së Prishtinës, se ashtu edhe quhet – Pallati i Rinisë dhe i Sporteve. Tjetra, është se mospajtueshmëria në mes koalicionit ka sjellë deri te humbja e 14 milionë eurove. Unë e kam dëgjuar zotin Renzo Davidi, përfaqësuesin e Komisionit Evropian në televizion, i cili ka thënë se ato kanë qenë investime të dedikuara për Pallatin e Rinisë, por për shkak të problemit të pronësisë, këto mjete kanë shkuar në Mitrovicë. Këtë e përmenda vetëm për shkak të asaj se derisa jeni pajtuar ju, partnerët e koalicionit, 14 milionë euro i ka humbur Prishtina.

Prandaj, unë këtë projektligj e kam shqyrtuar nga aspekti më shumë i përfitimit për qytetarët e Kosovës. Çka do të thotë ky projektligj për qytetarët e Kosovës, a do të përmirësohet jeta e tyre, a do të ketë rregull dhe rend në Prishtinë. Po filloj nga një aspekt i rëndësishëm, i cili në një mënyrë e mërzit jetën e secilit qytetar, duke më përfshirë edhe mua – e që është ndërtimi pa leje. Prishtina po rritet në mënyrë të paligjshme, pa kontroll.

Më lejoni, të shtrojë edhe një dilemë tjetër të cilën kërkoj nga ju, z. ministër, ta qartësoni. Me projektligj parashihet krijimi i Institutit për Planifikimin Urban, do të thotë, formohet një strukturë e re. Por, nuk është definuar raporti në mes të këtij instituti dhe Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Cili do të jetë ky raport dhe si do të ndahen përgjegjësitë? Mos harroni po flasim për një çështje shumë të rëndësishme që po e ngulfat jetesën e qytetarëve të Prishtinës.

Dilema tjetër ka të bëjë me tatimin me qira. Unë i kam përcjellë të arriturat e komunës së Prishtinës dhe kam parë se komuna e Prishtinës nuk ka arritur t'i mbledhë as tatimet ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Nuk po e zgjati me hyrje, por po kaloj vetëm në disa komente dhe disa propozime për leximin e dytë. Padyshim se ky ligj është ndër ligjet e fundit që plotëson sistemin kushtetues të Kosovës. Nuk jam i sigurt, por mendoj se është i fundit, sepse ne miratuam ato ligjet për sistemin gjyqësor dhe ka qenë një obligim kushtetues i cili po përmbushet, edhe pse me shumë vonesë.

Ligji niset nga parimi i dekoncentrimit të pushtetit dhe është shumë mirë, por unë kam nja tri sugjerime, për shkak të kohës po e shkurtoj diskutimin. Sugjerimi i parë, është se Prishtina përpos që paraqitet në cilësinë e qytetit, ajo paraqitet edhe në cilësinë e kryeqytetit dhe unë sugjeroj që në nenin 3 të definohen funksionet e Prishtinës si kryeqytet i Kosovës, sidomos funksionet administrative, sepse nganjëherë Prishtina ka kompetenca për organizimin e ceremonive në nivelin shtetëror, edhe atëherë kur niveli qendror, edhe atëherë kur Qeveria organizon ato ceremoni, kështu që duhet bërë përpjekje që këtu të precizohen kompetencat administrative të Prishtinës, si kryeqytet. Mandej, Prishtina paraqitet si qytet dhe fakti që vetëm Prishtina, sipas Kushtetutës së Kosovës, ka statusin e qytetit, ka bërë që Prishtina të ketë distrikte.

Zoti ministër, unë mendoj që duhet ta rishikoni këtë nen dhe unë personalisht propozoj që të hiqet termi distrikt, të mbetet termi komuna, sepse distrikti në kuptimin administrativ është njësi shumë më e madhe se sa komuna. Mos harroni, në Shtetet e Bashkuar të Amerikës, menjëherë pas shtetit federal vjen distrikti, kështu që mjafton që qyteti i Prishtinës të ketë 5 komuna, ato 5 komuna që ju i keni cekur.

Një çështje tjetër që duhet të përcaktohet, duhet të definohen qartë cilat çështje do t'i lëmë te statuti i komunës së Prishtinës. Këtu u fol shumë për kompetencat e bordeve, por duhet të kemi parasysh që akti organik i qytetit të Prishtinës është statuti i qyteti dhe statuti i qytetit duhet t'i rregullojë çështjet procedurale dhe çështjet tjera që janë shumë të rëndësishme.

Dhe, çështja e fundit, po përmendet formimi i Institutit për Planifikim Urban, që është shumë me rëndësi. Po, duke qenë se 1/3 e popullsisë do të marrin shërbime nga qyteti i Prishtinës do të jetë shumë me rëndësi formimi i një instituti për shërbime të shpejta, elektronike dhe digjitale qytetarëve, sepse qytetarët do të kenë më së shumti nevojë që të marrin shërbime administrative për realizimin e të drejtave të veta. Unë e di që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal bashkë me Ministrinë e Administratës Publike po punojnë në këtë projekt, por komuna e Prishtinës është qyteti kryesor që duhet ta çojë përpara këtë projekt dhe të ofrojë shërbime qoftë nga gjendja civile, qoftë shërbimet tjera elektronike dhe krahas këtij instituti, që është shumë i rëndësishëm për planifikimin urbanistik, komuna duhet të mendojë për ofrime të shpejta qytetarëve, ofrime të shërbimeve sa më të mira dhe sa më të shpejta.

Unë mendoj se ky ligj duhet të zgjerohet, nuk duhet të mbetet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë! Deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Vërtet, si Kuvend kur diskutojmë për ligje që dalin nga nenet e caktuara të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet të jemi serioz, po flasim për një projektligj të rëndësishëm. Prishtina është kryeqytet i Republikës së Kosovës, është qendër politike, universitare, diplomatike dhe kulturore e vendit dhe nuk bëhet fjalë për ndarje ose luftë për kontroll të pasurive apo të aseteve të caktuara të kryeqytetit. Do të thotë, duhet ta tejkalojmë nganjëherë edhe egon personale edhe partiake dhe vërtet duhet t'i shikojmë disa projektligje që janë obligim kushtetues, t'i hartojmë ashtu si duhet dhe kryeqyteti i vendit, do të thotë, duhet ta ketë një status të veçantë dhe duhet ta ketë një organizim ligjor dhe juridik i cili vërtet u ofron shërbime edhe kryeqytetasve, po edhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, edhe atyre që nuk janë banorë të kryeqytetit dhe të Kosovës, flas këtu për institucionet, përfaqësitë diplomatike, institucionet ndërkombëtare. Ne besojmë se në të ardhmen këtu do të ketë një prani edhe të institucioneve dhe mekanizmave tjerë relevantë ndërkombëtarë dhe vërtet duhet të jemi serioz në këtë temë.

Më lejoni të shpreh edhe unë disa vërejtje në disa vakuume, qoftë te nocioni “distrikt” dhe kompetencat e tij, te përfaqësimi në bordin e distriktit dhe kam një vërejtje konkrete, më shumë në aspektin profesional, te neni 8, zoti ministër, paragrafi 7. Flitet për menaxhimin e shëndetësisë sekondare, edhe pse ende Prishtina nuk e ka të rregulluar, sepse nuk ka spital të ofrimit të shërbimeve shëndetësore sekondare. Po e citoj paragrafin 7, thotë: “menaxhimin e shëndetësisë sekondare, përfshirë edhe regjistrimin, licencimin e institucioneve për përkujdesje shëndetësore”. Unë frikoj, këtu është edhe ministri Bukoshi, që po interferon me Ligjin bazik për shëndetësi. Do të thotë, cilit nivel, çfarë licenca lëshon, cili organ, të cilit nivel dhe kush është organi kompetent që lëshon licenca të këtij niveli. Do të thotë, ju lus këtu që ta keni parasysh Ligjin themelor për shëndetësinë, të konsultoheni edhe me juristë, sepse atë funksionimin organik të ligjeve duhet ta bëjnë juristët. Unë besoj se ka edhe interferime të ligjeve tjera, edhe të Ligjit për pushtetin lokal, andaj besoj që do të ishte mirë të konsultohet edhe Ministria e Shëndetësisë, sepse licencimi, pastaj trajnimi dhe pagat e punëtorëve shëndetësorë... në rregull kryeqyteti e ka ligjin, statusin e vet, por besoj se Ministria e Shëndetësisë duhet ta thotë fjalën e vet.

Në parim, duhet ta mbështesim të gjithë këtë projektligj dhe vërtet t'iu japim fund edhe shumë spekulimeve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Teuta Hadri e ka fjalën.

TEUTA HADRI: Zoti kryetar, unë e pata fjalën e teta, e tha Naseri atë çka deshi të thotë, mirëpo meqë ma dha fjalën, faleminderit! Unë e kam parë se ka një përzierje kompetencash te neni 8, në mes të atij nivelit qendror dhe komunal, që e tha edhe Naseri dhe do të ndalem te paragrafi 4.5, ku komuna nuk i ka definuar qartë kompetencat e veta kur i përmend pallatet sportive, cilat janë të komunës dhe cilat janë të nivelit qendror. Gjithashtu, ato të shëndetësisë veç i tha Naseri, s'po marr kohë, faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit, edhe për kohën e kursyer! Fjalën e ka Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Vërtet, ajo çka u pa nga diskutimet e kolegëve deputetë, është se ne pajtohemi të gjithë se më në fund duhet ta kemi ligjin e kryeqytetit, kurse sa i përket përbërjes, gjegjësisht përmbajtjes së këtij paragrafi që na u ka ofruar përpara, shihet se është një paragraf i kopjuar, respektivisht është një draft i kopjuar nga një shabllon i caktuar, që nuk ka kurrgjë të përbashkët me kryeqytetin e Kosovës. Andaj, në këtë version çfarë është i propozuar, unë nuk shoh bash asgjë.

Ndërsa, sa i përket çështjes së paraqitjes këtu, me qëllim më të mirë të mundshëm për të bërë një ligj të kryeqytetit, ne duhet të abstrahojmë atë se kush e qeveris këtë qytet, në qoftë se dëshirojmë ta ndërtojmë një ligj çfarë e meriton Kosova, si ligj i kryeqytetit. Andaj, nuk ka nevojë fare këtu për interferime as politike, as grupore, as kurrfarë, sepse qëllimi është më i mirë, të ndërtohet një ligj për kryeqytetin.

Unë, në fakt, në bazë të këtyre që kam lexuar në këtë ligj, shihet se çështja e pronësisë së Pallatit të Rinisë dhe Sporteve nuk është definuar, që në fakt duhet të dimë një gjë të qartë: kjo nuk është ndërmarrje shoqërore, që është pretenduar deri tash, sepse Pallati i Rinisë dhe i Sporteve është ndërtuar nga kontributet e qytetarëve, që nuk janë titullarë punëtorët e Qendrës së Rinisë dhe Sporteve, por titullar janë qytetarët e Prishtinës. Andaj, nga aspekti i pronësisë, ky objekt sportiv, kulturor, edhe biznesor, i takon kryeqytetit duke marrë parasysh ligjet që i kemi në fuqi, në të cilat mbështetet edhe Agjencioni Kosovar i Privatizimit.

Në kuptimin e organizimit të brendshëm, duke marrë parasysh këtë draft të propozuar shihet se me ligj nuk janë definuar fare autoritetet, as autoritetet e atyre që po thuhet distrikte, që edhe unë shpreh rezerva, sepse më mirë është ndoshta të quhen qarqe apo pjesë të Prishtinës se sa distrikte, se nëse kanë dashur të marrin këtë koncept anglo-sankson, atëherë nuk i përgjigjet pjesëve të Prishtinës, që e tha po më duket edhe një koleg deputet, andaj në aspektin e kompetencave të autoritetit nuk është definuar saktë.

Te çështja e grandeve, se më provokoi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë! Fjalën e ka deputeti Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

Është mirë që sot po shqyrtojmë Projektligjin për kryeqytetin e Prishtinës, me të cilin do të rregullohet statusi i veçantë, po ashtu edhe funksionimi dhe organizimi i institucioneve të qytetit me qëllim të përmirësimit dhe të ngritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët e saj.

Unë do t'i ngre disa çështje parimore. Në nenin 4, paragrafi 2: "kryetari i qytetit të Prishtinës është edhe kryesuesi i kuvendit të qytetit dhe kryesues i komitetit për politikë dhe financa". Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, kryesuesi i kuvendit zgjidhet nga këshilltarët e kuvendit, i cili e udhëheq edhe komitetin për politikë dhe financa. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, kryetari i cili ka dalë nga votat e drejtpërdrejta të qytetarëve, ka kompetenca të mjaftueshme për ushtrimin e funksionit të tij, prandaj ushtrimi i funksionit edhe si kryesues i kuvendit dhe i komitetit për politikë e financa është përgjegjësi shtesë dhe ngarkesë e panevojshme, kur dihet se në bazë të paragrafit 3 të këtij neni, kryetari nuk është anëtar i kuvendit të komunës dhe komitetit për politikë e financa. Po ashtu, pozita e kryetarit është pozitë ekzekutive në komunë.

Unë konsideroj se duhet të ketë ndarje të pushteteve me qëllim të funksionimit më të mirë. Atëherë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duhet të mendojë edhe për plotësim-ndryshimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nëse Projektligji miratohet në këtë formë.

Në nenin 6, ku flitet për organet e distrikteve administrative, në paragrafin 2, bordi i distrikteve përbëhet nga 7 anëtarë, 4 nga radhët e Kuvendit të qytetit të Prishtinës dhe 3 anëtarë janë nga zonat e distriktit. Shtrohet pyetja, çka nëse nga një zonë e distriktit nuk kemi asnjë të zgjedhur për këshilltarë të kuvendit të qytetit, apo kemi vetëm një, sepse kjo mund të ndodhë duke pasur parasysh Ligjin për

zgjedhjet lokale. Unë e ngre këtë çështje, sepse plotësimi i bordit prej 4 anëtarëve nga kuvendi i qytetit, nga zonat e distrikteve tjera, duke pasur parasysh mentalitetin dhe dëshirën e përfaqësimit, kjo mund të sjellë pakënaqësi dhe mosfunksionim të duhur të bordit. Këtë duhet ta kemi parasysh.

Po ashtu, edhe emërimi i 3 anëtarëve të tjerë nga ana e kryetarit, sigurisht se duhet t'i paraprijë një proces zgjedhor brendapërbrenda zonës së distriktit, sepse në këtë mënyrë ata do të kenë legjitimitetin e plotë të përfaqësimit.

Në nenin 8, paragrafi 4, "qytetit të Prishtinës i jepet një grand shtesë në lartësi jo më pak se 3% e grandit total të komunave për secilin vit fiskal". Kjo duhet të saktësohet se sa duhet të jetë përqindja e grandit shtesë, sepse kështu lihet mundësia për interpretime të ndryshme, se duhet të jetë 3, 5, 7 e kështu me radhë.

Implementimi i këtij ligji do të ketë kosto financiare, që në fakt ne nuk e kemi deklaraten financiare, se sa në të vërtetë do të duhen mjete për implementim.

Duke parë rëndësinë që ka ky Ligj për kryeqytetin e Kosovës, do ta përkrah në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkolli, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni-Kaloshi.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit! Në fakt, janë disa çështje të cilat u thanë disa herë dhe po përpiqem të mos i përsëris. Një problem që po i përcjell gati të gjitha ligjet, mendoj se po e përcjell edhe këtë ligj. Që në hyrje të ligjit, kur flitet për qëllimin e projektligjit, vazhdimisht thuhet se qëllimi i projektligjit është krijimi i bazës ligjore. Mendoj se kjo çështje duhet të ndryshohet, sepse në fakt fjala është për politikën e Qeverisë, të cilat përmes krijimit të bazës ligjore rregullojnë çështje të caktuara. Ligji nuk është qëllim i vetvetes. Ligji rregullon. Prandaj, kjo duhet të trajtohet në të gjitha ligjet dhe projektligjet që po na vijnë në Parlamentin e Kosovës.

Sa i përket emërimit të ligjit, mendoj po ashtu se duhet të saktësohet. Ndoshta Ministria ka parë modele të ndryshme, mirëpo duhet të qartësohet se është fjala për kryeqytetin e Kosovës, të Republikës së Kosovës dhe jo sikur për njërin nga qytetet e Kosovës. Emërtimi kështu, në fakt, të bën të mendosh se është fjala për një nga qytetet e Kosovës.

Sa i përket strukturës dhe organizimit të brendshëm, mendoj se ky ligj më shumë çrregullon se sa që rregullon diçka në kuptimin e funksionimit të qytetit. Kompetencat, dikasteret... është menduar gati sikur në ato të ashtuquajturat në atë kohë dhe jo të ashtuquajturat, por në fakt kanë ekzistuar në atë kohë bashkësi lokale, sa iu përket kompetencave bile kanë edhe më pak tash këto dikastere. Bordet është shumë e paqartë se si krijohen, kompetenca pretendon të jetë më shumë territoriale se sa kompetenca funksionale, që u barten këtyre bordeve, por në fakt kemi një paqartësi të madhe, sepse nuk dihet kush i emëron, në fakt, thuhet i propozojnë qytetarët e dikasterit, por nuk dihet kush i emëron anëtarët e bordit, një pjesë të tyre, së paku.

Prandaj, mendoj që në atë kuptim nuk është bërë as decentralizim dhe as dekoncentrim dhe ka mbetur një çështje shumë e paqartë.

Një problem tjetër lidhet me shëndetësinë. Unë mendoj që në këtë ligj duhet të ketë vend që në mënyrë taksative të thuhet që Prishtina duhet të ketë spitalin e qytetit. Këtu nuk është thënë. Është folur diçka për shëndetësinë, pa e përmendur edhe spitalin e qytetit dhe në këtë kuptim mendoj se duhet të thuhet kjo.

Dhe, sa i përket Pallatit të Rinisë, unë nuk kam çka të shtoj shumë. Është kontributi i qytetarëve dhe si i tillë edhe duhet të menaxhohet.

Kam frikë që nuk do ta rregullojë shumë funksionimin e qytetit të Prishtinës ky ligj. Ndoshta do të jetë po ashtu njëri nga ligjet që do të duhet Parlamenti i Kosovës përmes mekanizmave të vetë t'i hyjë shumë seriozisht rishkrimit apo ri-rregullimit të tij.

Dhe, ka një problem këtu. Në fakt, këto ligje po na vinë si pasojë e problemeve që po ka koalicioni qeverisës. Në rastin konkret, LDK-ja po bëhet sikur po do ta bëjë këtë ligj, PDK-ja po bëhet sikur nuk po do. Në fakt...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni, le të përgatitet deputetja Myzejene Selmani.

HYDAJET HYSENI: Përshëndetje!

E përshëndes këtë ligj! Kam pritur më shumë. Kam në dhjetë nene, së paku dhjetë vërejtje. Së pari, ligji nuk shpjegon kush e ka përgatitur, nuk i ka përkufizimet, nuk e ka ç'është e vërteta as deklaratën financiare, po kjo e fundit ndoshta është mirë kur ligji nuk ka implikime financiare, e të mos bëhemi rob të formaliteteve.

Në nenin 2, në shqip, është “aranzhime brenda komunale”, por në anglisht është “ndërkomunale”. Është saktë në anglisht dhe tregon që teksti është shkruar në anglisht dhe pastaj është përkthyer shqip.

Në nenin 3, flitet për status special të qytetit dhe s'ka gjë të keqe, por në anglisht është fjala për status special të distriktit special. Në shqip, është njësi speciale. Kjo loja me shumë “speciale” mund të ketë probleme speciale.

Në nenin 4, në shqip është “kryetar”, në anglisht është “mejor” që do të thotë prefekt. Edhe kryetar, edhe prefekt nuk shkon.

Po, si do që të jetë, thuhet se çështja e kryetarit rregullohet me Ligjin për vetëqeverisjen, si është, për Pushtetin Lokal, por në të vërtetë këtu kërkohet që kryetari të drejtojë asamblenë komunale, që s'është në përputhje me ligjin.

Në nenin 5, janë distriktet që janë të distriktit, në anglisht e kam fjalën, dhe janë katra prej tyre rurale, kurse kërkohet më vonë që të jetë metro-zonë metropolitane. Zonë metro-politane me 4 njësi rurale dhe pa asnjë park..., pa asnjë plan, tingëllon si ajo – e sheh bretkosa si mbathen buajt dhe e ngre këmbën.

Bordet janë edhe nga kuvendi, edhe nga qyteti, edhe nga distrikti. Nuk di si funksionon. Personeli paguhet nga buxheti i qytetit, një centralizim buxheti s'di si funksionon. Çdo distrikt, thotë “organizon dy takime me qytetarët”. Çka është tash distrikti? A është njësi administrative apo është një, si të thuash, trup administrativ që organizon takime.

Kërkohen pastaj lidhje – zona metropolitane me komuna fqinje, por nuk janë të gjitha komunat fqinje. Pse disa janë, disa nuk janë? Pse nuk është Artana, ta zëmë?

Ose kjo farë zona metropolitane siguron resurse të mjaftueshme, vini re, nga buxheti i komunave tjera. Kush e rregullon, si funksionohet kjo?

Dhe, për ta përfunduar, gjithë kjo hyn në fuqi për 15 ditë. A mund të rregullohen të gjitha këto çështje, këto transformime për 15 ditë? Le të jenë këto si vërejtje. Faleminderit, për kohën!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Myzejene Selmani, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për të gjithë të pranishmit!

Duke marrë parasysh vonimin e këtij projektligji në total prej 10 faqesh dhe duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji për kryeqytetin e shtetit të ri të Kosovës, që besoj dhe shpresoj është dashur kaherë të sillet në Kuvendin e Kosovës, shihet se Projektligji nuk bie ndesh me direktivat e BE-së dhe me fuqinë legjislative e cila është dispozitë themelore e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ligji për kryeqytetin e Prishtinës, duke marrë parasysh të gjitha nenet të cilat i posedon ky projektligj, shihet shumë qartë, po s'dua të hyjë në çështje teknike të cilat u potencuan nga të pranishmit, shihet shumë qartë se duke marrë parasysh... thuhet se grandit shtesë mund të jetë më pak se 3%, diç absurde për një kryeqytet të një shteti demokratik dhe shteti të ri të Kosovës, që është dashur së paku të jetë 5 e më tepër, kur dihet rëndësia e kryeqytetit.

Dhe, çështja tjetër që mund të potencoj këtu, Ligji i Prishtinës nuk bie ndesh as me ligjet e pakos së presidentit Ahtisari, në të cilën pako është edhe Ligji për Agjencionin Kosovar të Privatizimit, do të thotë me çështjen e pronësisë dhe mundësia definitive e menaxhimit me pronën dhe ndërmarrjet shoqërore do të jetë pronë e kryetarit të Prishtinës apo, më mirë të them, pronë e institucionit të Prishtinës, se pavarësisht kush e udhëheq qytetin e Prishtinës, më e rëndësishme është institucioni që të funksionojë në bazë të ligjit i cili është prezent sot këtu.

Njëkohësisht, dua të them se duke marrë parasysh se e gjithë prona në komunën e Prishtinës është ndërtuar nga prindërit tanë, atëherë edhe menaxhimi edhe i Pallatit të Rinisë dhe i një spitali të mundshëm të Prishtinës duhet të menaxhohen nga stafi i komunës së Prishtinës apo institucioni të cilin e udhëheq Prishtina. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, le të përgatitet Flora Brovina.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryetar!

Më vjen keq që u kufizua vetëm në 3 minuta, se është kjo temë të cilën e kam pritur me mjaft padurim, kështu, për të diskutuar.

Ligji është katastrofal, në të gjitha kuptimet. Nuk zgjidh asgjë. Asgjë nuk zgjidh! Nuk ka kurrfarë konflikti në mes koalicionit, po ju them, se ligji për Prishtinën do t'i marrë votat 100% nga të gjithë deputetët. Jam me bindje të plotë se çdonjëri prej nesh do ta votojë ligjin. Nuk është kryeqyteti i Prishtinës i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Këtë kuptoni njëherë e përgjithmonë dhe e di se kështu mendoni si unë, të gjithë do ta jepni votën.

Mirëpo, problemi është se çka zgjidh ky ligj. Ky ligj, kështu qysh është, duhet të quhet për kryetarin e Prishtinës. E centralizon pushtetin krejt te kryetari i Prishtinës, ia jep atij të drejtën të drejtëjshme kuvendin komunal, do të thotë në kuvendin komunal i jep të drejtën t'i emërojë qytetarët, i jep të drejtën në vendimmarrje, i jep të drejtën këtu... Mua më vjen keq. Ky kryetari aktual që është, ky nuk

e ka ushtruar pushtetin as 100 metra jashtë komunës së vet, e do të ketë akoma koncentrim të pushtetit në vetvete. Domethënë, ky më mirë është dashur ta quaj “Ligji për Isa Mustafën” se jo Ligji për kryeqytetin e Prishtinës.

(Reagim)

Do të thotë, ky është thelbi i problemit. Ky është thelbi i problemit! Nuk është problemi që Prishtina s’ka pas para, po Prishtina nuk mund të qeveriset me mentalitet urban katunaresk, qysh është duke u qeverisur aktualisht. Ata që nuk e kuptojnë, le ta marrin sociologjinë post-modernë të Skotlandës dhe le ta lexojnë, çka do me thënë, ku fillon moderniteti në shoqëri. Moderniteti fillon te arkitektura. Të menduarit në arkitekturë e shpreh kultura, kultura e banimit e shpreh kulturën e qytetit. Shikoni ndërtesat që janë të ngjitura njëra me tjetrën në qendër të qytetit të ish “Sllovenia sporti”, ku rrezikohet jeta e qytetarëve. Pastaj, e tha njëri diskutues këtu, çfarë qyteti metropolitan mund të bëjmë ne. Me çfarë kriterë ka hy Podujeva në Prishtinë, kur është 30 kilometra e më shumë prej Prishtinës, kurse Lipjani 15 kilometra.

Domethënë, këtu janë disa tendenca të individëve që donë ta kenë qytetin e Prishtinës si pronë të veten dhe konsiderojnë se Prishtina është e tyre. Nga ky mentalitet ne duhet të heqim dorë.

Unë jam i bindur se ligji i duhet Prishtinës, por jo ky ligj çfarë është. Thotë këtu, e kemi shfrytëzuar përvojën e Sllovenisë, të Gjermanisë, e ku ta di unë. Unë kam qenë në Slloveni, kam jetuar 18 vjet. Nuk është përvoja e Sllovenisë. Prishtina duhet të decentralizohet, t’i ketë 5 komuna, përkatësisht kriter për formimin e komunave, sipas standardeve evropiane, janë 60.000 banorë. Të formohen komunat e reja, të krijohet Prishtina si bashki dhe të kemi krye-bashkiakun, të bëjmë zgjedhje në komuna të reja. Nuk mund të vendosë një pjesë e qytetit të Prishtinës, e cila del gjithë në votime, kurse 80% e qytetarëve të Prishtinës i bojkotojnë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Propozimet po dalin, do të thotë sipas do propozimeve do të ndryshohet Kushtetuta, pastaj të bëhet ligji. Keni parasysh këtë. Fjalën e ka deputetja Flora Brovina, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

FLORA BROVINA: Përshëndetje, zoti kryetar!

Kolegë dhe kolege,

Më vjen mirë që ky ligj më në fund erdhi për shqyrtim, por jam më se e dëshpëruar për nivelin që e ka ky ligj. Mbase ligji nuk i përmbush kërkesat e atyre që kanë menduar se me ligj pak a shumë do të zgjidhen disa probleme kaotike për kryeqytetin e Kosovës.

Së pari, nuk i kam të qartë disa terma që përdoren nga Ministria e Pushtetit Lokal, e në këtë rast edhe me termin distrikt. Sepse, shpesh përdoret “region” dhe ne nuk kemi regjione, Kosova nuk është e ndarë në regjione. Tani është një term i ri, që nuk jep të kuptohet se çka është në të vërtetë.

Nëse me këtë keni kuptuar nën-komunat, atëherë mund t’i quanim edhe komuna urbane, pse jo. E një shembull të tillë e kemi me komunën e Tuzit, që është vetëm komunë urbane, por ndryshe janë të zgjedhura strukturat udhëheqëse dhe qeverisëse.

Prandaj, insistoj dhe sigurisht në formë të amendamentit do ta paraqes se si mund të udhëhiqet ndryshe, jo si është në ligj, si të zgjidhen këto organe udhëheqëse të komunave urbane, e që nuk i keni emëruar fare dhe është e pakuptueshme që ato të quhen djathtas e majtas, veri, jug ose qendër. Ato

duhet ta kenë emrin e vet, territorin e vet, numrin e banorëve dhe arsyeshmërinë pse duhet të jenë komuna urbane.

Së dyti, desha të përqendrohem në edhe çështjet që janë të lidhura me asetet e qytetit. Kujtoj se asetet e qytetit janë asete të qytetit dhe mendoj se Pallati i Kulturës i takon qytetit, mbasi që janë dhënë mjete pas një referendumi, si një metodë shumë demokratike e qeverisjes lokale për ta ndërtuar një pallat të tillë.

Kujtoj se çështja e referendumit gjithashtu duhet të hyjë në ligj dhe të propozohet për shfrytëzimin e pasurive tjera që i ka Prishtina, sikur që është Gërmia ose regjionet tjera, si është Zllatari ose ndonjë regjion tjetër që duhet të jetë i mbrojtur në veçanti dhe ndërtimet ose shfrytëzimi i tyre të vendoset pas referendumit.

Kjo është një nga vërejtjet e mia, por kam shumë amendamente që besoj do t'i ndihmonin që të zgjidhet mirë ky projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka i fundit për sot, Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit!

Të qenët i fundit dhe të flasësh për këtë ligj, që shumë thanë është i zbrazët dhe bajat, është pak siklet, por megjithatë do të them diçka që ka të bëjë me këtë projektligj, por ka të bëjë edhe me gjëra tjera, por po them kështu në mënyrë të veçantë - me këtë projektligj, me mënyrën se si disa tentojnë ta patronizojnë Prishtinën me terma “qytetarë”, “qytetari i Prishtinës”.

Të nderuar, këtu ngatërrohet tani termi “banor”, sepse çdo individ që lind apo jeton në një vendbanim është banor, por jo edhe domosdoshmërisht qytetar. Mund të jetë banor i vendbanimeve rurale apo i vendbanimeve urbane, por jo qytetar, sepse qytetar – qytetaria është atribut. Për ta fituar statusin e qytetarit, banori duhet të kontribuojë në komunitet dhe në shoqëri në përgjithësi, pra duhet t'i përfaqësojë dhe përqafojë vlerat e qytetarit.

Hajnat, keqbërësit, rrencat, të korruptuarit, shkelësit e ligjit - nuk janë qytetarë. Me fjalë tjera, për të qenë qytetar, parakusht është të respektohet ligji, rregullat, por edhe të jesh aktiv në procesin e vendimmarrjes me konsekuenca kolektive.

Tash disa, po them edhe një herë, që e kanë dëmtuar Prishtinën, nuk mund të jenë qytetarë. Ata mund të jenë banorë, statusin e qytetarit s'mund ta marrin. Ata e kanë me lindje statusin e banorit, por jo edhe të qytetarit dhe s'kanë të drejtë ta patronizojnë qytetin e Prishtinës apo cilindo qytet... Mund të flasin për gjëra të tjera.

Prishtina iu takon qytetarëve të ndershëm, ata që me të vërtetë tentojnë të bëjnë diçka, ndonëse janë të pakët, më pak sesa këta hajnat dhe rrencat që e kanë sjellë në këtë derexhe Prishtinën. Faleminderit!

KRYETARI: Nejse, edhe ky është fjalor parlamentar! Faleminderit! Ministër, mund të thuash,, por edhe ti 3 minuta. Jo, jo, 3 minuta shkurt, punën tjetër e bën komisioni.

MINISTRI SADRI FERATI: Faleminderit!

Unë, vërtet ju falënderoj dhe shpreh kënaqësinë për përkushtimin e deputetëve në mënyrë që vërtet Ligjin për Prishtinën ta bëjmë sa më të mirë.

Disa çështje që lidhen me precizimin, termat, vërtet komisioni do të bëjë punën e vet dhe unë, meqenëse nga kryetari m'u tërhoq vërejtja që i kam vetëm 3 minuta, nuk do të lëshohem në një pjesë, por vetëm do të provoj për t'i dhënë disa sqarime për ta kuptuar më tepër cili ka qenë qëllimi jo vetëm i sponzorimit, por edhe i bërjes së ligjit.

Së pari, dihet se Prishtina edhe me Ligjin e ri mbetet si një njësi, vetëm një njësi politiko-administrative. Pra, mbetet komunë, si të gjitha komunat tjera dhe funksionon sipas Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

Të veçantat, që tani i përfiton komuna e Prishtinës, përshkruhen me ligjin e veçantë – me Ligjin e Prishtinës. Pra, shpallet kryeqytet i Republikës së Kosovës dhe të gjitha angazhimet që ajo të rregullohet në terminologji, i respektojmë. Mbetet në fuqi Ligji për kufijtë administrativ. Pra, asgjë nuk ndërron në aspektin e zonave kadastrale, siç u tha, prandaj edhe nuk ishte temë e diskutimit kjo.

Distriktet apo zonat, ne kemi mund vetëm t'i definojmë, sikur edhe te komunat tjera. Komunat kanë të drejtë që të dekoncentrojnë shërbimet, që të krijojnë kontakte më të mira me qytetarët duke i shfrytëzuar të gjitha potencialet e strukturave komunale. Ato do të jenë këshilla konsultative, i afrohen komunitetit, diskutojnë ku do të investojnë, si do të bëhet. Me fjalë tjera, e zgjojnë interesimin e qytetarëve për afrim në vendimmarrje. Por, vendimmarrja nuk koncentrohet. Ajo mbetet aty ku ka qenë, te asambleja komunale, te kryetari dhe organet ekzekutive.

Bën përjashtim mjekësia sekondare. Siç dihet, Prishtina, u tha me të drejtë, nuk ka spital ngase ai po shfrytëzohet edhe si terciare dhe për nevojat e gjithë Republikës së Kosovës dhe është kërkesë e drejtë e qytetarëve të Prishtinës që ta kenë spitalin, spitalin vetjak, sikur çdo komunë tjetër e Kosovës.

Grandi u tha, pikërisht këtu, duke marrë parasysh edhe çështjen në shëndetësi dhe shumë çështje të tjera dhe pajtohem edhe me diskutuesin kur tha këto janë resurse, por janë resurse afatgjate. Dhe ideja është që t'i ndihmohet Prishtinës shumë shpejt, për pak vite, që ajo të ndërtojë kapacitetet e nevojshme që të funksionojë si komunë, t'i shërbejë mirë si kryeqytet Republikës së Kosovës dhe më vonë me resurset e veta mund të ndodh që do t'i kontribuojë buxhetit, e jo të marrë më tutje, por flitet për një afat sa më të shkurtër.

Edhe instituti, siç dihet, edhe çështjet e urbanizmit, çështjet e kulturës që diskutohet për Pallatin, janë kompetenca vetjake. Ne vetëm i kemi rishkruar, sepse dihet, komuna është kompetente të menaxhojë me çështjet e kulturës, me çështjet e planifikimit urban, çështjet rregullative dhe çështjet tjera. Çështja e pallatit ka hyrë si çështje, që në vullnetin e Kuvendit dëshiron t'i thotë – stop më një zvarritjeje dhjetëvjeçare ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Regjia, edhe një minutë ia mundësoni ministrit!

MINISTRI SADRI FERATI: ... zona metropolitane, e thashë në fjalën time, mundet, pra është në vullnetin, jo vetëm Prishtina, mund edhe Prizreni me 4, 5 komuna të veta ku ka interes, shërbimet publike, siç është çështja e fabrikave të ujit, çështja e fabrikave për trajtimin e ujërave të zeza e të tjera, e të tjera. Pra, është vullnet. Vetëm e kemi rishkruar një çështje që dihet. Komuna e Prishtinës, me komunat përreth ka të drejtë që të bëjë bashkëpunim ndër-komunal për çështjet që i kanë me interes dhe ky nuk është ndonjë detyrim apo ndonjë cenim. Dhe prapë është autonomi e komunës së Prishtinës dhe të tjerave dhe në organizimin zonal, në organizimin metropolitan.

Licencimet tek mjekësia sekondare, u thanë, atëherë kur bie në kompetencë, jepet edhe kompetenca e themelimit të atyre institucioneve.

Referendumi, do të rregullohet me ligj të veçantë. Referendumi, pra, si një e drejtë e komunave, referendumi dhe çështja e borxheve do të rregullohen me ligje të veçanta.

Edhe një herë ju falënderoj dhe shpresoj se ne do t'i afrohemi edhe komisionit që të bëjmë bashkë një punë me komisionin, në mënyrë që...

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Mendoj që debati është harxhuar dhe ju falënderoj për debat korrekt. Hymë në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Në sallë kemi 74 deputetë. Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota “për”, 5 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për qytetin e Prishtinës.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhen që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ujërat e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë dhe ministra,

Në vazhden e ndërtimit të infrastrukturës së re ligjore për administrimin e resurseve ujore në Kosovë, kam kënaqësi të prezantoj Projektligjin për ujërat.

Nxjerrja e Ligjit për ujërat e Kosovës është i nevojshëm për faktin se me ligjin ekzistues shumë çështje nuk janë të përfshira, duke filluar nga përkufizimet dhe përafrimi me Direktivën 2000/60 të Komisionit Evropian dhe të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës, të datës 23 tetor të vitit 2000 në fushën e politikës së ujërave.

Me këtë ligj rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me ujërat sipërfaqësore, liqenet, akumulimet, rezervuarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësore, tokat e lagëta, truallin buzë bregut të lumit, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e tyre, përdorimin dhe shpërndarjen e ujërave, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujërave, si dhe mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë përmbytjet,

vrshimet, erozionin, objektet dhe infrastrukturën ujore, financimin e ujërave, si dhe kushtet, mënyrat dhe veprimet me të cilat mund të shfrytëzohen ose shkarkohen ujërat.

Ligji është hartuar në harmoni me standardet evropiane, sipas teknikave të reja juridike, me një koncept fleksibil.

Risitë dhe avancimet e Projektligjit për ujërat e Kosovës janë në mënyrë përmbajtësore dhe më saktë adreson rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e resurseve ujore, si dhe krijon Këshillin Ndërmintor për Ujëra, në vend të deritanishëm të Këshillit Kombëtar të Ujërave, Institutin e Kosovës për Ujëra, por gjithashtu paraprakisht ka qenë planifikuar edhe fondi i ujërave, por këto do të rregullohen me Ligjin e eko-fondit. Por, gjithashtu do të formohen dy njësi rajonale për administrimin e pellgjeve lumore.

Projektligji përbëhet prej 15 krerëve me 113 nene. Për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete shtesë buxhetore. Projektligji është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet që janë të përafërta me dispozitat e *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese. Në Projektligjin për ujërat e Kosovës, thashë, hiqet formimi i Këshillit Kombëtar të Ujërave dhe do të zëvendësohet me Këshillin Ndërmintor të Ujërave. Funksioni i tij do të bëhet nga ekspertët të cilët janë të punësuar në ministritë respektive dhe nga ministrat përkatës.

Krijimi i Institutit për Ujëra përfshihet me Udhëzimin administrativ ministror dhe pa u siguruar buxheti vetjak për vitin vijues Ministria e Mjedisit nuk do ta themelojë, por është në planifikim në vitet e ardhshme të themelohet.

Krijimi i dy rajoneve të pellgjeve lumore të cilat do të menaxhojnë pesë pellgje lumore të Kosovës bëhet nga stafi ekzistues, do të thotë nuk do të ketë implikime buxhetore.

Dispozitat e këtij projektligji lidhur me administrimin e resurseve ujore garantojnë të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ujë të bollshëm dhe të pastër.

Të nderuar deputetë, ju ftoj që të votoni Projektligjin, në parim, duke besuar se ligji në komisionet parlamentare do të kompletohet. Ju faleminderit për vëmendjen!

Drejtimitin e mbledhjes e merr zoti Eqrem Kryeziu, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Në emër të komisionit funksional nuk ka të paraqitur. Atëherë, shkojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. E kemi zonjën Elheme Hetemi. A jeni ju që doni të flisni në emër të PDK-së? Atëherë, zonja Elheme Hetemi e ka fjalën.

ELHEME HETEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka analizuar dhe e ka vlerësuar sponzorimin e këtij ligji kaq të rëndësishëm për rregullimin e një fushe mjaft të gjerë, siç është një resurs mjaft i rëndësishëm i natyrës, i cili ka një përdorim të gjerë dhe kërkon një vëmendje dhe një rregullim ligjor për fushëveprimtarinë e gjerë, ashtu siç e elaboroi edhe ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si sponzorizues i këtij ligji.

Në veçanti, gjatë analizës dhe gjatë shqyrtimit të këtij projektligji ajo çka ka qenë e rëndësishme, duke ku bazuar në fushëveprimtarinë dhe përdorimin e gjerë të këtij resursi natyror dhe përgjegjësitë e kompetencat ndërinstitucionale dhe ndërministrore, ka qenë e rëndësishme themelimi i Këshillit Ndërmintor të Ujërave dhe i Institutit të Ujërave.

Shpresoj se në bazë të strukturës ligjore që ka ky projektligj dhe përmbajtjes dhe fushëveprimtarisë do të gjejë një zbatim, do të ketë zbatim për kushtet të cilat janë në Kosovë. Ky ligj është i bazuar në direktivat e Bashkësisë Evropiane, madje është i përafër me këto direktiva të Bashkësisë Evropiane.

Vërejtjet konkrete që i kemi hasur në nene të caktuara, si anëtare e Komisionit funksional për Mjedis, Planifikim Hapësinor, Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim rural, sigurisht se në bashkëpunim me anëtarët e komisionit dhe zyrtarët që e kanë hartuar këtë projektligj, por ajo çka është shumë e rëndësishme që të jemi të sigurt dhe të jemi më në ngjarje, të jemi më të sigurt që këto projektligje, në bërjen e ligjeve të mira dhe të zbatueshme për Kosovë kemi një zbrazësi që e vërejmë. Ministrat, në veçanti ministrat bashkëpunojnë pak, që mendoj unë është shumë e rëndësishme gjatë shqyrtimit të projektligjeve të jenë në komisionet funksionale prezentë edhe vetë ministrat, sepse po hasim në vështirësi në shqyrtim dhe në arsyeshmëri të neneve të caktuara vetëm me zyrtarë përkatës të zyrave ligjore që i hartojnë këto projektligje. Faleminderit! E përkrahim në parim këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit zonja Hetemi. Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës përkrah Projektligjin për ujërat e Kosovës, sepse një ligj i tillë rregullon administrimin dhe përkujdesin për ujë, si burim shumë i rëndësishëm për jetën e njeriut.

Me këtë projektligj përcaktohen rregullat për administrimin e ujërave, themelimin e Këshillit Kombëtar për Ujëra, përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësitë e organeve që themelohen me këtë ligj, shfrytëzimin e ujërave e tjera.

Projektligji avancohet më tej drejt respektimit të standardeve të Bashkimit Evropian. Ligji aktual për ujërat e Kosovës numër 2004/24, gjegjësisht Rregullorja e UNMIK-ut 2004/41 ka pasur shumë mangësi, andaj me këtë projektligj do të eliminohen dhe ligji do të jetë më i zbatueshëm në praktikë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah, në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zef! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet në parim këtë ligj. Arsyeja kryesore pse e mbështesim dhe e votojmë, në parim, është se s'kemi çka të bëjmë. Domethënë, nuk kishim kontribuar nëse e kthejmë, se e dimë që nuk vjen më i mirë herën tjetër dhe mendojmë se nëse ka hap përpara ta votojmë këtë ligj, prapë deri në një dozë është hap përpara.

Sidoqoftë, kur fillojmë të diskutojmë për ligjin dhe kur ministrat e prezantojnë ligjin, e kam potencuar disa herë, është mirë që, në vend se të na tregojnë sa nene i ka ligji, të na tregojnë, shembull e marrim, konkretisht cilat janë ndryshimet.

U tha këtu edhe prej deputetëve dhe po e pranoj se e thonë që e përfaqësojnë grupin dhe kanë kohën e shkurtër të flasin, por kur flet ministri dhe thotë ka përparime, atëherë është mirë të na tregojë cilat janë përparimet, se janë dy ose tri krejt, nuk janë shumë. Të na tregojë, shembull ta marrim dhe vetëm sa për shembull po e marr – dozat e lejuara të hedhjes, çka po di, të klorit në ujërat e zeza, kanë qenë kaq, tani janë reduktuar me ligj dhe kjo është një përparim. Mirëpo, nuk kemi dëgjuar diçka asisoj dhe është shumë problem një ligj që i ka mbi 100 nene për deputetët, të cilët nuk janë dhe nuk duhet të jenë ekspertë të lëmisë, se ne jemi përfaqësues, nuk jemi këtu përfaqësues të ekspertëve, por jemi përfaqësues të popullit. Domethënë, ne që nuk jemi ekspertë, është mirë të dëgjojmë prej ministrit çka po votojmë, cilat ndryshime jemi duke i votuar. Se, në fund të fundit, tanë ata njerëz në Ministri që e përgatisin, edhe e di që janë të mirë ata njerëz, kanë mundësi t'i shkruajnë dy faqe tekst, të tregojnë çfarë ndryshimesh po votojmë ne, çka ndodh në Kosovë më ndryshe se që ka ndodhur deri sot, kur aprovohet ligji.

Mendoj se politikisht kjo është tepër me rëndësi në Kuvend vazhdimisht ta dimë. Edhe një herë po e përsëris, është tepër lehtë, tepër e saktë çka ndodh më ndryshe në Kosovë prej momentit që ligji hyn në fuqi. Vetëm kaq nevojitet ta dinë deputetët e Kuvendit të Kosovës për ta votuar ose mos e votuar një ligj. Nuk kanë nevojë të dinë kurrgjë më të komplikuar.

Tash po shkoj te disa pika tjera, të cilat i kemi shikuar. Shembull të marrim, Agjencioni për Integritet thotë që ndodh përafrimi me *acquis communautaire*, prapë as Agjencioni nuk tregon çka, në cilat elemente ndodh ai përafrim dhe a ndodh me të vërtetë. Ne që nuk e kuptojmë këtë lëmi, mund të mos i besojmë fjalës së Agjencionit, as fjalës së ministrit, se nuk po na ilustron me kurrgjë hiq këtë përafrim.

Çështje tjetër është, shembull të marrim, neni 38. E keni nenin 38 dhe prapë po flas për agjencionet, se fola për Agjencionin për Integritet, që është pjesë e Ministrisë. Tash po flas për një agjencion, që disa herë kam kërkuar që edhe ata t'i marrin ligjet dhe t'i shqyrtojnë para se të na vinë neve këtu si Kuvend. Është Agjencioni Antikorrupsion. Është Agjencion i yni dhe është mirë, nuk ka të bëjë kjo me korrupsionin dhe nuk po aludoj në korrupsion. Mirëpo, nëse duam strukturalist ta luftojmë korrupsionin, atëherë neni 38 thotë “statusi i objekteve dhe pajisjeve ujore fitohet ose humbet në bazë të vendimit të ministrit”. Kush e lexon tekstin, në radhë të parë, në radhë të parë i shkon mendja që ka hapësirë shumë të madhe... Ministri është burrë i mirë, krejt në rregull! Ama po lejohet njëfarë hapësire, domethënë, e çuditshme. Edhe mund të ndodhë që Agjencioni Antikorrupsion sugjeron diçka tjetër. Strukturalisht nëse mendojmë, jo të mendojmë a është ministri i mirë a është ministri i keq, po a lejohet si strukturë diçka e tillë.

Çështje tjetër, shpesh po përdoret “ministri i ministrisë”, veç ministri thuaje, ministri i Mjedisit. “Ministri i ministrisë”! Nuk ka ministër të drejtorisë, ministri i ministrisë. Nuk ka nevojë... Domethënë, është një përdorje e keqe, po nuk kam dëshirë kështu... OK. Në rregull!

Diçka tjetër, që është tepër me rëndësi dhe që duhet të shihet, është çështja e ndalesave. E keni nenin 48 dhe po e lexoj prapë çka thotë neni 48. Thotë kështu: “Ndalohej”, vazhdon më tutje...”nxjerrja e rërës, zhavorrit, gurëve, deponimi dhe hudhja e mbeturinave, mbeturinave të ngurta dhe shkarkimi i materieve të lëngëta në ujërrjedha, liqene, akumulime dhe brigjet e tyre”. Nen, tepër interesant! Gjithë kishim dashtë të implementohet kështu si është, ta shohin Kosovën një ditë që ky nen plotësisht implementohet. Por, nëse sot neni hyn në fuqi, nënshkruhet nga presidenti i Kosovës, çka do të bëni në Orllan. Çka bën Ministria në Orllan, ose çka bën, shembull ta marrim, në Reçan, ose në Shaptej, ose në Kaçanik. Çka bën Ministria, qysh i gjobitë ata njerëz që janë duke e thyer ligjin. Evidente, menjëherë! Në momentin që nënshkruhet ky ligj, e thyejnë ligjin, ata njerëz. Domethënë, cili është veprimi i shtetit në atë rast? Çka bëjmë na? Çka bën shteti në atë rast?

Po, pak edhe më shumë se kaq, ka të bëjë me nenin 72. Tash në nenin 72, thotë kështu: “Leja ujqore lëshohet për shkarkim të ujërave të ndotura, eksploitim të rërës, zhavorrit, gurëve, argjilës” e tjerë, e tjerë. Do të thotë, një nen thotë që ndalohej, neni tjetër tregon provizion ligjor se qysh të bëhet ajo punë. Domethënë, ose ndalohej, ose nuk ndalohej, por nuk mundet në të njëjtën ligj të ketë dy provizione, njëri thotë ndalohej – taksativisht një fjalë e keni: ndalohej, ndërsa neni tjetër e tregon mundësinë se si të bëhet ajo që e ndalon një nen paraprak. Domethënë, është diçka problematike.

Prapë te këto dy nene, shembull të marrim, është një shprehje “ujërrjedha”, e cila nuk shpjegohet te definicionet dhe kjo është pyetje e imja për ministrin: tregona, çka janë ujërrjedhat, për shkak se nuk ekziston te definicionet kjo fjalë. Nuk e dimë ne çka janë ujërrjedhat, a janë lumenj, a janë kanale të ujitjes, a çka janë, apo janë të dyja bashkë. Realisht, mund të ndodhë që dikush edhe e di, po nëse nuk ekziston te definicionet, deputetët e kanë problem ta kuptojnë se çka po mendon hartuesi i ligjit me fjalën “ujërrjedhat”.

Dhe, në fund të fundit, po dal edhe te monitorimi, edhe një fjalë tjetër “shpjegimet e plota”, do të thotë “monitorimi i plotave”, prapë ministri duhet të na tregojë çka janë plotat për deputetë, për shkak se nuk ekziston kurrkund te definicionet dhe përdoret.

Dhe, në fund, po kaloj te gjrobat. Është një fenomen i gjobave në Kosovë që me siguri shumica e deputetëve e kanë vërejtur, po i bie shkurt, është fenomeni i rripit të sigurisë, i them unë. Fenomeni i rripit të sigurisë, domethënë, që për një dënim mandator gjrobat janë, shembull ta marrim, sa 20 herë paga e policit dhe ata policë hezitojnë të na dënojnë në trafik për shkak se është gjoba shumë e madhe! Dhe çka ndodh? Nuk na dënojnë. Bile-bile, ka gjoba në trafik që janë sa gjysma e rrogës së policit. Atëherë, ndodhin dy ose tri fenomene aty. E para, është që policit i dhimbset dikush ta dënojë me gjysmën e rrogës. Në rastin tjetër, ka mundësi për t’u marrë vesh, se kur dënimi është shumë i madh, atëherë është lehtë për t’u marrë vesh për një shumë pak më të vogël. Nuk po aludoj në diçka, po prapë në aspektin struktural po flas për vendimet të cilat i marrim ne dhe qysh implementohet.

Për derisa te ky farë sindromi i rripit të sigurisë të jetë gjoba 10 euro, po ju garantoj që policët i dënojnë shumë më lehtë njerëzit në trafik dhe dikujt mund t’i duket dënimi i ulët. Ama, paramendoni, nëse ju dënojnë nga 3-4 herë nga 10 euro dhe të shkonin në stacion të policisë për ta marrë lejen e qarkullimit ose patent-shoferit...

Do të thotë, dola pak vetëm sa për ta shpjeguar kontekstin. Gjrobat janë tepër të mëdha për biznesin që bëhet në Kosovë. Gjrobat janë tepër të mëdha për kushtet në të cilat operojnë operatorët dhe të gjithë tjerët dhe problemi im është jo se më dhimbset ata që e shkatërrojnë mjedisin, por e kam problemin e implementimit të ligjit. A ka për t’u implementuar ligji nëse ka gjobë 100.000 euro për një operator? Cila është mundësia për t’u marrë vesh operatori me inspektorin, kur gjoba është 100.000 euro? Është tepër e madhe.

Gjoba, edhe nëse kishte për të qenë 10.000 në vend të 100.000, është gjobë dhe e parandalon operatorin për të kryer të njëjtën punë. Por, gjoba 100.000 euro për kushte të Kosovës, për këtë çka po e bëjmë ne, e rritë atë farë hapësirën në mes implementimit të ligjit dhe të marrëveshjes, domethënë mundësinë e marrëveshjes e bën tepër të madhe.

Mendoj se këto elemente duhet të shikohen në ligj. Përndryshe, është një ligj i mirë, një ligj shumë voluminoz, një ligj i vlefshëm për Kosovën, ligj që i duhet Kosovës. Mendoj, prapë kur e hartojmë, Kosova duhet të shkojë kah sofistikimi, ministrinë tona të shkojnë kah sofistikimi, këto elemente,

gjithë këtë punë që e kanë bërë stafi i ministrisë dhe me pak më tepër punë kanë mund ta sjellin një ligj i cili do të ishte edhe më i mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gjini! Në emër të AKR-së do ta marrë fjalën zoti Haset Cakolli.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për ujërat e Kosovës është i nevojshëm për faktin se Ligji ekzistues për ujërat e Kosovës numër 2004/24 është dashur të përafrohet dhe adaptohet me direktivat e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës dhe për këto arsye Ligji ekzistues për ujërat e Kosovës ka pësuar një ndryshim mbi 50% dhe do të thotë është përgatitur ligji i ri.

Projektligji për ujërat e Kosovës, të cilin po e debatojmë sot, ka gjithsej 14 kapituj, por në kapitullin e dytë i përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve për administrimin e ujërave në nivelin qendror dhe atë lokal dhe, do të thotë, në 12 dhe 13 i përshkruan kompetencat e këtyre dy niveleve. Ndërsa, në memorandumun shpjegues thotë se kompetencat e këtyre niveleve lokal dhe atij qendror janë të përshkruara në nenin 7, 8 dhe 9, që do të thotë nuk përkohen në mes veti.

Kapitulli IX - Mbrojtja e ujërave, e përcaktuar me nenin 58 deri në nenin 68, i përcakton kompetencat dhe ne mendojmë se këto nene nuk i adresojnë shumë çështje dhe vërejte konkrete. Prandaj, kemi edhe disa vërejtje të përgjithshme në projektligj, por ne si Grup Parlamentar i Aleancës Kosova e Re i japim mbështetje në parim, ndërsa kontributin tonë përmes anëtarëve tanë do ta japim në komisionet funksionale gjatë shqyrtimit të mëtutjeshëm të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit shumë, zoti Cakolli. Në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, fjalën e merr zoti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e diskutojmë një Projektligj jashtëzakonisht të rëndësishëm që rregullon një fushë e cila këto 11 vite në liri nuk ka mund të menaxhohet, të administrohet, po as të hartohen plane të rrafshit nacional për menaxhimin adekuat të resurseve ujore, që Republika e Kosovës fatmirësisht i ka të bollshme.

Lidhja Demokratike e Dardanisë do ta mbështesë këtë projektligj, pra Ligjin për ujërat e Kosovës, sepse qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme, në radhë të parë për shëndetin publik të qytetarëve të vendit tonë, për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin ekonomiko-social të Republikës së Kosovës.

Sigurisht se ky ligj parasheh edhe themelimin e institucioneve relevante, qoftë të nivelit nacional, të nivelit regjional apo edhe të nivelit komunal. Është me rëndësi që Këshilli Kombëtar i Ujërave, që ka qenë një nocion jo shumë adekuat dhe nuk është funksionalizuar, edhe pse ishte votuar më herët në Parlamentin e Republikës së Kosovës, tani në këtë ligj do të projektohet si Këshill Ndërmintor i Ujërave, i cili përfshin ministri relevante. Nuk mund t'i adresohen kompetencat dhe përgjegjësitë vetëm Ministrisë së Mjedisit, kur ka të bëjë me shëndetin e popullatës, është Ministria e Shëndetësisë, kur ka të bëjë me projektet e energjetikës dhe të hidrocentraleve tjera, është Ministria e Energjetikës, Ministria e Transportit, Tregti, Industri e të tjera. Do të thotë, përfshin një spektër më të gjerë të ministrive të linjës, si nivel qendror i ekzekutivit.

Instituti për Ujëra, gjithashtu është e nevojshme që resurse ujore ta kenë një institucion shkencor të thirrur, i cili në mënyrë kompetente profesionale do të adresojë, do të ndihmojë në hartimin e strategjive shtetërore, master-planeve, për një menaxhim dhe administrim të mirë të resurseve ujore të vendit tonë. Pastaj, edhe menaxhmenti i pellgjeve lumore, sepse Kosova dihet, është ndarë në pesë pellgje lumore, që përfshin disa zona të Kosovës dhe dua të besoj që edhe me përcaktimin në disa nene për monitorimin e zbatimit të këtij ligji, po edhe për inspektimin se si respektohen nenet e caktuara që kanë rëndësi për rregullimin dhe administrimin më të mirë të menaxhimit të ujërave, besoj që edhe komunat do ta kenë rolin e vet përmes inspektorëve të tyre.

Ky projektligj, gjithashtu, ka për qëllim që të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, prej tejshfrytëzimit dhe keqpërdorimit, që jemi dëshmitarë që ky tejshfrytëzim, ndotje e pakontrolluar dhe keqpërdorim ndodh çdo ditë në Kosovë, madje edhe me liqenet natyrore dhe ato të akumuluar apo edhe trupat tjerë ujorë, nga të cilët qytetarët e vendit tonë furnizohen me ujë për pije apo i shfrytëzojnë edhe për amvisëri.

Gjithashtu, ky projektligj ka për qëllim të përcaktojë kornizën institucionale për administrimin e resurseve ujore.

Është një ligj voluminoz, i cili nuk është në harmoni të plotë me *acquis communautaire* dhe direktivat e BE-së, në veçanti me Direktivën 200/60, mirëpo në masë të madhe është i përafëruar. Gjithashtu, nga këta 15 kapituj dhe 113 nene të këtij projektligji, besoj se Ministria do të ketë punë në nxjerrjen e udhëzimeve administrative, sepse është një spektër i gjerë dhe vërtet në afatin brenda 6 muaj deri në 12 muaj, por unë mendoj që duhet t'i jepet kohë Ministrisë që për strategjitë nacionale, strategjinë shtetërore për ujërat, në Direktivat e BE-së këto strategji nacionale janë në kohëzgjatje për 9 deri 13 vite, me mundësi të rishikimit çdo 5 vjet. Do të thotë, Ministria si institucion kompetent nacional i shtetit i merr masat e nevojshme, bën rishikimin e hapave që i ka marrë në kohëzgjatje prej 5 viteve, andaj edhe Këshilli Ndërmintor i Ujërave, edhe Instituti i Ujërave, menaxhmentet e pellgjeve lumore, por edhe departamentet konkrete dhe inspeksionet edhe të nivelit komunal mund të japin një kontribut të jashtëzakonshëm që njëherë e përgjithmonë këto resurse natyrore, që i kemi me bollëk në Kosovë dhe kemi probleme evidente, qoftë të furnizimit me ujë, qoftë për ujëra industriale e tjera, që kanë impakte direkte në zhvillimin ekonomik, të menaxhohen mirë qoftë në sektorin e industrisë, të bujqësisë, të turizmit e të tjera.

Lidhja Demokratike e Dardanisë e mbështet, në parim, këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim edhe në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rugova! Në emër të Grupit “7+”, e ka fjalën Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, gospodine predsjedavajući!

Evo, da pozdravim malobrojne ministre i zamenika premijera i kolege!

Ja delim mišljenje mojih prethodnih govornika i kolega da je ovo zakon koji reguliše jednu vrlo specifičnu materiju, a to je Zakon o vodama Kosova.

Svima nama je poznata činjenica da je Kosovo siromašna vodama, samim tim i pijaćom vodom. Ne znam da li se neko bavio fenomenom koliko se vode kupuje na Kosovu. Ovde niko od kolega nije pomenuo, pogledajte samo velike trgovačke prodajne organizacije koliko se vode prodaje i da je ta voda mahom ili 90% iz uvoza. Mislim da je to jedan fenomen kome mi nismo posvetili dovoljno pažnje, ali se niko ne bavi obaveštenjem građana ili obaveštavanjem građana kada se negde hlorige voda, nakon toga da mogu da je koriste recimo i za spremanje, odnosno za piće. Niko se time i ne bavi.

Ja se slažem da je zakon vrlo obiman, što su i kolege rekle, i da on u svom memorandumu pokušava da pojasni da je u skladu koliko-toliko sa evropskim zakonodavstvom, ali na nekim mestima se provlači i mišljenje da nije potpuno u skladu, što je i kolega Rugova napomenuo.

Međutim, gospodo, niko ovde nije govorio o tome da se voda za piće, odnosno vode koje se upotrebljavaju na selu, maltene su iste te količine s obzirom na naseljenost naše države, ne bavi time da se ogromna količina troši na selu, po gotovu sa urbanizacijom sela, po gotovu sa razvojem države i tako dalje, a da se niko ne zapita, recimo, da su mnogi vodovodi čak privatni, čak nelegalni, potom da nisu regulisani mernim instrumentima i da nisu pod kompetencijama kontrole gradskih preduzeća.

Dalje, vrlo je poznata činjenica da gradske firme, hidro-regioni i tako dalje nisu u dobrim odnosima sa samom opštinom. Dakle, problematika je veoma, veoma složena i mi ćemo, normalno, mi smo prinudjeni da ovaj zakon što reče neko, gospodin Gjini, mi smo prinudjeni da ovaj zakon prihvatimo, jer boljeg i drugog nemamo, ali je izuzetno veliki posao pred komisijama koje treba da ga dorade.

Ako uzmete sadržajno, videćete, ima strahovito mnogo grešaka, nelogičnosti, termina koji se upotrebljavaju za iste stvari, tako da je pred nama poprilično veliki zadatak kako da ovaj zakon načinimo efikasnim. Nigde se ne predviđaju precizno kaznene mere za zagađivanje voda. Nigde se ne predviđaju mere s obzirom da voda teče, jel da, odozgo pa na niže, to znamo taj princip spojenih sudova i tako dalje, kako regulisati kada niži delovi naselja uvek je imaju a viši delovi naselja, gradova i tako dalje je nemaju. Mislim, zaista je ovo vrlo složena problematika.

Ja ću samo pomenuti jedan fenomen gde se pominju, recimo u poglavlju III, državni savet, potom državni odbor, potom među-ministarski odbor, kako je sam ministar rekao. Uvek se radi o istom telu, a u stvari spominju se različiti termini. Dakle, ne znam kako je na ostalim jezicima, ali je činjenica da ima strahovito mnogo nejasnoća kada se, recito, koristi termin “demoliranje” ili “demontriranje”, ili kada je “ispuštanje voda”, kaže “izručivanje otpadnih voda”. Mislim, to su takve neke nelogičnosti, koje jednostavno... Ili kaže, šta ja znam, “izručivanje voda građanima”, te “objektivi”, te... Vidi se da lutamo u terminima kako da to regulišemo. Ja bih predložio u ime naše Parlamentarne grupe da se malo više vodi računa o tim mernim jedinicama, o ingerencijama ministarstva, potom hidro-regiona, o prelasku pod kontrolu seoskih vodovoda, o higijeni, jer je voda izvor raznih zagađenja i tako dalje, i tako dalje. Ja takođe nisam za ovu oblast stručan, ali je činjenica da nam nedostaju stručnjaci i da zakon nije mogao da predvidi sve ovo što je trebalo da se predvidi, možda trebamo malo i tuđa iskustva da koristimo malo više, da ne otkrivamo mi i vrugu, ako je otkrio još Arhimed. Evo, mi ga u principu, dakle, podržavamo ali još jednom upozoravamo nadležne da se povede računa o tome da on dobija kakvu-takvu neku normalnu pravnu regulativu. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Murati! Në emër të Grupit SLS, zoti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Hvala, gospodine predsedavajući!

Dame i gospodo,

SLS je razmatrao ovaj nacrt zakona i došao do stanovišta da postoje neke nejasnoće, kao što je gospodin Džezair napomenuo i mi se s njim apsolutno slažemo. Međutim, kod nas je došlo do toga da ćemo dati neke preporuke, odnosno definicije koje nisu u definicijama u članu 3. predviđene, a zatim i predložili bi da u celom tekstu tog nacrta zakona odnosno budućeg zakona budu predviđeni.

Recimo, nigde ne postoji, nisu definisani zaštićene oblasti, koje su to zaštićene oblasti, zone, sanitarna zaštita izvorišta, zatim to su područja namenjena za zahvatanje vode za ljudsku potrošnju i tako dalje, i tako dalje. Zatim, nije predviđeno vodno zemljište, tekućih voda, stajaćih voda, zatim

napuštenih korita i pešćanih sprudova gde voda povremeno dolazi. Takođe, nije predviđeno priobalno zemljište, širina pojasa. Ne postoji definicija korišćenja vodnog zemljišta, a tu podrazumevamo izgradnju vodnih objekata, održavanje korita i vodnih objekata i tako dalje. Zatim, nije predviđeno ili nisu određene granice vodnog zemljišta i samim tim i upisivanje tih granica u evidencije nepokretnosti. Ne postoji definicija, samim tim i u celom tekstu, šta su to vodni objekti, odnosno nije precizirano da su to građevinski objekti za uređenje vodotoka, za zaštitu od poplava i erozija, za korišćenje voda, za skupljanje i odvođenje i prečišćavanje otpadnih voda. Znači, to je veoma potrebno. Korišćenje vode za navodnjavanje, precizirati to mnogo bolje, za plovidbe, za uzgoj ribe, za sport, rekreaciju, turizam. Zatim, definisati eksploataciju rečnih nanosa. Precizirati zatim korišćenje vode za piće, napajanje stoke u domaćinstvu, sanitarno - higijenske potrebe, rekreaciju. Zatim, uključivanje, gašenje požara, plovidbe, kupanje i tako dalje.

Posebna pažnja bi trebala da se odnosi na zaštitu od zagađivanja voda, to je rekao i Džezair. Zatim, zaštita od poplava nije predviđena. Tu se podrazumevaju i mere i radovi, zatim odbrana od poplave, redovna i vanredna, da postoji zaštita od erozije i regulisanje bujica, ali nikako od poplava, poplave su moguće.

Smatramo da član 78. ne bi trebao da postoji. Znači o koncesijama bi trebao da se bavi Zakon o koncesijama a ne da ga uvrstimo u ovaj zakon koji je suštinske prirode.

Takođe bi trebao predvideti nadoknadu za korišćenje vodnog dobra, a to su znači korišćenje vode i vodnog zemljišta. Ko su to obveznici plaćanja, izuzeće od plaćanja, cene, zatim nadoknade za ispuštanje voda i tako dalje. Znači, to su neki naši predlozi i ovo je bitno, takođe i i Džezair je nešto o tome rekao što se tiče sela, jer je tamo ipak haotično stanje. Mi bi jedno posebno poglavlje u tom pogledu predvideli i predložili, pod nazivom: Zabrane, ograničenja prava i obaveza vlasnika i korisnika vodnog zemljišta i vodnih objekata, a ono bi se odnosilo na radnje trpljenja, a to su prolazi vodovoda i odvodnih mreža, koji nisu regulisani na seoskom području, zatim utvrđivanje prava službenosti i recimo jedno od bolnih pitanja su priključenja na javni vodovod u seoskom naselju.

Osim ovoga što smo naveli, mi ćemo naravno u radu parlamentarnih komisija dati svoj doprinos na poboljšanju teksta ovog nacrt zakona. U principu i u načelu mi ćemo podržati ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zotni Halili! Dhe, për Grupin Parlamentar për Integrim e ka fjalën zoti Branislav Gërbiq.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem se, predsedavajući!

Uvaženi ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Pred nama je jedan zakon koji sigurno ima jednu stratešku važnost, a to je usvajanje Zakona o vodama, kao jedan od strategijskog izvora života i sigurno da je ovaj zakon jako bitan i za normalno funkcionisanje jednog društva. U smislu ovog zakona, možemo da kažemo da kao Poslanička grupa prihvat ćemo nacrt ovog zakona, ali ćemo kroz zakonodavne komisije dati primedbe i amandmane jer smatramo da su suviše formalno navedene neke granice između državnog i opštinskog interesa, suviše su formalno date kaznene odredbe, tako da tu, s obzirom da znamo da smo i ranije imali zakone o vodama i kako smo ih poštovali, ovo je jako osetljiva materija, jako zloupotrebljiva materija kako u privatnom, tako i u društvenom smislu i sigurno da je ovde jako bitno definisati granice onoga što može da se radi sa vodom i šta ne sme da se radi sa vodom. S obzirom da su zloupotrebe jako moguće, ovde je vrlo važno da se u okviru ovog zakona sprovedu i diskretno stvore znači uslovi da se tačno i u okviru kaznenih odredbi dovedu ljudi u situaciji da mogu da tumače ono što su radili

pozitivno i šta su radili negativno, te u tom smislu, da ne bi smo dovodili narod u neki smisao mogućeg ili nemogućeg, sigurno da je ovde potrebno još dosta stvari doraditi i mi ćemo u suštini podržati ovaj zakon, ali ćemo kroz amandmane dati neka svoja razmišljanja. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gërbiq! Tani e kanë radhën edhe tri deputetete, zonjat që janë paraqitur për fjalë, por po ju paralajmëroj që në fund të shterimit të listës, unë do t'i konsultoj shefat e grupeve parlamentare a do të vazhdojmë, sepse edhe katër pika tjera i kemi në rend të ditës për sonte, apo do t'i lëmë për nesër. Le të jetë temë meditimi që pas këtyre tri zonjave t'ju pyes pastaj. Dhe, radha e zonjave është kështu: zonja Luljeta Shehu, Nurishahe Hulaj dhe Gjylnaze Syla. Luljeta Shehu e ka fjalën.

LULJETA SHEHU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Qytetet e Kosovës në përgjithësi kanë probleme të konsiderueshme me ujë, prandaj nevojitet të ngriten edhe disa liqene artificiale në pjesët periferike të fushave në viset kodrinore, malore dhe për ngritjen e tyre nevojiten sasi të mëdha të mjeteve materiale. Të drejtën ujore mund ta shfrytëzojnë të gjithë personat fizikë dhe juridikë, të brendshëm ose të jashtëm, në pajtim me ligjin.

Ndotësit kryesorë të ujërave sipërfaqësorë janë vendbanimet, zonat urbane dhe rurale dhe pjesët industriale të zonave urbane. Ujërat e zeza dhe ato industriale shkaktohen pa kontroll dhe pa trajtim paraprak në lumenj, duke shkaktuar kështu ndotjen e ujërave me materiale organike dhe mikrobiologjike.

Niveli i ulët i zhvillimit të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit të ujërave të zeza, ndotja e lumenjve nga ujërat e zeza për arsye të mosekzistencës së implementimeve, mungesa e akumulacioneve ujore, niveli i ulët i zhvillimit të sistemeve të ujitjes dhe niveli i ulët i rregullimit të shtretërve të lumenjve janë probleme shqetësuese për shoqërinë tonë.

Neni 52 bën fjalë për mbrojtjen e zonave erozive, të cilat u shkaktuan nga nxjerrja e dheut, rërës, zhavorrit, gurit, prerja e pakontrolluar e drurit e tjerë. Është mirë që me këtë ligj janë përcaktuar procedurat, kriteret dhe mënyrat me të cilat organet kompetente do të parandalojnë këto dukuri negative. Me këtë ligj është e rregulluar çështja e përcaktimit të zonave të mbrojtura ujore, me të cilat garantohet uji për pije, uji mineral termal e tjerë dhe këtë punë do ta bëjë Ministria me akt nënligjor në bashkëpunim me autoritetin kompetent për shëndetësi.

Ligjin që ne si Grup parlamentar i LDK-së e mbështesim, në parim, do ta begatojmë edhe përmes angazhimit të mëtejshëm përmes komisioneve funksionale gjegjëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Shehu. E ka fjalën zonja Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Ministra të nderuar dhe deputetë të respektuar,

Unë do t'i paraqes disa çështje të rëndësishme për Projektligjin për ujërat, sepse ujërat për vendin tonë janë resurs natyror shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e shëndetit publik të popullatës.

Në çështjet që do të përqendrohem, janë së pari çështjet e lidhura me Memorandumin shpjegues për Projektligjin për ujërat. Mendoj se në Memorandumin shpjegues, në pikën 4, pra arsyetimi për Projektligjin, është e domosdoshme që të futen të dhëna konkrete për disa indikatorë për ujërat në

vendin tonë, të cilat të dhëna nuk janë cekur në këtë memorandum shpjegues, por janë cekur të dhënat lidhur me direktivat dhe lidhur me rregulloret e UNMIK-ut, për ligjin që ka qenë më parë. Prandaj, kanë qenë të rëndësishme të dhënat dhe indikatorët e ujërave të vendit tonë të paraqiten në memorandum shpjegues, respektivisht në pikën 4 për arsyetimin e Projektligjit.

E para, e them për ujërat sipërfaqësore, sepse janë indikatorë shumë të rëndësishëm natyror, dhe për ujërat nëntokësore. Për ujërat sipërfaqësore të dhënat tregojnë se rreth 55% e ujit që merret nga mjedisi natyral vijnë nga burimet sipërfaqësore, ku janë identifikuar rreze serioze potenciale në 4 prej 5 rezervuarve që mbledhin këto ujëra sipërfaqësore. Prandaj, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor gjatë punës që ka bërë me grupet punuese për këtë projektligj ka qenë dashur që të merren të dhënat dhe të cekën cilat janë ata rezervuarë që kanë rreze potenciale.

E dyta, që është për arsyetimin e Projektligjit, do të ishte gjithashtu për indikatorët e ujërave nëntokësore dhe për këtë theksoj se 22 nga 29 burime nëntokësore janë raportuar se janë në rreze nga ndotësit potencialë. Shumica e këtyre burimeve të ujërave nuk trajtohen para se të futen në sistemin e furnizimit, por vetëm dozohen me klor. Prandaj, kontaminimi me kemikalie apo organike, nuk do të parandalohej nga klorimi i ujit.

Gjithashtu, një indikator tjetër i rëndësishëm që do të duhej të ishte në memorandum shpjegues është se në Kosovë ekzistojnë 12 fabrika të përpunimit të ujit, të cilat nuk kanë ndonjë standard konsistent të aplikueshëm.

Një vërejtje tjetër e kam në nenin 32 të Projektligjit. Në këtë nen, të shtohet një paragraf tjetër i ri, ku thuhet: “strategjia shtetërore për ujërat hartohet në baza të studimit të fizibilitetit për ujërat”. Kjo çështje nuk është cekur në këtë çështje të Projektligjit, prandaj duhet të shtohet ky paragraf.

Një vërejtje tjetër e kam në neni 35 të Projektligjit, pra programi i masave, të cilat masa janë shumë të rëndësishme për menaxhimin e ujit dhe parandalimin e shumë sëmundjeve ngjitëse dhe për mbrojtjen e shëndetit publik të popullatës. Në këtë nen të shtohet një paragraf shtesë, ku thuhet: “të bëhet testimi i ujërave para se të futen në sistemin e furnizimit për prezencën e kemikalieve”, pra është ky një kriter që e përcakton edhe Direktiva kornizë për ujërat 2000/60 si parim i përkujdesjes, parandalimit dhe pengimit të ndotjes. Prandaj, ne nuk e kemi këtë kriter ende për testimin e prezencës së kemikalieve të ujërave në Kosovë.

Prandaj, ne e mbështesim, në parim, këtë projektligj dhe unë do të jap kontributin tim ndoshta edhe me ndonjë amendament që do t’ia dërgoj komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Hulaj. Dhe, natyrisht, edhe Gjylnaze Sylja e ka fjalën tani, pastaj zotëri Mahir Yagcilar është paraqitur dhe i takon fjala në fund të debatit.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Menaxhimi dhe administrimi i sektorit të ujit është më se i rëndësishëm, sidomos duke marrë parasysh se uji është faktor i jetës, është faktor ekologjik, ekonomik dhe shëndetësor. Megjithatë, ky sektor është rregulluar përmes një ligji, që është Ligji 2004/24 – në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/41.

Nëse i kujtohet ministrit, unë vitin e kaluar e pata pyetur, sidomos për funksionalizimin e Këshillit të Kosovës për Ujërat, dhe së paku një mangësi të ligjit aktual e di që ky nuk është funksionalizuar asnjëherë. Mirëpo, jam e bindur se së pari është dashur të bëhet një analizë e ligjit aktual, cilat janë mangësitë e tij dhe cilat dispozita ligjore nuk po e përmbushin qëllimin për çka është bërë ligji. Pas kësaj, konsideroj se është dashur, z. ministër, të zhvillohen politikat e mirëfillta të menaxhimit dhe

administrimit të ujit dhe atë në pajtim me konceptet moderne të menaxhimit dhe administrimit të integruar. Edhe në botën globale kanë të njëjtat vështirësi. Për të dëshmuar rëndësinë e administrimit dhe menaxhimit të mirë të resurseve ujore, po përmend një fakt me rëndësi, se në të ardhmen parashihet që luftërat të zhvillohen pikërisht për shkak të mungesës së ujit.

Kosova ballafaqohet me problemet e shumta sa i përket ujit dhe atë sidomos me mungesën e vetë resurseve të ujit, pastaj të cilësisë së ujit të pijshëm, por edhe të një faktori shumë të rëndësishëm – dëmtimit të vazhdueshëm të shtratit të lumenjve.

Ky ligj, a i bën zgjidhjet adekuate lidhur me këto probleme që ka Kosova? Po i shtrojë disa nga dilemat dhe sfidat.

E para, që e konsideroj është sfidë me rëndësi për zbatimin e ligjit, është se rreziqet financiare të cilat janë shtruar në këtë projektligj, nuk bindin shumë se jeni kujdesur që të ketë financa të vazhdueshme ashtu që ligji të gjejë zbatimin. Dhe, po përmendi disa nga këto, siç janë mekanizmat e rinj, të cilat do të krijohen me këtë projektligj. Në këtë kontekst po përmend formimin e Këshillit Ndërmnistror të Ujërave, apo të 5 njësive të pëllgjeve apo të fondit, apo edhe programet që janë të parapara për ujin. Megjithatë, janë disa numra të cilët në vetë memorandumin shpjegues janë dhënë, ku thuhet se përafërsisht diku mbi 433.000 euro nuk dihet se si ose ku do të merren, meqenëse nuk janë paraparë as me buxhet, as me Kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Një sqarim kisha dashur nga ju, z. Ministër. Meqenëse keni paraparë që të hyrat e fondit të derdhen në vetë fondin dhe jo në buxhetin e Kosovës, për të cilin gjë edhe në memorandumin shpjegues të projektligjit, thuhet se kjo është kundër Ligjit për menaxhimin e financave publike, neni 2, atëherë shpjegoni pse është bërë një zgjidhje e tillë ligjore, meqenëse është në kundërshtim me ligjin që e përmenda.

Në fund, në qoftë se një ndër arsytet për hartimin e këtij projektligji kanë qenë afrimi me ligjet ose legjislacionin e Bashkimit Evropian, unë mund të them se atëherë është dashur ta ndani në atë mënyrë që të zhvillojë politika për ujërat, do të thotë të jetë jo vetëm një ligj i tillë voluminoz, por të zhvillojë disa ligje konform direktivave të BE-së, sidomos duke marrë parasysh se administrimi dhe menaxhimi i ujit me Direktivat e BE-së është shumë më gjithëpërfshirës dhe po i përmendi vetëm disa: Direktiva për kualitetin e ujit; si ajo e sigurimit të kualitetit minimal të ujit; pastaj kualitetit të ujit për larje; janë edhe direktivat e tjera për pastrimin e ujërave të zeza; nitratoeve e tjera.

Konsideroj se është dashur në bazë të zhvillimit të këtyre politikave, pastaj të bëni më shumë ligje dhe jo vetëm një ligj, për atë edhe nuk mundet, natyrisht, të përfshihet në mënyrë adekuate çështja e administrimit dhe menaxhimit të ujit.

Përkundër mangësive të projektligjit, për shkak të nevojave që ka Kosova për rregullimin e këtij sektori, unë në parim e përkrah, por me kërkesën që komisioni funksional të punojë në përmirësimin e tij, ashtu që ky projektligj të arrijë qëllimin e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Sylja! Tani e ka fjalën, i fundit, zoti ministër, Yagcilar.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, kryesues!

Së pari, dëshiroj të falënderoj të gjithë deputetët për përkrahjen, sepse vërtet është një ligj voluminoz, nuk është një ligj perfekt, sepse duhet të përmirësohet dhe për atë qëllim është menduar të formohet Këshilli Kombëtar i Ujërave, sepse nuk është puna vetëm e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, por janë edhe disa ministri tjera dhe disa institute tjera, si Instituti i Shëndetit Publik, por edhe ministrinë

përkatëse. Për atë aspekt është ndoshta edhe ndryshimi më i madh te ligji, sepse ndryshohet prej Këshillit të ujërave në Këshillin Ndërmintor për Ujërat. Por, gjithashtu, në ligj janë risitë se do të krijohet Instituti për Ujëra, por gjithashtu duke menduar të bëhet shmangie prej rreziqeve buxhetore, në ligjin final i cili është tash para jush, nuk ekziston Fondi i ujërave, por mendohet Fondi i ujërave të jetë në kuadër të ligjit të posaçëm, i cili do të jetë ligj i eko-fondit, sepse për këto çështje edhe një herë është tërhequr nga Qeveria, duke pasur parasysh këto rreziqe buxhetore.

Gjithashtu, pse nuk jemi përafuar me direktivat evropiane? Sepse direktivat evropiane kërkojnë për çdo pellg lumor të krijohet një administrim, por prapë për shkak të rreziqeve buxhetore ne jemi duke menduar sipas ligjit të krijojmë dy njësi rajonale për administrimin e ujërave ose administrimin e pellgjeve lumore, kështu që të kemi edhe një administrim, por gjithashtu të mos krijojmë rreziqe buxhetore.

Po ashtu, ne me këtë ligj menduam të bëjmë të gjitha udhëzimet administrative për çështje teknike ose për çështjet detale. Vërtet, ligji ka sigurisht edhe gabime te neni 38 dhe neni 72. Unë, vetë e kam lexuar disa herë ligjin, por prapë duke u bazuar edhe në punët e ekspertëve, prapë kanë ndodhur gabime. Unë besoj se nëpër komisione këto gabime do të evitohen.

Gjithashtu, ekziston problemi pse nuk është 100% me direktivat evropiane. Për fat të keq, në Kosovë tash për tash ekziston vetëm një impiant për trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Skenderajt. Ne nuk mund të shkojmë me standarde evropiane, duke mos pasur edhe impiante për trajtimin e ujërave të zeza, të cilat prapë kanë një kosto të madhe buxhetore.

Sa i përket strategjisë së ujërave, ne jemi në fazën e hartimit me përkrahjen e Bankës Botërore dhe Komisionit Evropian për strategjinë e ujërave, por gjithashtu edhe master-planin e ujërave. Besojmë që këtë vit dhe vitin e ardhshëm do të përfundojmë, duke marrë parasysh edhe përkrahjen nga Komisioni Evropian ose me projektet IPA.

Sa i përket disa terminologjive jo logjike në gjuhën serbe, boshnjake, zotëri Xhezairi nuk është këtu, por ai vetë ka pasur te unë këshilltarin, i cili ka dashtë t'i rregullojë krejt këto çështje, por ndodhën këto çështje... Edhe ministri nuk ka mundësi ta shqyrtojë në çdo gjuhë ligjin dhe të krijuar ose heq gabimet, kështu që, unë besoj se me përkrahjen tuaj do të përmirësohen këto në komisionet parlamentare, edhe ato përkufizimet të cilat mungojnë, por gjithashtu edhe sa i përket gjobave, do të rregullohet në harmoni edhe me ligjet tjera. Edhe një herë, ju falënderoj për përkrahjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim, duke qenë se e kemi numrin e nevojshëm për të krijuar kuorumin dhe ky numër është 66 aktualisht, dhe votojmë tash:

Deklaroj se me 62 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, miratohet në parim ky projektligj.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

Këto komisione duhet që brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë në Kuvend, t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Dhe, tani ka ardhur koha që të zgjidhim dilemën a do të vazhdojmë më tutje, a jo. Edhe katër pika i kemi të rendit të ditës. Është e vërtetë se ministri i Pushtetit Lokal është optimist se nuk do ta zgjasim shumë. Atëherë, përpara!

Pra, pika e tetë e rendit të ditës, është:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës

Edhe ju e dini që me nenin 56 të Rregullores janë përmbushur kushtet, ndërkaq menjëherë po e ftoj dhe unë dhe shkurt e shkurt po i bie, ministrin e Pushtetit Lokal, Sadri Feratin, që në emër të Qeverisë ta prezantojë këtë ligj.

MINISTRI SADRI FERATI: Faleminderit, kryesues!

Prona komunale vërtet është një kohë e gjatë që e sfidon pushtetin lokal në aspektin e menaxhimit, të përdorimit të saj, por edhe këmbimin e pronës për interesa publike. Prandaj, deri më tani kjo çështje është rregulluar me Urdhëresën e UNMIK-ut 2005/13 që është fare e pamjaftueshme dhe është paraparë domosdoja e këtij ligji.

Ligji i ka kaluar të gjitha fazat, prandaj kisha lutur dhe kisha thirrur deputetët që ta votojnë të njëjtin për procedim të mëtejshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Dhe tani, grupet parlamentare. Për PDK-në është paraqitur zoti Hajredin Hyseni.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës rregullon procedura që komunat duhet t'i përmbushin për ta realizuar këtë të drejtë, e cila do të lehtësonte qeverisjen lokale dhe qendrore.

Projektligji qartëson formën, mundësitë dhe kushtet të cilat duhet të përmbushen për t'u realizuar kjo e drejtë, me çka vërtet do të mundësohet që të përmbushen nevojat e qytetarëve.

Për të qenë më efikas dhe i qartë ligji, mendoj se duhet qartësuar procedurat e dhënies komunale në shfrytëzim tek neni 8 apo tek neni 6.1, ku interpretimi i ligjit i lihet Ministrisë, vërtet shumë e panevojshme, sepse në ligj duhet të mbështeten edhe komunat edhe ministria dhe çdo veprim i kundërligjshëm vendimet anulohen, sepse nuk janë të ligjshme çështjet të cilat besoj se do të rregullohen në procesin e mëtejshëm. Andaj, Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah në parim projektligjin.

KRYESUESI: Faleminderit shumë, zoti Hyseni!

Tani e ka fjalën për Lidhjen Demokratike të Kosovës, Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrah këtë ligj, në parim, dhe propozon që të miratohet në lexim të parë, me disa vërejtje të përgjithësuara që i kam përgatitur lidhur me këtë ligj dhe besoj se

nuk do t'ju marr kohë shumë, edhe ashtu profa po më thotë se veç dy minuta i kam në dispozicion për të folur.

Fjala është për nenin 1, që mendoj se duhet të plotësohet dhe të përfshihen edhe “personat juridikë e fizikë”, sepse neni 7 e parasheh se toka e komunës mund t'u jepet në shfrytëzim edhe personave fizikë e juridikë. Kjo është nën një.

Neni 3, te përkufizimet, gjithashtu duhet të përfshihen edhe këto dy kategori: “personat fizikë dhe juridikë”.

Pastaj, neni 6, e ka një kuptim shumë të gjerë dhe duhet të rregullohet, sepse krijon disa dualizma dhe krijon disa dilema gjatë zbatimit të tij.

Neni 7, e thashë, është në kundërshtim me nenin 1, sepse atje thotë se i jepet toka, se këmbëhet me tokën që e menaxhon Agjencioni Kosovar i Pronës, kurse neni 7 lejon mundësinë që toka t'u jepet në shfrytëzim edhe personave fizikë dhe juridikë. Prandaj, këto duhet të harmonizohen në mes veti.

Neni 13, paragrafi 2, thotë në mes tjerash, “në rast se komuna nuk respekton kufizimin e përcaktuar me pikën 1 të këtij neni, apo nëse konstatohet se komuna nuk ka pasur nevojë publike apo ka paraqitur të dhëna të gabueshme me rastin e kërkesës për bartje të paluajtshmërisë, atëherë bordi ka të drejtë që me vendim ta anulojë bartjen e paluajtshmërisë”. Unë mendoj se me vendim nuk mund të anulohet bartja e paluajtshmërisë, por duhet ta anulojë vendimin për bartjen e paluajtshmërisë, sepse vendimi është ai që prodhon efekte juridike, e paluajtshmëria është tjetër gjë, anulimi i bartjes së paluajtshmërisë është tjetër gjë. Meqenëse thotë për paluajtshmërinë, ne kemi një spektër të gjerë të paluajtshmërisë, kemi toka bujqësore, kemi toka urbane, kemi toka pyjore, kemi objekte, kemi banesa, lokale e tjera, e tjera, ndoshta do të duhej edhe të plotësohej në këtë kuptim.

Për të mos e zgjatur më tepër, ju falënderoj për durimin. Po e përsëris, ne si Lidhje Demokratike e Kosovës e përkrahim këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kelmendi, aq më tepër kur jeni përpjekur të mbani premtimin e dhënë, i keni kaluar nja 45%, po sidoqoftë, mirë është.

Për Aleancën e Ardhmërisë së Kosovës, e ka fjalën zonja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj, por i kemi disa vërejtje. Njëra prej tyre është, përkufizimi se çka është prona e komunës. Ky definicion është i mangët. Nevojitet që në mënyrë më precize të definohet se çka është prona e luajtshme dhe e paluajtshme, se kjo është objekt kryesor i shtjellimit të këtij projektligji dhe nëse lihen zbrazëtira, do të ketë edhe më tutje uzurpime të cilat janë bërë në masë të madhe këto 10 vitet e fundit dhe e kanë zvogëluar dukshëm pronën e komunave të Kosovës.

Edhe një vërejtje sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ky ligj nuk ka nevojë të harmonizohet me ligjet e Bashkimit Evropian, sepse çdo shtet e rregullon këtë çështje me nevojat e komunave të tyre.

Në këtë projektligj, në pjesën hyrëse, thuhet se ky projektligj është në përputhje me *acquis communautaire*, gjë që nuk ka pasur nevojë të shkruhet, po jo vetëm me këtë rast, shpesh vërehet tendenca që pa nevojë të keqpërdoret çështja e integriteteve evropiane, e me këtë zhvlerësohet ky proces i rëndësishëm për vendin tonë.

Anëtarët e Grupit Parlamentar do ta japin kontributin e vet në komisionin funksional dhe në komisionet kryesore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Hundozi! Tani për Aleancën Kosova e Re, e ka fjalën zotni Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryesues!

Ministra, të nderuar,

Deputetë të respektuar,

Fillimisht, si vërejtje parimore, a thua është dashur ky dokument ligjor apo jo. Pse? Sepse, prona nga entiteti natyral apo legal apo personi fizik apo juridik, disponohet pa kurrfarë pengese që nga e drejta romake Jus utendiis fondeius, abotendi. Do të thotë, mund ta japë në shfrytëzim, mund ta shfrytëzojë vetë, mund ta këmbëjë, mund ta shesë e tjera. Kjo është në parim, se kjo është tematikë kontraktore, jus dispositivum.

Mirë, tash meqenëse është bërë, Grupi i AKR-së e mbështet. Ka vërejtje, ndër tjera, vetëm dy që janë pak, si të them, më cilësore.

Një, te neni 3, paragrafi i parë, ja se ç’thotë: “Pronë e paluajtshme e komunës” nënkupton pronën e paluajtshme e cila evidencohet në pronësi të komunës, në librat kadastrale. Do të thotë, nuk është definicion adekuat, as i qëndrueshëm dhe nuk po hymë më tutje. Ose, ka shprehje që quhen pleonazma, të panevojshme. Bie fjala, te neni 6. Ja ç’thotë: “Kuvendi i komunës ka të drejtë të japë pronën e paluajtshme publike komunale”. Nuk po hyjmë te shprehjet dhe aty ka shumë kakofoni, “në shfrytëzim afatshkurtër apo afatgjatë”. E tash, në qoftë se mund ta japë në afat të gjatë, nënkuptohet se mund ta japë në afat shkurtër – argumentum ab majori ad minus. Nëse mund ta japë në afatgjatë, bile këtu thotë nga 40 vjet, mund ta japë edhe 30, edhe 20, edhe 15, edhe 10. Tek e fundit, s’ka nevojë të përdoret as afatshkurtër, as afatgjatë, se mund ta japë në shfrytëzim.

Ose, po e zëmë, vërejtje parimore. Te neni 6, paragrafi 5. “Prona e dhënë në shfrytëzim regjistrohet në regjistrat e paluajtshmërive të komunës, sipas nenit 14 paragrafit 3 të Ligjit...”, ligji thirret në ligj. Po, çfarë do të bënim në qoftë se do të pësonte ndryshim, se mund të pësojë ndryshim dhe plotësim Ligji, po e zëmë, për vetëqeverisjen lokale dhe do të zhvendoseshin dispozitat, më pastaj ne do të apelohehim në një dispozitë inadeguete. Prandaj, do të duhej vetëm me “I” të vogël – ligjit. Po, edhe disa të tjera...

Gjithsesi, e mbështesim në parim dhe shpresojmë se do të japim një kontribut modest gjatë përgatitjes së tij për miratim përfundimtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Smaka! Në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, e ka fjalën zonja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet në parim Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, i cili si qëllim ka rregullimin me akt ligjor të mënyrës së dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Gjatë hartimit të tij, është parë se këtë ligj e kanë përcjell disa dobësi e mangësi, mirëpo ato më esenciale dhe për hir të kohës, do të kursehem dhe do të përmend vetëm dy vërejtje, të cilat janë thelbësore, vlerësojmë ne, te kreu III, ku kemi të bëjmë me bartjen e paluajtshmërive në kompetencën

e Agjencionit Kosovar të Privatizimit të komunat për nevoja publike. Domethënë, flitet këtu për shndërrimin e pronave shoqërore, që tashmë i menaxhon AKM-ja, në prona publike për interesa të përgjithshme të komunës, interesa të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve të ndryshme, si të spitaleve, qendrave sportive, terreneve të ndryshme sportive apo edhe shkollave të ndryshme për të cilat ka probleme të theksuara nëpër komuna sepse mungojnë këto prona.

Është neni 10 – kërkesa për bartje të paluajtshmërisë, në mes tjerash, te pika 6, ku thotë: “paluajtshmëritë që përcaktohen nga bordi si esenciale për procesin e privatizimit nuk mund t’i barten komunës. Bordi detyrohet të publikojë listën e paluajtshmërive të vlerësuara si esenciale për privatizimin në secilën komunë”. Dhe, të nderuar, ne mendojmë se ky nen duhet të hiqet fare, të mos ekzistojë dhe duhet të formulohet në favor të komunave. Këtu sikur i është dhënë roli kryesor apo dominant në menaxhimin e pronave të komunës, të pronave shoqërore Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Mirëpo, duhet të kihet parasysh se Agjencioni Kosovar i Privatizimit ka mandatin për t’i privatizuar pronat shoqërore dhe për t’i shndërruar në prona private apo në prona shtetërore ose publike, qysh quhen pronat që duhet të menaxhohen nga institucionet.

Këtu shihet se agjencionit i jepet prioriteti se duhet të hartojë listën e pronave të cilat duhet t’i privatizojë. Mirëpo, mendoj se duhet të jetë roli i komunës, komuna duhet të ketë një listë të prioritetëve të veta dhe brenda territorit të saj t’i shpall interes të përgjithshëm ato prona. Dhe, në bashkëpunim me Agjencionin Kosovar të Privatizimit, ato interesa të përgjithshme mandej t’i shndërrojë dhe vërtet t’i menaxhojë konform ligjit.

Kjo është ndoshta edhe një defekt dhe një arsye që në Ligjin për Prishtinën u cek me mjaft pompozitet apo me të madhe menaxhimi i Palestrës Sportive, që në këtë rast, po ta kishim pasur këtë interes të përgjithshëm, nuk kishim pasur nevojë ta fusim dhe t’i japim prioritet. Ndoshta krejt Ligji për Prishtinën shkoi nën hije të asaj se a duhet Pallati i Rinisë të jetë pronë e komunës apo duhet të jetë pronë.... apo duhet t’i takojë Agjencisë Kosovare të Privatizimit, mandej të përfundojë në duar të personave fizikë apo të interesave të ngushta që dikush ka mbi ato prona.

Prandaj, ne si Lidhje Demokratike e Dardanisë kërkojmë që ky ligj të riformulohet dhe të kalojë në interes të komunave, jo në interes të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, siç edhe është pretenduar këtu brenda ligjit.

Është edhe neni 11, te kompensimi. Domethënë, në mes tjerash përmendet se si komuna duhet t’ia kompensojë për pronën që e merr, duhet ta bëjë kompensimin apo pagesën te Agjencia Kosovare e Privatizimit. Edhe ne këtu shprehim dilemat dhe rezervat tona dhe mendojmë se komuna për interesa publike, nuk themi për ato që do t’i jep mandej në shfrytëzim me qira, sepse ato janë në njëfarë forme që e siguron atë pagesë që e bën. Mirëpo, për ato interesat e përgjithshme që u cekën: ndërtimi i objekteve sportive, ndërtimi i spitaleve, shkollave e tjera, që ka interes komuna dhe qytetari drejtpërdrejt ato prona që i merr komuna për këtë qëllim të mos ketë nevojë të kompensohen apo të paguhën, sepse po merren paratë e qytetarëve dhe po iu jepen një Agjencioni Kosovar të Privatizimit, që thjeshtë 500 milionë të tërë nuk dihet se ku i ka lënë ky agjencion. Duke parë specifikat dhe paratë e qytetarëve me të cilat po menaxhon Agjencioni Kosovar i Privatizimit, pse t’i fusim në rrezik paratë e qytetarëve dhe të komunës. Këtu duhet të shohim edhe arsyeshmërinë e komunave, duhet që komunat në këtë rast të mos kenë nevojë të paguajnë për interesa të përgjithshme, për ato që u cekën më lartë, por të kenë nevojë që me një marrëveshje, qoftë edhe të thjeshtë, ato të vendosin prioritetet e veta dhe të kenë nevojë t’i marrin ato prona.

Këto janë vërejtjet esenciale, duke pas parasysh se ka edhe vërejtje tjera, për hir të kohës dhe se jemi të lodhur, nuk do të bëhem e tepërt për kolegët deputetë, do të kemi mundësinë në komisionin

funksional, po edhe në komisionet tjera që kolegët tanë të japin kontributin për përmirësimin e ligjit. E përkrahim në parim. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče!

Mi ćemo kao Parlamentarna grupa 7+ podržati u načelu ovaj nacrt zakona. Imamo određene primedbe, ali zbog vremena neću govoriti, samo ću pomenuti član 6. gde se davanjem zemljišta posle ispunjavanja kriterijuma određenim zakonom o javnoj nabavci, i posle davanja saglasnosti od strane nadležnog Ministarstva za lokalnu samoupravu, mislim da se ta procedura komplikuje dosta. Posebno će to biti teško za određene slučajeve. Pomenuću samo tri slučaja, to su slučajevi socijalnih kategorija, ljudi koji pripadaju toj kategoriji i ako ova procedura bude išla preko tendera i javnih nabavki, da će biti teško. Druga je za povratnike koji su deportovani i koji nemaju smeštaj i, treće, za stočare koji imaju zahteve za dobijanje i izgradnju štala na nekom zemljištu koje pripada opštini. Mislim da procedura za ove slučajeve treba da bude uprošćena i da se svede na nivou opštine, odnosno gradonačelnika koji bi uz određene druge stvari mogao... Imamo mi pripremljene amandmane pa ćemo predati komisiji. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, deputeti Sllobodan Petroviq e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedniče!

Uvaženi zameniče premijera, ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Gospodine ministre Ferati, želim da vam ispred Poslaničke grupe Samostalne liberalne stranke, pre svega odam jedno priznanje na aktivnostima koje dajete. Ono što sigurno potvrđuje da ste dali sigurno i veliki značaj na izradi, odnosno predlogu ovog zakona, ispred Poslaničkog kluba Samostalne liberalne stranke želim da kažem da mi u načelu ćemo podržati predlog ovog zakona. Svakako da ćemo koristiti pravo da damo doprinos ovom zakonu kroz amandmane koje ćemo dati kroz funkcionalne komisije. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputeti Vlladimir Todoroviq e ka fjalën.

VLADIMIR TODOROVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Da ne bih oduzeo vremena, mi podržavamo u načelu ovaj zakon, a sve druge primedbe koje imamo, daćemo u tim komisijama. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e deputetëve. Fjalën e ka kërkuar deputeti Ismail Kurteshi.

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Menjëherë pas luftës, AKM-ja dhe tani viteve të fundit, AKP-ja, në emër të krijimit të fondeve për zhvillim ekonomik, hapjen e vendeve të reja të punës, plotësimin e standardeve evropiane e të tjera, përveç tjerash, ka privatizuar objekte dhe sipërfaqe të tokave shumë të nevojshme për komunat dhe qytetarët e tyre.

Ndodh shpesh që komunat janë të detyruara të blejnë toka ose prona të tjera, me çmime shumë më të larta se që ato i shet AKP-ja. Për shembull, komuna e Gjilanit, gjatë vitit 2008/2009 për blerjen e 3 trojeve për ndërtimin e 3 shkollave ka paguar rreth 1,5 milion euro e për këtë shumë AKP-ja ka shitur edhe qindra e ndoshta edhe mijëra hektarë tokë.

Prandaj, propozoj që Qeveria e Kosovës të kërkojë nga komunat listat me prona të rëndësisë së veçantë dhe ato prona të barten nga AKP-ja në pronësi të komunave, por natyrisht që komunat duhet ta kenë edhe arsyeshmërinë e nevojshme.

Tani disa vërejtje konkrete për disa nene. Në nenin 6, pika 6, thuhet që “kriteret e përcaktuara në ligj për prokurim publik nuk zbatohen për rastet kur kërkesa për dhënie në shfrytëzim bëhet nga institucionet qendrore të Kosovës, përfaqësitë diplomatike e të tjera”. Mirëpo, në ligj askund nuk shpjegohet se në këto raste cilat janë procedurat për dhënien në shfrytëzim të tokave. Do të thotë, nuk ka asnjë shpjegim, vetëm thuhet që nuk respektohet Ligji për prokurim publik, kurse çka respektohet dhe cilat janë procedurat, nuk ka shpjegim.

Në nenin 8, pika 2, thuhet “Kuvendi i komunës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale merr vendim me shumicën e anëtarëve të kuvendit që janë të pranishëm”. Mendoj se duhet të jetë me: me votat e shumicës së anëtarëve të Kuvendit; dhe jo të pranishëm, por atyre që janë përherë se çështja e dhënies së tokave në shfrytëzim edhe ashtu është një çështje shumë e rëndësishme.

Në nenin 10, pika 1, ku thuhet “Kërkesa për bartjen e paluajtshmërisë, bordi i drejtorëve të Agjencisë vendos për bartjen e paluajtshmërive”, mendoj se duhet të jetë: kuvendi komunal me shumicë votash vendos për bartjen e paluajtshmërisë, kurse në pikën 2 të njëjtit nen, në reshtin e parë, thuhet “komuna përkatëse ia paraqet kërkesën” dhe në vend që t’ia paraqet kërkesën, duhet të jetë: e njofton bordin.

Dhe, po ashtu propozoj që neni 11 të hiqet në tërësi.

Dhe, krejt në fund, kam vërejtur se në këtë ligj nuk parashihen sanksione për rastet kur pronat e komunës jepen në shfrytëzim në kundërshtim me kriteret dhe procedurat e ligjit për prokurim publik dhe raste të tilla ka shumë nëpër komunat tona, kur kryetari i komunës i jep pronat pa kaluar nëpër procedurat që parashihen me ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ardian Gjini e ka kërkuar fjalën. Ndoshta e ke parasysh kohën, Ardian.

ARDIAN GJINI: Absolutisht, shumë shkurt. Faleminderit, zoti kryetar!

Me këtë ligj, në esencë, dy çështje rregullohen pak më ndryshe se sa kanë qenë të rregulluara më përpara dhe mendoj, siç thashë, kur diskutuam për ligjin e kaluar, është mirë për ta fokusuar debatin politik në atë që e bën ligji. Do të thotë, çka ndodhë kur ligji aprovohet dhe hyn në fuqi ndryshe prej asaj që po ndodh sot.

Çështja e parë është se komuna ka të drejtë: “të blejë pronë prej Agjencionit Kosovar të Pronës”, i ka pasur, ka të drejtë dhe që unë realisht personalisht pajtohem. Dhe çështja e dytë është që mundet për ta japë pronën me konsension, në vend të 10 vjetëve në 40 vjet.

Te neni 6, pika 2 dhe 3, më duket u tha më përpara, nuk kanë nevojë të jetë pika 2 dhe 3, se pika 3 nënkupton që mund të jepet edhe për 10 vjet, nëse mundet deri në 40 vjet.

Kjo është një vërejtje që e kam në aspektin politik, pra nuk ka nevojë të jetë.

Dhe, duhet pasur pak më të qartë kur hyn në fuqi ligji, menjëherë apo i kemi disa çështje tjera.

Këto ishin ato që desha t'i them edhe një herë. Debati politik duhet fokusuar me çka ka të bëjë ligji dhe të tregojë se a pajtohemi a jo me atë që ligji e rregullon prej momentit kur hyn në fuqi? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe për kohën! Diskutuesi i fundit, deputeti Fatmir Rexhepi, e ka fjalën. Ju lutem, respektoni kohën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryetar! Por, s'e di a Eqremi i Prizrenit më hoqi prej listës, a çka u bë? Sido që të jetë, s'ka dert, jo. Mirë!

Projektligji i ofruar për shqyrtim lidhur me pronën komunale, rregullat, politikat dhe menaxhimin që ka të bëjë me koncesionimin, shfrytëzimin dhe këmbimin, sigurisht që kryekëput do të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës komunale, është në funksion, sa e përkrahim në parim. Unë po e shfrytëzoj rastin, atë që biseduam edhe në mëngjes, por edhe më herët që sot po theksoj pra nevojën që bashkë me këtë projektligj, kërkesën që të shikohet ajo mundësia e memorandumit, realisht për politikën e Qeverisë, në mes të Qeverisë, asociacionit të komunave, për të gjitha komunat dhe AKP-ës lidhur me pronën që ka të bëjë me tokën nëpër qytete. Nuk është e rastit kjo, nuk ka nevojë komuna të blejë tokën prej AKP-së. Kjo është tokë shoqërore, pronë shoqërore, vetëm për një emër që ndërrohet në pronë të komunës, nuk është ndonjë kiamet i madh, ndonjë zahmet i madh... Prandaj ne jemi ata që e bëjmë ligjin, ka mundësi ta ndryshojmë përmes një memorandumit dhe realisht komuna ta ketë në shfrytëzim atë pjesë sipas specifikave dhe nevojave që mund të plotësohen këto kategori për komuna të caktuara. Prandaj ky memorandum mendoj që duhet të punohet në të njëjtën kohë, në mes të Qeverisë, AKP-së dhe asociacionet të komunave.

Dhe, e fundit, është çështja që po e ripërsëris. Është me të vërtetë sui generis sikur që është puna e Kosovës, edhe puna e Gjilanit. Kërkoj falje, por vërtet është sui generis. Merreni, këqyreni në të gjitha anët. Ndoshta duket e tepërt, por realisht është kështu, kryetar. Asnjë metër katror e tokës nuk i ka mbetur. Besoni, asnjë metër. Është shumë e çuditshme, qysh! Dhe tash është kjo e pakuptimtë. Ka edhe diçka tjetër, që do të thotë është në procedurë e sipër, prandaj po reagojmë dhe mendoj, në qoftë se duam të jemi me dy të mira në vjeshtë, bëjeni memorandumin që e thamë më herët, edhe projektligji le të plotësohet me këto ndryshime, të cilat janë të nevojshme dhe realisht komunat mund të kenë pronë në disponim për zhvillimin e vet, pra s'kemi kurrgjë të veçantë që në nuk mundem ta bëjmë, si politikë, si qeveri, si njerëz që mund të mundësojmë zhvillimin e komunave më mirë. Prandaj, nëse domi të jemi me dy të mira në vjeshtë, unë po them për dy muaj ka mundësi edhe memorandumit edhe projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Ne, atëherë po e inkurajojmë ministrin që ta bëjë memorandumin. Mendoj se diskutues më nuk ka. Tani po hyjmë në procedurën e votimit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Në sallë kemi 69 deputetë, kështu që mund të votojmë dhe votojmë tash:

Me 66 vota "për", 1 "kundër", 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit, t'i paraqesin raporte me rekomandime, ose amendamente.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit? Nuk paraqitet!

Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 562 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 6 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 61 votë “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 61 votë “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 61 votë “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti i fundit, 15.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 15.

Tani votojmë ligjin në tërësi. Votojmë tash:

Konstatoj se me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e 10-të të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Kalojmë menjëherë në procedurën e votimit. A jeni dakord? Atëherë votojmë, për amendamentin e parë.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2, i Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 2, i komisionit funksional.

Rregullorja thotë duhet ta votojmë edhe amendamentin e deputetit Riza Smaka. Duhet të deklarohe mi!

Votojmë për amendamentin e deputetit Riza Smaka dhe votojmë tash:

Me 12 vota “për”, 31 “kundër”, 9 abstenime, nuk miratohet amendamenti.

Tash votojmë Amendamentin 3.

Votojmë tash:

Me 51 votë “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Me 50 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7, i Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 51 vota “për”, 2 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 7 i Komisionit funksional.

Amendamenti b/, është i deputetit Riza Smaka.

Votojmë tash:

Me 24 vota “për”, 22 “kundër”, 5 abstenime, nuk miratohet, pasi që amendamenti i mëparshëm ka marrë më shumë vota.

Jo, tash jemi te amendamenti 8. A e ke fjalën për 8-shin? Jo, ai shkoi!

Tash votojmë amendamenti 8.

Regjia! Votojmë tash amendamentin 8:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Në sallë janë 67 deputetë.

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Mirë, s’prish punë! Me 51 votë “për”, 4 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, asnjë kundër, 3 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Ndërsa amendamenti 21, është i deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 37 vota “për”, 18 “kundër”, 4 abstenime miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22, i deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 27 vota “për”, 25 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, 3 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24 i ka dy propozime. I pari është i Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 4 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 24/a.

Tani votojmë amendamentin 24/b të deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Për variantin 24/b kanë votuar 21 deputetë “për”, 28 “kundër” dhe 10 abstenime, nuk miratohet.

(Reagim)

Po është votuar dhe ju po votoni për ta mbaruar qejfin. Ju nuk po shikoni. Jo, po s’e keni votuar pa lexuar. Vazhdojmë.

Amendamenti 25.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 25.

Dhe amendamenti i fundit, 26 i deputetit Riza Smaka, pa përkrahje të Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 21 vota “për”, 29 “kundër”, 9 abstenime, nuk miratohet amendamenti 26 i deputetit Riza Smaka.

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni!

BAHRI HYSENI: Kryetar, e di që jeni për ngutë, mirëpo është mirë t’ua sqarojmë deputetëve. Amendamentin numër 18 që e kemi votuar, të deputetit Riza Smaka, nuk patëm nevojë ta votojmë, sepse bie në kundërshtim me Ligjin e shërbimit civil. Dhe, këtu i është dhënë mundësia që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës t’i shqyrtojë edhe ankesat që vijnë nga Ligji i përgjithshëm administrativ dhe komplet tash e nxjerrim prej sistemit Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës. Andaj, nuk duhet me u pranua sepse nuk mund të zbatohet dhe e qesim krejt në stad. Është i pari. Ndërsa, shumë me rregull do të ishte me u përkrah ai amendamenti kur nuk e përkrahëm. Por tash është mirë me intervenua edhe një herë, me sqaruar sepse s’ka të bëjë Ligji i procedurës administrative kurrgjë me Ligjin e shërbimit civil. Pikërisht Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i shqyrton ankesat e ligjit apo të nëpunësve civilë. Kurrgjë s’ka të bëjë me procedurën e përgjithshme administrative.

KRYETARI: Faleminderit, shumë! Po të lus, ty si anëtar dhe kryetar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe kryetar i Komisionit funksional, nëse një deputet e bën një amendament që bie ndesh me ligjin, nuk ka nevojë as ta qesim këtu.

BAHRI HYSENI: Jo, duhet për ta qitur, se me rregull është!

KRYETARI: Jo, s’është rregull! Ju duhet të bisedoni dhe amendamenti kur është ndeshur me ligjin nuk vihet në rend të ditës.

(Ndërhyrje, reagime)

KRYETARI: Edhe deputeti, realisht, nuk duhet të bëjë... Nëse do të bëjë, duhet t’i konsultojë të gjitha ligjet për të bërë amendament. Prandaj, unë po kërkoj nga ju dhe nga deputeti që bën amendamente, edhe nga kryetari i Komisionit funksional, edhe nga kryetari i Komisionit për Legjislacion, Gjyqësi... që mos të na bien amendamente që bien ndesh me ligjin.

(Ndërhyrje, sugjerim)

KRYETARI: Deputeti Esat Brajshori e ka fjalën.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryetar! Jo, unë mendoj, kam vetëm një gjë, deputetët duhet t'i lexojnë amendamentet dhe të dinë çka votojnë. Unë veç kaq kam. Deputetët duhet ta dinë çka votojnë, sepse të prishet tash sinkronizimi i gjithë një ligji, nuk është shumë mirë. Kaq kam unë, ndërsa e drejta e deputetëve për të bërë amendamente është gjithkund. Faleminderit shumë, kryetar!

KRYETARI: Ju lutem! Ju lutem!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Edhe një herë, realisht ka një përgjegjësi në votim, se i njëjti deputet që voton për një amendament “për” për variantin tjetër përsëri voton “për”. Kjo është jo seriozitet dhe më vjen keq.

Tash, si të veprojmë?

Deputeti Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Kryetar, ne dalim lehtë prej kësaj situatë. Nuk është që nuk po e përkrahim. Deputetët janë lëshuar në lajthitje, se s'e kanë lexuar, është pak procedurë e shpejtë. Është pa përkrahje të Komisionit funksional, është pa përkrahje të Komisionit për Legjislacion, por s'kemi pasur nevojë të bëjmë amendament tjetër, sepse nuk e ka përkrahur Komisioni funksional. Ne deshëm për të reaguuar me kohë, mirëpo për shkak Prandaj edhe një herë kërkojmë që amendamenti numër 18 të mos përkrahet dhe asgjë tjetër! Gjatë miratimit të ligjit, me këtë plotësim themi: aprovohet ligji, përjashtimisht amendamenti 18 dhe krejt është në rregull.

KRYETARI: Kërkoj deklaram të seancës për rivotim të amendamenteve që i kaluam shpejt e shpejt. Kush është për?

(Reagim)

Faleminderit! A ka kundër? 1, 2, 3. Faleminderit!

Votojmë amendamentin 18 të deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 4 “për”, 50 “kundër”, 6 abstenime, nuk miratohet amendamenti 18.

Votojmë amendamentin... Cilin thatë ta votojmë?

E ka fjalën deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Unë mendoj se njësoj duhet të veprojmë dhe me amendamentin 26, i cili nuk i mori votat për përkrahje, sepse ky amendament doemos duhet të përkrahet për të mos ia lënë në arbitrarizëm organit apo udhëheqësit të organit nëse dëshiron për ta zbatuar apo jo vendimin e këtij këshilli, prandaj duhen dënimet, por jo kaq të larta.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Faleminderit!

Regjia, votojmë ligjin në tërësi dhe votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

11. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare

Kjo është vetëm për njoftim. Vazhdojmë.

12. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2008 dhe 2009

Ftoj kryetarin e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, zotin Haki Shatri, që në emër të Komisionit, para deputetëve ta arsyetojë rekomandimin.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e ka kryer punën, obligim i cili ka dal nga vendimi i Kryesisë së Kuvendit për procedurat për auditorin që do të auditojë Zyrën e Auditorit Gjeneral.

Rekomandimi i Komisionit është para deputetëve. Unë ju them se në emër të Komisionit, rregullat, procedurat e ligjit janë respektuar. Të gjithë anëtarët e Komisionit janë pajtuar dhe e kemi një vendim për ta votuar formalisht për auditorin që do të auditojë Auditorin Gjeneral. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Votojmë propozimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për zgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008/2009.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi përzgjodhi Kompaninë audituese Grant Thornton, që të bëjë auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008/2009.

Fjalën e ka kërkuar për Rregulloren, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryetar!

Për të mos iu marrë kohë, unë po ju thërras që ta zbatoni Rregulloren. Ka të bëjë me shtojcën 2, pika 15 – Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, ku ndër të tjera, thotë: Secili grup parlamentar do ta ketë nga një anëtar. Dy partitë më të mëdha politike kanë nga 2 anëtarë në këtë komision, që është në kundërshtim me Rregulloren që është në fuqi. Po kërkoj që të zbatohet Rregullorja në këtë rast. Faleminderit!

(Reagime)

(Ndërprerje e incizimit dhe njëherësh përfundimi i seancës)

Përgatiti:
Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës